- Shkëmbim i Email-eve me Qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZKK-së.

Qershor

- Mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 14.06.2024. Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja;
- Gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar, ka pasur një kërkesë nga një familje nga fshati Gllogjan për kyçje në sistemin e kanalizimit, ku të njëjtëve ju është ndihmuar nga ZKK për hartimin e kësaj kërkesë dhe adresimin e saj tek zyra përkatëse;
- Raport për MAPL-në: Obligimet e Komunave nga Agjenda Evropiane, Plani Gjithëpërfshirës i Komunave Janar-Qershor 2024;
- ZKK i ka ndihmuar anëtarët e Komuniteteve që ti hartojnë kërkesat e komuniteteve në një kërkesë të përbashkët dhe të njëjtat i janë dorëzuar Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Komitetit për Politik dhe Financa;
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZKK-së.

Korrik

- Mbledhja e shtatë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 12.07.2024. Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja;
- Gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar, si një lajm të mirë për këtë muaj vlen të ceket asfaltimi i rrugës në një lagje të fshatit Prapaqan ku jetojnë pjesëtarët e komunitetit Boshnjak;
- Gjatë këtij takimi z. Ramiz Bajramaj, zyrtar nga DKA-ja paraqiti një pasqyrë të përgjithshme rreth mbarëvajtjes së procesit arsimor në përgjithësi e në veçanti për nxënësit e pjesëtareve të komuniteteve;
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZKK-së.

Gusht

- Gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pas kërkesa për ndihmë rreth plotësimit të dokumenteve për grante dhe subvencione të cilëve ju është ofruar ndihme nga ZKK-ja rreth plotësimit të aplikacioneve;
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZKK-së.

Shtator

- Mbledhja e tetë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 13.09.2024. Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, PK-ja, OSBE, UNMIK-u;
- Gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pasur një kërkesë nga komuniteti, familja Jollaj ka kërkuar ndihmë për kyçje në sistemin e kanalizimit, ku të njëjtëve ju është ndihmuar nga ZKK për hartimin e kësaj kërkesë dhe adresimin e saj tek zyra përkatëse;
- Gjatë kësaj mbledhje raportoj Drejtoresha për Buxhet dhe Financa Znj, Dafina Cacaj: e njëjta i njoftoj të pranishmit për Buxhetin e Komunës së Deçanit vitin 2025/2027. Buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2025 parashihet të jetë 14,401,935.00 €. Drejtoresha znj. Dafina Cacaj tha se gjatë viteve paraprake janë realizuar shumë projekte për qytetarët nga komunitetit jo shumicë siç është asfaltimi dhe kyçja në rrjetin e kanalizimit në lagjen Pemishte, Gramaçel dhe Prapaqan, projekte këto të bashkëfinancuara nga niveli qendror me participim edhe nga Komuna e Deçanit. Drejtoresha i inkurajoj përfaqësuesit e komuniteteve jo shumice pranë Komitetit për Komunitete që të paraqesin kërkesa konkrete dhe se të njëjtat do të shqyrtohen. Edmond Dushi përfaqësues i OSBE-së i njoftoj të pranishmit rreth aktiviteteve që janë në vazhdimësi këtë vit e që organizohen dhe sponsorizohen nga OSBE, aktiviteti pasues është vizita neper teren në vendbanimet me komunitete në Komunën e Deçanit. Pjesë e këtyre vizitave do të jone koleget nga Komuna e Pejës me qëllim të shkëmbit të përvojave të ndryshme nga terreni;
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZKK-së.

Tetor

- Mbledhja e nëntë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 11.10.2024. Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, PK-ja, OSBE, UNMIK-u;
- Gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pasur një kërkesë nga komuniteti, një familja ka kërkuar ndihmë për kyçje në sistemin e kanalizimit, ku të njëjtëve ju është ndihmuar nga ZKK për hartimin e kësaj kërkesë dhe adresimin e saj tek zyra përkatëse;
- Edmond Dushi nga OSBE i njoftoj të pranishmit rreth aktiviteteve që janë në vazhdimësi këtë vit e që organizohen dhe sponsorizohen nga OSBE. Aktiviteti pasues është vizita neper teren në vendbanimet me komunitete jo shumicë në Komunën e Pejës;
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZKK-së.

Nëntor

- Mbledhja e dhjetë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 08.11.2024. Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, PK-ja, OSBE, UNMIK-u;
- Gjatë këtij muaji kemi pasur një rast të personave të riatdhësuar te cilit i është ofruar ndihma rreth procedurave të riatdhësimit;
- Gjatë këtij muaji ka pasur një thirrje nga Ministria e Kthimit për rindërtimin e shtëpive të komuniteteve dhe një thirrje tjetër për ndarjen e bursave, kjo informate është shpërndarë tek përfaqësuesit e komuniteteve nga ZKK-ja;
- Drejtori i QPS-së z. Islam Mustafaj i njoftoj të pranishmit për gjendjen sociale të pjesëtarëve të komuniteteve në Komunën e Deçanit;
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZKK-së.

Dhjetor

- Mbledhja e njëmbëdhjetë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 13.12.2024. Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, PK-ja, OSBE, UNMIK-u;
- Gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhësuar, ka pas kërkesa për ndihmë rreth plotësimit të dokumenteve për grante dhe subvencione të cilëve ju është ofruar ndihmë nga ZKK-ja rreth plotësimit të aplikacioneve;
- Raport për MAPL-në: Obligimet e Komunave nga Agjenda Evropiane Plani Gjithëpërfshirës i Komunave Janar-Dhjetor 2024.;
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve të përditshme të ZKK-së.

➤ Zyra për Barazi Gjinore

Zyra për Barazi Gjinore ka qenë gjithnjë e përkushtuar për avancimin e barazisë gjinore ku për këtë kemi qenë të fokusuar në disa komponentë, ndër të tjera veçojmë:

Për fuqizimin ekonomik të grave janë ndërmarrë masa adekuate, ku komuna në bashkëpunim me donatorë ka bërë subvencionimin e 25 shoqatave që merren me kultivimin e kulturave të ndryshme promovuese (kulturë, sport, artizanale, bujqësi).

Është funksionale këshillimorja në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë e cila rregullisht mbanë trajnime me fermer, kryesisht fermere femra për krijimin e bizneseve të reja në agro-kulturë, kultivimin e perimo-kulturës e trajnime tjera në zhvillimin e bujqësisë që rrisin fuqizimin ekonomik, posaçërisht të grave.

Zyra e kryetarit ka marrë Vendim për hartimin e Strategjisë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2024-2026, që ka për synim parandalimin e dhunës, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të dhunës.

Ndërsa sa i përket riintegritetit të viktimave të dhunës në familje, Komuna e Deçanit ka lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi me Shtëpinë e Qëndrimit në Pejë, për financimin e kësaj qendre për çdo vit, por në rast të rritjes së numrit të strehimit të viktimave në këtë qendër, veç shumës së paraparë në marrëveshje, buxheti komunal ndahet shtesë në proporcion me viktimat e strehuara.

Veç kësaj, Komuna e Deçanit ka punësuar 4 psikologë, politikë kjo që e bënë më të lehtë identifikimin e dhunës në familje, pasi që dhuna ndikon indirekt edhe tek fëmijët në familje, pasi që fëmijët e përjetojnë më së rëndi dhunën në familje, dhe identifikimi i tyre mund të bëhet më lehtë nga psikologët shkollor.

Është organizuar bashkë me OSBE-në, KFOR-in, Stacionin e Policisë në Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri”, punëtori informuese për dhunën në familje, këto punëtori do të vazhdojnë ligjëratat informuese në shkollat e tjera të komunës që do të fillojnë në muajin shtator, ku nga këto ligjëratat direkt do të përfitojnë 1200 nxënës të shkollave të komunës sonë.

Sipas Komandantit të Stacionit të Policisë në Deçan, sa i përket të dhënave-statistikat e rasteve me dhunë në baza gjinore për periudhën Janar - Qershor janë trajtuar 24 raste të dhunës në familje.

Drejtorja për Buxhet dhe Financa edhe në këtë vit, ka bërë rimodelimin e KAB-it nga perspektiva gjinore, si dhe të bëjmë analizë gjinore të shpenzimeve publike në sektorë të ndryshëm, pasi që të jemi të gatshëm që në procesin e planifikimit të buxhetit, i cili fillon në muajt në vijim, të planifikojmë buxhetin 3 vjeçar nga perspektiva gjinore (mbështetje dhe përkrahje projekteve me baza gjinore).

Në komunë janë organizuar këto aktivitete:

- **Organizimi i 8 Marsit, Dita Ndërkombëtare e Gruas** - u mbështetë dhe përkrahë nga Zyra e Kryetarit. Po ashtu znj. Shkendije Berisha Pacolli, për 8 Mars prezantoi dokumentarin “Gruaja Dukagjinase dhe sot” - ku morën pjesë shumë gra deçanase.



- Punëtorja me temën “Dhuna në familje dhe Mekanizmi Komunal kundër Dhunës në Familje”

2024/04/30 - 10:28



Punëtorja me temën “Dhuna në familje dhe Mekanizmi Komunal kundër Dhunës në Familje”, u organizua nga Ekipi Monitorues Ndërlidhës të KFOR-it (LMT), me OSBE-në, mbështetur nga Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj. Punëtorja u mbajt me nxënësit e shkollës së mesme “Vëllezërit Frashëri” për ngritjen e vetëdijes kundër dhunës në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore. Parandalimi i këtij realiteti të trishtë është e domosdoshme të mbahen punëtori edhe në shkollat e tjera, meqë rastet e dhunës në familje në vitet e fundit vetëm sa janë shtuar dhe jo e kundërta. Në këtë punëtori morën pjesë anëtarët e mekanizmit, Xhavit Nimonaj-Udhëheqës i Njesisë kundër Dhunës në Familje në Stacionin e Policisë, Ardita Ramizi Bala, Drejtoreshë e Strehimore në Pejë, Ibrahim Lushaj-Zyrtar në Qendrën për Punë Sociale, Besnik Hulaj- Drejtor për Arsim, Hamid Qorraj- Drejtori i Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri”, si dhe nxënës të gjimnazit. Anëtarët e mekanizmit komunal, KFOR-i, OSBE-ja, drejtori i gjimnazit ndanë informacione me nxënësit në lidhje me dhunën në familje dhe i ftuan nxënësit që të përhapin mesazhin rreth temës dhe mënyrës së raportimit të rasteve të mundshme të dhunës në familje.

- **Ndarja e mirënjohjeve për Klubin e vajzave të Hendbollit të Vajzave “Jusuf Gërvalla”**

Mbështetja dhe përkrahja nga Zyra e Kryetarit për Klubin e Hendbollit të Vajzave “Jusuf Gërvalla”, me trajner Musa Berisha. Arjeta Imeraj, lojtarja e shquar e klubit të Deçanit, është në mesin e të përzgjedhurave të përfaqësueses së Kosovës në Kampionatin Botëror në Hendboll, i cili do të mbahet në Kinë.



- **Punëtori me temën Ankthi dhe Depresioni (Postpartum)**

Mbështetur nga Komuna e Deçanit, u mbajt tribuna me Prof. Dr. Ferid Aganin me temën: Ankthi dhe Depresioni (Postpartum). Të pranishmit u njoftuan rreth ankthit dhe pasojat që mund t'i sjellë shoqërisë, i cili duhet të trajtohet që nga shfaqja e shenjave të para dhe konstatohet me profesionist përkatës. Me shpresën të mbështesim njëri tjetrin në këto raste. Me moton “Thyeje heshtjen, nuk je vetëm”!

Tribunë me **Prof.Dr.Ferid Agani**
Tema: **Ankthi & Depresioni**
(Postpartum)



31 Maj, Ora 14:00
Vendi: **Gendra Rinore Deçan**



- Diskutim në tryezë të rrumbullakët mbi Buxhetimin Gjinor në Komunën e Deçanit

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Dafina Cacaj, së bashku me z. Visar Gjakova, Menaxher i Programit, dhe znj. Elena Morina, Asistente e Programit nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), dhe Ekspertja për Buxhetim Gjinor, znj. Elirjeta Beka nga Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës, mbajtën një diskutim në tryezë të rrumbullakët mbi Buxhetimin Gjinor në Komunën e Deçanit. Në këtë tryezë u diskutua për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor në komunën e Deçanit, i cili është një qasje proaktive që synon të sigurojë që alokimet dhe shpenzimet buxhetore adresojnë nevojat dhe prioritetet specifike të grave, burrave, vajzave dhe djemve në mënyrë të barabartë. Kjo strategji pranon se buxhetet nuk janë neutrale ndaj gjinisë dhe se ato ose mund të përjetësojnë ose të zbusin pabarazitë gjinore brenda shoqërisë. Duke përfshirë perspektivën gjinore në proceset buxhetore, Deçani po punon drejt ndërtimit të një shoqërie më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse, ku nevojat dhe të drejtat e të gjithë banorëve njihen dhe adresohen plotësisht.

Ky program është mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



- Pjesëmarrje në trajnime dhe punëtori:

Zyrtarët komunal për barazi gjinore ndoqën trajnimin dy ditor me temën “Barazia Gjinore online: trendet e sotme dhe strategjitë inovative për ndryshim”, të organizuar nga Qendra e Trajnimit të AKK-së.

Ky trajnim kishte për qëllim pajisjen e Zyrtarëve Komunal për Barazi Gjinore me njohuri dhe aftësi të domosdoshme për të përdorur rrjetet sociale si mjet i fuqishëm në ndërgjegjësimin dhe promovimin e barazisë gjinore si dhe për të nxitur pjesëmarrje aktive për ndryshim pozitiv nëpër komunat e Kosovës,

Gjatë këtyre dy ditëve intensive, u diskutuan trendet dhe strategjitë inovative për të promovuar një kulturë të barazisë gjinore përmes mediave sociale. Qendra e Trajnimit është e përkushtuar të vazhdojë këtë angazhim me Zyrtarët për Barazi Gjinore që t'i pajisë ata në përdorimin e çdo platforme dhe burimi në dispozicion për të ngritur dhe avancuar zërin e barazisë gjinore.



- Fuqizimi i gruas duke zvogëluar dallimet në rajonin e Pejës

Tryezë e rrumbullakët me temën: Fuqizimi i gruas duke zvogëluar dallimet në rajonin e Pejës, organizuar nga OSBE me datë 20 Mars në Pejë, në hotel Dukagjini. Kjo tryezë e rrumbullakët e cila ka për qëllim të përforcojë komunikimin dhe bashkërendimin mes zyrtareve për barazi gjinore dhe kryesueseve të grupeve të grave në rajonin e Pejës. Tryeza ka për qëllim të ndihmojë në shkëmbimin e të arriturave dhe njohurive mes zyrtareve për barazi gjinore dhe grupeve të grave, duke paraqitur momentin e duhur dhe dialogun e parë mbi barazinë gjinore dhe gratë në qeverisje të nivelit ekzekutiv dhe legjislativ në rajonin e Pejës.

➤ Drejtoria e Administratës

Bazuar në përgjegjësitë dhe angazhimet që ushtron Drejtoria për Administratë dhe planifikimeve vjetore, rezulton se gjatë vitit 2024 me sukses janë kryer të gjitha obligimet e shërbimeve dhe kërkesat e qytetarëve.

Gjatë periudhës gjashtë mujore në Qendrën e shërbimit me qytetarë (Zyra pritëse) janë pranuar dhe proceduar për realizim 30,663 kërkesa dhe lëndë të ndryshme.

Në sektorin e gjendjes civile të të gjitha zyrave të gjendjes civile janë lëshuar 44,225 certifikata të ndryshme, nga këto 31,596 për përdorim të brendshëm dhe 12,629 për përdorim të jashtëm.

Zyra ligjore ka kryer 468 aktvendime, vërtetim për kadastrë 6, 138 aktvendime për fitim të shtetësisë, 11 aktvendime për lirim të shtetësisë.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor, zyra për themelimin e Aktit të Vdekjes ka kompletuar dhe lëshuar 214 Akte Vdekjeje.

Zyra e E-PASURIS dhe FREE BALANCIT gjatë vitit 2024 është angazhuar në kryerjen e obligimeve me përgjegjësi, nga këto angazhime rezulton se në FREE BALANCE janë gjeneruar 698 raporte të pranimit të mallit, ndërsa në E-PASURI janë regjistruar 418 fatura apo lista të inventarizimit.

Inventarizimi është bërë në objektet e komunës, Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Ambulancave të Mjekësisë Familjare, si dhe regjistrimi i inventarit në të gjitha shkollat e Komunës së Deçanit.

Gjatë vitit 2024 në Njësinë për Teknologji Informativë, njësi kjo e sistemuar në kuadër të Drejtorisë për Administratë janë kryer këto punë profesionale në lëmin e Teknologjisë Informativë:

- Janë mirëmbajt Pajisjet Elektronike / PC-të, Printerët – Skanerët, MFP-të, Digital Sender-i në QSHQ, në Institucionin e Komunës, etj.;
- Instalimi i Softuerëve në Pajisjet Elektronike Harduerike;
- Instalimi si dhe konfigurimi i Aplikacioneve Profesionale për mirëvajtjen e proceseve administrative në Drejtorinë e Komunës;
- Konfigurimi dhe përdorimi i Pajisjeve Elektronike për mirëvajtjen e Takimeve të Kuvendit të Komunës dhe zërimit në Sallën e Takimeve;
- Njësia për Teknologji Informativë / NJTI në bazë të kërkesave të Drejtorive të Komunës e në bashkërenditje me Njësinë e Prokurimit është bërë specifikimi për furnizime me pajisje elektronike të Drejtorive / Njësive të Komunës;
- Në bazë të kërkesave të Drejtorisë për Administratë, Drejtoria në fjalë është furnizuar me dhjetë pajisje elektronike / kompjuter;
- Janë mirëmbajt të gjitha MFP-të e Drejtorive / Njësive të Komunës si dhe janë kryer edhe punë tjera profesionale në lëmin e Teknologjisë Informativë ashtu që proceset administrative të mos kenë ngecje në asnjë moment.

Shtëpiaku është kujdesur për rregullimin e avarive të ndryshme brenda objektit të komunës dhe mirëmbajtjen e hapësirave pranë objektit të komunës.

Gjatë kësaj periudhe jemi kujdesur për mbulimin e të gjitha nevojave me materiale shpenzuese për të gjitha shërbimet në mënyrë që mos të ketë ngecje në asnjë situatë.

Në Drejtorinë për Administratë gjatë kësaj periudhe nuk kemi asnjë aferë korruptive dhe asnjë ankesë të qytetarëve për shërbimet e ofruara.

Gjithashtu vlen të theksohet se kemi bërë planifikimin e pushimeve vjetore në atë mënyrë që të përballohet fluksi i bashkatdhetarëve në muajt e verës.

➤ **Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit**

Qëllimi i këtij Raporti është të paraqesë një përmbledhje të aktiviteteve, të arriturve dhe sfidave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024. Puna në Drejtorinë tonë bazohet në Ligjin Për Ndërtim 04/L-110, Ligji Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen E Mjedisit, Ligji Nr.05 L-31 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 06/L-024 Për Trajtimin E Ndërtimeve Pa Leje dhe aktet nën ligjore që rrjedhin prej tyre dhe në rregulloret komunale.

Në muajin Maj kemi marrë pëlqimin nga MPHI për shqyrtim publik të PZHK 2024-2032. Ka filluar shqyrtimi publik me hapjen solemne me datë 24.06.2024 dhe ka vazhduar me takime me banorë të të gjitha fshatrave dhe të gjitha palët e interesit. Pas shqyrtimit publik dhe hyrjes në fuqi të PZHK hapet rruga për Hartimin e Hartave Zonale.

AKTIVITETET

Aktiviteti	Periudha	Sektori	Numri	Te tjera
Kryerja e punëve rreth dhënies së kushteve të lokacionit, për ndërtimet e objekteve të reja, adaptimet, rekonstruimet, rindërtimet etj.	Janar - Qershor	Sektori i urbanizmit	8 vendime për kushte ndërtimi dhe njoftime publike	6 vendime janë për objekte private dhe 2 për objekte publike
Kryerja e punëve rreth dhënies së lejes së ndërtimit dhe llogaritja e taksave urbanistike	Janar - Qershor	Sektori i urbanizmit	5 leje 5 taksa	Taksa të mbledhura 19,971.82 euro
Kërkesa të pranuar	Janar - Qershor	Sektori i urbanizmit	230 gjithsej	230 të shqyrtuara
Kërkesa për leje ndërtimi	Janar - Qershor	Sektori i planifikimit	8	8 të shqyrtuara
Kërkesa për leje mjedisore komunale	Janar - Qershor	Sektori për mbrojtje të mjedisit	2	Të shqyrtuara 2
Vendime për leje mjedisore komunale	Janar - Qershor	Sektori për mbrojtje të	2	Taksa të mbledhura

		mjedisit		4546.30 euro
Vendime për leje rrënimi	Janar - Qershor	Sektori i urbanizmit	2 vendime 2 taksa	
Vendime për dhënien e certifikatës së legalizimit	Nëntor - Qershor	Sektori i urbanizmit	25 vendime	Taksa te mbledhura 11,618.09 euro
Vendime për refuzim për kushte, leje ndërtimi, rritje etazhiteti dhe leje mjedisore	Janar - Qershor	Sektori i urbanizmit, sektori i mjedisit	3 - refuzim për kushte 0 -leje ndërtimi 1 - rritje etazhiteti 0 - leje mjedisore	
Kryerja e punëve rreth dhënies së lejes mjedisore dhe llogaritja e taksave mjedisore	Janar - Qershor	Sektori për mbrojtje te mjedisit	2 leje 2 taksa	Është bërë inspektimi në terren
Pëlqime të natyrave të ndryshme	Janar - Qershor	Zyrtarja ligjore	5	
Njoftime të natyrave të ndryshme	Janar - Qershor	Zyrtarja ligjore	12	
Përgjigje të natyrave të ndryshme	Janar - Qershor	Zyrtarja ligjore	3	
Referenca për punë të kryera	Janar - Qershor	Drejtoria	2	
Është dorëzuar drafti dhe pritët pëlqimi për diskutim publik nga MMPH për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal	Janar - Qershor	Sektori i planifikimit		
Janë zhvilluar takime me banorët dhe palët e interesit në kuadër të shqyrtimit publik ku është	Qershor e në vazhdim	Drejtoria	10 takime të cilat vazhdojnë	

prezantuar Plani Zhvillimor Komunal			në muajin Korrik	
Puna në komisione vlerësuese për projekte të ndryshme në zyrën e prokurimit	Janar - Qershor	Drejtoria		
Punimi i paramasave dhe paralogarive për projekte të ndryshme ku investitor është komuna ose niveli qendror	Janar - Qershor	Drejtoria		
Pranimet teknike të projekteve ku investitor është komuna dhe Ministria	Janar - Qershor	Drejtoria	2	
Futja dhe përditësimi i të dhënave për numra dhe adresim për komunën	Janar - Qershor	Sektori i Adresave		
Përpilimin i kërkesave dhe akteve përcjellëse për: Ministritë, Ndërmarrje, Korporata, Agjencinë të ndryshme për nxjerrjen e buxheteve dhe përkrahjeve ligjore për projekte të ndryshme, drejtori paralele	Janar - Qershor	Drejtori Zyrtarja ligjore	11 kërkesa 5 akte përcjellëse	
Pritja e palëve, shqyrtimi i kërkesave dhe kthimi i përgjigjeve	Janar - Qershor	Drejtoria		

PROJEKTET DHE PARAMASAT E PUNUARA DHE MENAXHUAR NGA STAFI I DREJTORISË

Nr.	Titulli i projektit/paramasës
1.	Hartimi i projektit kryesor zbatues i pishinës gjysmë-olimpike
2.	Paramasa për renovimin e strehës së kulmit të QKMF “Adem Ukëhaxhaj”
3.	Menaxhimi i projektit kryesor “Kompleksi Memorial Dëshmorët e Dukagjinit” në Glllogjan
4.	Menaxhimi i projektit kryesor “Ndërtimi, zgjerimi i rrugës, urave dhe strukturave, segmenti Lëbushë-Qendra e Strellcit”

5.	Paramasa për ngjyrosjen e ambientit të brendshëm të stacionit të policisë
6.	Paramasa për adaptimin dhe rregullimin e kthinës së kurorëzimit për çifte

Hartimi i projektit kryesor zbatues të pishinës gjysmë-olimpike dhe sigurimi i buxhetit në vlerë prej 2,076,704 € për ndërtimin e saj është menaxhuar nga ekspertët e Drejtorisë, me përkrahjen e kompanive projektuese të fushave përkatëse. Drejtoria ka caktuar lokacionin, ka bërë ndarjen e parcelës, ka kërkuar dhe ka marrë pëlqimin e Kuvendit Komunal, ka përpiluar kushtet e lokacionit dhe ka plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit mes Komunës dhe Ministrisë.

- SEKTORI I ADRESAVE

Përditësimi i numrave në sistemin elektronik të adresave është kryer vitin e kaluar. Gjatë këtij gjysmë viti është punuar në emërtimin e rrugëve të reja. Puna në komisionin për emërtimin e rrugëve në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të komisionit konsiston në mbledhjen e kërkesave të qytetarëve për emërtim, shqyrtimin e tyre, daljen në terren, përcjellja e kërkesave dhe sugjerimeve të komisionit në MAPL dhe marrjen e vendimit për secilën kërkesë.

➤ Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsim dhe Shkencë për periudhën Janar – Dhjetor 2024, duke përfshirë kategoritë ekonomike të paga & mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale-vetanake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyre analitike, të hyrat nga gjobat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar - Dhjetor të vitit 2024.

Buxheti i Komunës për vitin 2024, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financës, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2024, për Komunën e Deçanit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

❖ Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
- Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
- Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar.

❖ Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:

- Realizimi i të hyrave vetanake-komunale sipas burimeve,
- Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e Thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

1. Të Hyrat Vetanake

1.1. Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake komunale

- Raporti i përgatitur, mbulon vitin fiskal 2024, dhe paraqet informatën e përcaktuar që kanë të bëjnë me realizimin dhe regjistrimin e të hyrave financiare. Më poshtë janë të paraqitura realizimet e të hyrave vetanake nëpër muaj si dhe tabelë e veçantë të realizimit të gjobave nga trafiku dhe gjobat nga gjykata për tremujorin e parë (TM1 – Janar, Shkurt, Mars), tremujorin e dytë (TM2 - Prill, Maj, Qershor), tremujorin e tretë(TM3 – Korrik, Gusht, Shtator), TM4 nuk është i paraqitur pasi që nuk është dërguar ende raporti i TM4 nga thesari.

- Planifikimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar – Dhjetor 2024, është në shumën prej 847,565.00 euro, Realizim i të Hyrave në total Janar – Dhjetor shuma prej 1,032,097.24 euro.

1.2. Tabela e realizimit detaj të të hyrave vetanake

<i>Raporti i realizimit të të hyrave financiare për periudhën Janar – Dhjetor</i>	
Te hyrat vetanake në periudha mujore dhe në total për periudhën 1 vjeçare	
Janar	46,767.87
Shkurt	45,087.87
Mars	94,165.51
Prill	96,118.13
Maj	71,005.00
Qershor	43,349.24
Korrik	56,842.48
Gusht	77,197.21
Shtator	70,990.10
Tetor	99,651.27
Nëntor	53,399.71

Dhjetor	116,561.85
Totali	871,166.24

<i>Raporti i realizimit të të hyrave financiare nga Gjobat në trafik nga Policia dhe Gjobat nga Gjykatat për periudhën Janar – Shtator</i>		
Të hyrat vetanake në periudha mujore dhe në total për periudhën 9 mujore TM1,TM2,TM3		
	Gjobat nga trafiku policia	Gjobat nga trafiku gjykata
Janar	7,355	700
Shkurt	8,345	1,100
Mars	9,005	450
Prill	12,315	450
Maj	9,480	700
Qershor	6,965	650
Korrik	14,075	1,570
Gusht	24,475	1,000

Shtator	12,745	935
Tetor	14,960	1,785
Nentor	13,460	2,335
Dhjetor	15,251	825
Totali	148,431.00	12,500.00
Totali : 160,931.00		

Të hyrat vetanake: 871,166.24

Te hyrat nga Gjobat në trafik dhe Gjykata : 160,931.00

Totali : 1,032,097.24 Euro

1.3. Paraqitja Tabelare e periudhës së realizimit të të hyrave financiare krahasuar me vitin paraprak 2023




Fig.1 Krahاسimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Janar me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Janar.

Fig.2 Krahاسimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Shkurt me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Shkurt.




Fig.3 Krahاسimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Mars me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Mars.

Fig.4 Krahاسimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Prill me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Prill.




Fig.5 Krahاسimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Maj me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Maj.

Fig.6 Krahاسimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Qershor me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Qershor.




Fig.7 Krahاسimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Korrik me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Korrik.

Fig.8 Krahاسimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Gusht me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Gusht.




Fig.9 Krahasimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Shtator me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Shtator.




Fig.10 Krahasimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Tetor me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Tetor.




Fig.11 Krahasimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Nëntor me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Nëntor.




Fig.12 Krahasimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për muajin Dhjetor me të hyrat vetanake të vitit 2023 për muajin Dhjetor.




Fig.13 Krahasimi i të hyrave vetanake të vitit 2024 për Periudhën Janar - Dhjetor me të hyrat vetanake të vitit 2023.

2. Buxheti dhe Shpenzimet

2.1. Shpalosja e Buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2024

2.1.1 Planifikimi i Buxhetit për Vitin 2024

Drejtori për buxhet dhe financa në muajin qershor ka filluar me planifikimin e buxhetit për vitin 2025.

Pas pranimit të Qarkores së parë buxhetore 2025/2 me 15.05.2024 kemi filluar edhe takimet buxhetore për Kornizën Afatmesme 2025/2027

Janë mbajtur katër Dëgjime Buxhetore

1. Dëgjim buxhetor me përfaqësues të këshillave lokale të fshatrave

2. Dëgjim buxhetor/ Granti për Arsim
3. Dëgjim buxhetor/ Granti për Shëndetësi
4. Dëgjim buxhetor me qytetarët e komunës së Deçanit

Me 28 Qershor është aprovuar nga Asambleja komunale Korniza Afatmesme Buxhetore 2025/2027.

Pas lëshimit të qarkores së dytë buxhetore nga Ministria e Financave 2025/2 me dt. 15.08.2024 së bashku me Ekzekutivin, KPF-në dhe Asamblenë komunale, kemi filluar me planifikimin detaj të buxhetit të vitit 2025 së bashku me përfaqësues të ndryshëm nga komuniteti i Komunës së Deçanit, para së të finalizojmë planifikimin e kemi organizuar dhe mbajtur takime buxhetore me:

1. Dëgjim buxhetor me shëndetësi
2. Dëgjim buxhetor me arsim
3. Dëgjim buxhetor me qytetarë të Komunës së Deçanit dhe përfaqësues të fshatrave
4. Dëgjim buxhetor me gra
5. Dëgjim buxhetor me OJQ

Në mbledhjen e Asamblesë komunale me 28.09.2024 është aprovuar Buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2025 në total:

Buxheti fillestar i aprovuar në Kuvendin Komunal ishte në shumën prej 12,660,517.00€ nga Granti Qeveritar dhe 847,565.00 € nga të Hyrat Vetanake të planifikuara për inkasim gjatë vitit 2024. Andaj, përfundimisht buxheti për vitin 2024 është shumën totale prej 13,508,082.00 €.

Te hyra të Bartura nga viti 2023 në vitin 2024 kanë qenë 157,135.53

Buxhet shtesë me Vendime të Qeverisë: vendimi nr.233 dt 27.11.2024 vlera 507,302.00 Euro, Vendimi nr 03/239 dt.24.12.2024 vlera 605,795.13 euro.

	Buxheti Final	Realizimi	Diferenca	%
--	----------------------	------------------	------------------	----------

Paga dhe Meditje	8,407,537.08	8,407,537.08	-	100.00%
Mallrave dhe Sherbime	2,672,310.75	2,649,559.92	(22,750.83)	99.14%
Shpenzime komunale	250,000.00	249,689.67	(310.33)	99.87%
Subvencione	290,103.00	289,031.12	(1,071.88)	99.63%
Kapitale	3,179,833.61	3,030,003.69	(149,829.92)	95.28%
Janar - Dhjetor 2024	14,799,784.44	14,625,821.48	(173,962.96)	98.82%

2.2. Planifikimi i Buxhetit 2024 dhe shpenzimi sipas kategorive ekonomike

PERSHKRIMI	PLANIFIKIMI	SHPENZIMI	DIFERENCA	%
GRANT QEVERITAR (10)	13,773,614.08	13,754,156.47	(19,457.61)	99.85%

PAGAT DHE SHITESAT	8,407,537.08	8,407,537.08	-	
MALLRA DHE SHERBIME	2,330,890.00	2,328,823.44	(2,066.56)	
SHPENZIME KOMUNALE	250,000.00	249,689.67	(310.33)	
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	249,000.00	248,078.43	(921.57)	
INVESTIMET KAPITALE	2,536,187.00	2,520,027.85	(16,159.15)	
TE HYRA VETANAKE (21)	847,565.00	712,909.56	(134,655.44)	84.10%
MALLRA DHE SHERBIME	217,938.00	199,982.36	(17,955.64)	
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	41,000.00	40,952.69	(47.31)	
INVESTIMET KAPITALE	588,627.00	471,974.51	(116,652.49)	
TE HYRA VETANAKE (22)	157,135.53	155,998.45	(1,137.08)	99.27%
MALLRA DHE SHERBIME	118,044.60	117,997.12	(47.48)	
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	103.00	-	(103.00)	

INVESTIMET KAPITALE	38,987.93	38,001.33	(986.60)	
GRANT I DONAT.TË BRENDSHËM (31)	16,027.70	-	(16,027.70)	0%
MALLRA DHE SHERBIME	4.00	-	(4.00)	
INVESTIMET KAPITALE	16,023.70	-	(16,023.70)	
GRANTE TJERA TË JASHTME (32)	974.50	-	(974.50)	0%
MALLRA DHE SHERBIME	974.50	-	(974.50)	
QEVERIA NORVEGJEZE (57)	7.98	-	(7.98)	0%
INVESTIMET KAPITALE	7.98	-	(7.98)	
QEVERIA JAPONEZE (59)	4,416.00	2,800.00	(1,616.00)	63.40%
MALLRA DHE SHERBIME	4,416.00	2,800.00	(1,616.00)	
COUNCIL OF EUROPE (93)	43.65	-	(43.65)	0%
MALLRA DHE SHERBIME	43.65	-	(43.65)	

TOTALI :GRANTI + THV+DONACIONET	14,799,784.44	14,625,864.48	(173,919.96)	98.82%
--	----------------------	----------------------	---------------------	--------

3. Pagesat në Arkë gjatë vitit 2024

Pagesat në Arkë bëhen nën vlerën 10 euro dhe përfshijnë pagesat e certifikatave të Lindjes, certifikata e vendbanimit, certifikata e vdekjes, certifikata e statusit martesor, certifikata e martesës, certifikata e bashkësisë familjare, certifikata e shtetësisë, ekstrakt i lindjes, vërtetim nga arkiva dhe taksa tjera administrative.

Janar 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	2415 €
Raport i pagesave të anuluar	102 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	4397€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S 2426- E.L 1536€- G.K100€ S.L- 127€ S.D 208

Shkurt 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	928 €
Raport i pagesave të anuluar	28 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	2946€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S 1037€ -G.K71€ -S.D224€- E.L 1614

Mars 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	739 €
Raport i pagesave të anuluar	49 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	3376€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S819€- G.K218€- S.D 375€ E.L 1964

Prill 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	498€
Raport i pagesave të anuluar	25 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	3274€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S 458€ E.L 2469€ S.D248€ S.L99€

Maj 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	1949 €
Raport i pagesave të anuluar	56 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	3419€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S 1811€ E.L 1080€ S.D 277€ G.K 228

Qershor 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	3718 €
Raport i pagesave të anuluar	103 €

Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	4056 €
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S 1829€ E.L 619€ S.D-205€

Korrik 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	2875€
Raport i pagesave të anuluar	53 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	4437€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S-2800€ G.K353€ S.D 178€ E.L 2106€

Gusht 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	1106€
Raport i pagesave të anuluar	27 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	5924€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S 157€ S.D 233€ E.L 4109€ G.K 425€

Shtator 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	1026€
Raport i pagesave të anuluar	56 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	3566€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S-907€ S.D-64€ S.L-158€ E.L 2183€

Tetor 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	1204€
Raport i pagesave të anuluar	95 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	3097€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S-1270€ S.D-103€ E.L 1601€ G.K-123€

Nëntor 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	487€
Raport i pagesave të anuluar	11 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	2467€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S-510€ S.D-116€ G.K-117€ E.L 1724

Dhjetor 2024

Raport i fletëpagesave të lëshuara	367€
Raport i pagesave të anuluar	24 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	3188€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S-382€ S.D-136€ E.L 2510 S.L-27€ G.K-133€

Gjatë këtij viti çdo ditë pune në mëngjes e kemi bërë barazimin e arkës, ndërsa pasdite zbrazjen e arkës dhe dërgimin e të hollave në poste.

Çdo ditë kemi pranuar pagesa si vijon:

DEQ4N- Certifikata të lindjes, ekstrat të lindjes

DEQ4U- Certifikata tjera ofiqarie

DET4U- Taksa tjera administrative

DEGFP-DEG4M – Pagesat e kadastrës

DEQ4G- Aktvendim për regjistrimin e vdekjes

DEQ4P – Certifikata të martesës

DEQ4S – Taksë verifikim i dokumenteve të ndryshëm

DEB4B – Taksë rrugore

DEQ5G – Gjoha të ndryshme

4. Departamenti i Tatimit në pronë

- Zyra e tatimit në pronë këtë vit ka inkasuar nga tatimi i pronës vlerën prej 520.053.85 €. për periudhën Janar-Dhjetor 2024, kemi bërë shqyrtimin ankesave të shqyrtuara nga komisioni 72 ankesa për objekte dhe parcela – dhe janë rregulluara në sistem.
- Kërkesave dhe përmirësim të vazhdueshëm për objekte dhe parcela -167 kërkesa,
- Modifikim i të dhënave të pronës nga sistemi janë kryer 177.
- Modifikime të të dhënave e relacionit të tatimpaguesit nga sistemi janë kryer 355.
- Modifikim i të dhënave të tatimpaguesit- 1784.
- Korrigjim manual i të dhënave 452
- Certifikata të lëshuara 294

➤ **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) e Komunës së Deçanit, gjatë vitit 2024, ka punuar intensivisht për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për qytetarët. Duke u bazuar në strategjitë dhe prioritetet e përcaktuara, fokusi ynë ka qenë përmirësimi i infrastrukturës, rritja e cilësisë së kujdesit shëndetësor dhe ofrimi i mbështetjes për grupet më të cënueshme të shoqërisë.

Në këtë raport paraqiten aktivitetet, arritjet dhe sfidat kryesore të drejtorisë gjatë këtij viti, duke reflektuar përkushtimin tonë për të siguruar mirëqenie dhe shërbime të qëndrueshme për të gjithë qytetarët e komunës. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe angazhimit të palodhur të stafit profesional, kemi arritur të adresojmë disa nga sfidat më të mëdha dhe të ndërtojme hapa të qëndrueshëm për të ardhmen.

DSHMS, veprimtarinë e saj e zhvillon duke u mbështetur në:

- ✓ Ligjin për Shëndetësi,
- ✓ Udhëzimit Administrativ
- ✓ Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare
- ✓ Ligjin për Vetëqeverisje Lokale,
- ✓ Statusin e QKMF.

➤ *Misioni*

Të sigurojmë një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të shërbimeve shëndetësore dhe sociale, duke ofruar mbështetje për të gjithë qytetarët, veçanërisht për ata që kanë më shumë nevojë.

➤ *Vizioni*

Të ndërtojme një komunitet të shëndetshëm dhe solidar, ku çdo qytetar ka qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor dhe mbështetjen sociale.

➤ *OBJEKTIVAT KRYESORE PËR VITIN 2024*

- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve në institucionet shëndetësore dhe sociale.
- ✓ Rritja e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore.
- ✓ Mbështetja e grupeve të cënueshme dhe zbatimi i politikave për përfshirje sociale.
- ✓ Edukimi dhe vetëdijesimi i qytetarëve për shëndetin publik.
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

➤ **Aktivitetet vjetore të DSHMS-së**

Gjatë këtij viti, DSHMS ka realizuar një sërë iniciativash dhe projektsh kyçe, përfshirë:

➤ **Takime dhe koordinime me qytetarët dhe institucionet:**

- ✓ Organizimi i takimeve të rregullta me qytetarët e Komunës së Deçanit për adresimin e nevojave dhe kërkesave të tyre.
- ✓ Takime të rregullta me Drejtorët e Qendrave të (QKMF, QMF, SHK, QPS).
- ✓ Takime me organizatat e ndryshme me karakter shëndetësor dhe social.
- ✓ Takime me Donatorë

➤ **Monitorimi dhe mbikëqyrja e shërbimeve:**

- ✓ Monitorimi i mbarëvajtjes së punës së personelit shëndetësor në QKMF dhe Shtëpinë e Komunitetit.
- ✓ Monitorimi i performancës së personelit në QPS.

➤ **Shqyrtimi dhe zbatimi i planeve dhe kërkesave:**

- ✓ Shqyrtimi i mjeteve të ankesave përmes rrugëve administrative.
- ✓ Zbatimi i planit të prokurimit për furnizime dhe projekte të nevojshme.
- ✓ Planifikimi dhe miratimi i buxhetit për periudhën vjetore.

Shqyrtimi i kërkesave nga QKMF, QPS, SHK dhe miratimi i tyre.

➤ **Identifikimi dhe mbështetja e grupeve në nevojë:**

- ✓ Identifikimi i nevojave sociale të familjeve me të ardhura të ulëta.
- ✓ Identifikimi dhe ndihma për personat që jetojnë në Shtëpinë e Komunitetit.
- ✓ Identifikimi i nevojave të stafit shëndetësor.

➤ **Bashkëpunim:**

- ✓ AQH (Accessible Quality Healthcare) SDC project implemented by SWIS TPH.
- ✓ Ministria e Shëndetësisë
- ✓ LMT K14 (KFOR)
- ✓ Ambasada Japoneze

➤ **INVESTIMET KAPITALE**

EMRI I PROJEKTIT	STATUSI I REALIZIMIT	VËREJTJE
Furnizimi me pajisje medicinale	✓ Realizuar	/
Pajisja me inventar në QMF,dhe AMF	✓ Realizuar	/
Furnizimi me Klima (të pajisura të gjitha qendrat)	✓ Realizuar	/
Rinovim i Shtëpisë së Komunitetit	✓ Realizuar	/
RTG	✓ Realizuar	/

➤ **MALLËRA DHE SHËRBIME**

Emri Projektit	STATUSI I REALIZIMIT	VËREJTJE
Furnizim me material administrativ për zyre për nevojat e shëndetësisë primare	✓ Realizuar	/
Furnizim me reagenca laboratorike	✓ Realizuar	/

Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna për nevojat e QKMF-së	✓ Realizuar	
Servisim i pajisjeve laboratorike Dhe medicinale tjera	✓ Realizuar	
Furnizim me material stomatologjik për nevojat e departamentit të stomatologjisë	✓ Realizuar	/
Furnizim me material higjieniko-sanitar për nevojat e shëndetësisë primare	✓ Realizuar	/
Mirëmbajtja e objekteve të shëndetësisë primare	✓ Realizuar	/
Mirëmbajtja e automjeteve	✓ Realizuar	/
Mirëmbajtja e pajisjeve	✓ Realizuar	/
Mirëmbajtja e rrjetit	✓ Realizuar	/
Furnizim për gjera ushqimore për pacientët e shtëpisë së Komunitetit	✓ Realizuar	
Furnizim me naft	✓ Realizuar	/
Sigurimi I objektit të Sherbimeve rezidenciale	✓ Realizuar	
	✓	

➤ **Prioritetet e DSHMS-së, që janë përfshirë në Planin e Veprimit të Komunës së Deçanit.**

Emri i Projektit
<i>Ndërtimi i Incineratorit</i>
<i>Ndërtimi dhe Aplikimi i energjisë eficiente në QKMF</i>
<i>Rrethojat në AMF</i>
<i>Ndriqimi i të gjitha objekteve shëndetësore</i>
<i>Investime në KPSH</i>
<i>Pajisje më inventar të ri</i>
<i>Ndërtimi i objektit për Banim Social</i>
<i>Rregullimi i parkingut në QKMF</i>
<i>Renovimi i QPS-së</i>
<i>Blerja e soft-ware për distribuim të imazheve RTG</i>
<i>Blerja dhe digjitalizimi i RTG</i>
<i>Blerja e aparaturës bashkëkohore për Laborator</i>
<i>Renovime në Shtëpinë e Komunitetit</i>

➤ ***Fushatë-vetëdijesuese për ndërgjegjësimin e kancerit të gjirit të organizuar nga DSHMS dhe Zyra e Kryetarit***

- Marrëveshje bashkëpunimi mes DSHMS dhe AVICENA;
- Pacientët e Komunës së Deçanit, kanë mundësinë të kryejnë analizat falas gjatë gjithë vitit (*duke paraqitur raportin e onkologut*);
- Gjatë muajit tetor, pacientët e QKMF-së në Komunën e Decanit do të marrin shërbimet e analizës **PapTest** falas (në Laboratorin Avicena);
- **3 Tetor**, (Hapja e Fushatës Vetëdijësuese nga Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive, Vizitë në QKMF);
- **14 Tetor**, Ligjeratë për muajin e ndërgjegjësimin të Kancerit të Gjirit;
- **23-24 Tetor**, Mamografi për gratë e Komunës së Deçanit.

Vendimi i Kryetarit të Komunës për Draft- Statutin e QKMF-së dhe të gjitha aktet nënligjore:

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka prezantuar draft-statutin e QKMF-së, në Asamblenë Komunale, duke marrë rekomandimet nga Asambleja Komunale për të vazhduar më procedurat e tjera të në bazë të legjislacioneve në fuqi.

➤ ***Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare***

- Veprimtaria e QKMF-së përfshin ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.
- Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Deçanit, t'u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirës dhe efikase, të bazuar në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe, njëherit pikë referuese për specialistët konsultat në nivelet e tjera të kujdesit shëndetësor.
- Sipas strategjisë së KPSH dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një **mjek familjar dhe dy infermiere familjare** ofron shërbime shëndetësore për 2000/2500 banorë sipas shtrirjes territoriale , gjeografike dhe organizimit të QKMF-së.

☛ **KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR NË KOMUNEN E DEÇANIT**

Komuna e Deçanit ofron shërbime të kujdesit parësor shëndetësor për **40.019** banorë të komunës. Këto shërbime ofrohen në kuadër të rrjetit të institucione shëndetësore që funksionojnë në qytet dhe viset rurale:

- **Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)** - është një institucion shëndetësor publik që ofron shërbime shëndetësore dhe implementon Mjekësinë Familjare në Deçan.
- **Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF)** - funksionojnë në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe ofrojnë shërbime shëndetësore në vendbanimet që kanë mbi 10.000 banorë.
- **Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF)** - ofrojnë shërbime shëndetësore në vendbanimet nën 10.000 banorë.

☛ **Në kujdesin parësor shëndetësor ofrohen shërbimet si në vijim:**

- ✓ Vizitat mjekësore dhe shërbime në bazë të nevojave të pacienteve si: Dhënia e terapisë parenterale: Injeksione, infuzione, pastrim, fashim, inhalim;
- ✓ Shërbime Diagnostifikuese: Analiza Laboratorike dhe Rentgen;
- ✓ Edukimi dhe promovimi shëndetësor: këshillim dhe promovim shëndetësor për pacientët me sëmundje kronike, për shëndetin oral, imunizim/vaksinim, konsulta për planifikim familjar;
- ✓ Vizita dhe shërbime për të moshuarit me sëmundje të rënda (kujdes paliativ);
- ✓ Kujdesin e vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo-ngjyçuese;
- ✓ Kujdes urgjent dhe kirurgji e vogël;
- ✓ Vaksinim dhe imunizim;
- ✓ Promovim i shëndetit oral dhe trajnimin bazik stomatologjik;
- ✓ Kujdes mjekësor në shtëpi (vizita në shtëpi në ratet urgjente, vizita dhe konsulta shtëpiake për nënat dhe fëmijët deri në tre vjeç);
- ✓ Sigurim të shërbimeve ambulantore dhe ndihmë mjekësore gjatë aktiviteteve sportive dhe kulturore.

➡ **Gjithsej numri i objekteve për KPSH-në në Komunën e Deçanit që ofrojnë shërbime shëndetësore janë:**

- 1 QKMF në Deçan
- 3 QMF, Strellc, Isniq, Irzniq
- 5 AMF, Gramaçel, Lumbardh, Prapaqan, Pobergjë dhe Ratishë.

Gjithësej numri i **laboratorëve dhe radiologjike për KPSH-në** në Komunën e Deçanit që ofrojnë shërbime shëndetësore janë 4;

- 1 QKMF në Deçan
- 1 QMF në Strellc
- 1 QMF në Isniq dhe
- 1 QMF në Irzniq.

Gjithësej numri i njësive të mjekësisë familjare të cilat përmbushin kërkesat për inventar, mjete dhe ofrimin e shërbimeve laboratorike në Deçan

✓ ***Departamenti i Mjekësisë Familjare***

Sektori i Mjekësisë Familjare i ndarë në dy ndrrime paradite dhe pasdite:

Sektori i Shëndetit Publik

- ✓ Njësia e SISH-it.
- ✓ Njësia e Imunizimit dhe Vaksinimit.
- ✓ Sektori i Shëndetit Oral.
- ✓ Sektori i Kujdesit Emergjent.
- ✓ Sektori Konsultativ.
- ✓ Njësia e Pediatriisë.
- ✓ Njësia e Gjinekologjisë dhe Maternitetit.
- ✓ Njësia e Dermatologjisë.

Sektori Diagnostikës

- ✓ Kabineti i Radiologjisë.
- ✓ Laboratori.

Departamenti i Administratës:

- ✓ Njësia apo zyra e personelit.
- ✓ Njësia apo zyra Juridike.
- ✓ Njësia apo zyra për Buxhet dhe Financa.
- ✓ Njësia apo zyra për shërbime teknike.

1. QMF (Qendra e Mjekësisë Familjare) Strellc:

- 1.1.Njësia Mjekësisë Familjare.
- 1.2.Njësia e Shëndetit Oral.
- 1.3.Njësia e Laboratorit.

2. QMF (Qendra e Mjekësisë Familjare) Isniq:

- 2.1.Njësia Mjekësisë Familjare.
- 2.2.Njësia e Shëndetit Oral.
- 2.3.Njësia e Laboratorit.

3. QMF (Qendra e Mjekësisë Familajre) Irzniq:

- 3.1.Njësia e Mjekësisë Familjare.
- 3.2.Njësia e Shëndetit Oral.
- 3.3.Njësia e Laboratorit.

4. AMF (Ambulanca e Mjekësisë Familjare) Gramaçel:

- 4.1.Njësia e Mjekësisë familjare

5. AMF (Ambulanca e Mjekësisë Familjare) Lumbardh:

- 5.1.Njësia e Mjekësisë Familjare

6. AMF (Ambulanca e Mjekësisë Familjare) Prapaqan:

6.1.Njesia e Mjekësisë Familjare

7. AMF (Ambulanca e Mjekësisë Familjare) Pobërgjë:

7.1.Njesia e Mjekësisë Familjare

8. AMF (Ambulanca e Mjekësisë Familjare) Ratishë:

Njesia Mjekësisë Familjare

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Deçan funksionon sipas orarit në vijim:

Shërbimet në QKMF	Orari i punës
Mjekësia Familjare	7:00-22:00 / 7 ditë në javë
Shërbimi Urgjent	7 ditë në javë, 24 h
Shërbimi Stomatologjik	7:00-14:00, 5 ditë në javë
Vaksinimi	7:00-15:00, 5 ditë në javë
Labortori hematologjik-biokimik	7:00-15:00, 5 ditë në javë
Diagnostika	7:00-20:00, 5 ditë në javë
Barnatorja	7:00-15:00, 5 ditë në javë
Pediatrica	7:00-15:00, 5 ditë në javë
Gjinekologia	7:00-15:00, 5 ditë në javë
Këshillimorja	7:00-15:00, 5 ditë në javë
QMF dhe AMF	7:00-15:00, 5 ditë në javë

Raporti i Vizitave dhe Shërbimeve Shëndetësore në QKMF

Numri i Vizitave dhe shërbimëve shëndetësore sipas grupmoshave për muajin Janar - Dhjetor 2024

Nr. Rendor	Departamenti (SHERBIMI)	Vizitat															Vizita Shtëpiake	
		Ne ordinancë														Sherbimet tjera shendetesore (infermieri),	Mjeku	Punëtor et tjere shendet
		Mjeku																
		Gjithsej	Vizitat e para sipas moshës															
Gjithsej	< 1 vjet		1 - 5	6 - 9	10 - 14	15 - 19	20 - 24	25 - 34	35 - 44	45 - 54	55 - 64	65+ vjet	Panjoher					
1	Mjekësia Familjare	0	51242	465	2383	1662	2511	3183	3859	4837	5973	7420	8418	10531	0	56402	0	0
2	Pediatria	0	8837	1267	3116	2059	1892	431	68	1	0	2	0	1	0	4909	0	0
3	Gjinekologji	0	4824	0	2	4	22	265	500	855	1029	831	726	590	0	2395	0	0
4	Vaksinimi + Covid 19	0	4722	1050	562	442	457	301	49	72	71	155	419	1144	0	8724	0	0
5	Laboratori (DSM+Rt Pcr)	0	9650	411	592	504	542	357	309	613	798	1518	1901	2105	0	241360	0	0
6	Radiologji - Rtg	0	3249	0	5	37	112	92	142	226	367	560	651	1057	0	319	0	0
7	Emergenca	0	32012	1676	2292	2811	3017	3282	3307	3546	3469	3082	3057	2473	0	170379	0	0
8	Fiziatri-Vizitat	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.	Realizimi i planit 6 mujor i punës së Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Korrik - Dhjetor	DBPZHR	DBPZHR
2.	Përcjellja e fushatës së korrje-shirjeve	Korrik	DBPZHR	DBPZHR
3.	Takime zyrtare me MBPZHR dhe ministri të tjera, OQ dhe OJQ	3-Takime	DBPZHR	DBPZHR, MBPZHR dhe ministrinë të tjera, OQ dhe OJQ
4.	Takime me Organizatën për Sera	Gjatë vitit	DBPZHR	DBPZHR
5.	Vlerësimet e dëmeve në bujqësi	Tetor - Dhjetor	Komisioni komunal i dëmeve	3 nga Drejtorinë me komisionet e tyre
6.	Dhënia e pëlqimit për 5 kërkesa për Shndërrimin e tokës bujqësore ne tokë ndërtimore	Korrik - Dhjetor	DBPZHR	DBPZHR, MBPZHR
7.	Raporti për fushatën e korrje-shirjeve-2024	Gusht	DBPZHR-zyrtari me staf	DPBZHR,MPPZHR, fermerët dhe autokombanjerët
8.	Përcjellja e kulturave pranverore	Korrik - Dhjetor	DBPZHR-zyrtari	DPBZHR dhe fermerët
9.	Grumbullimi i të dhënave, rezultateve të prodhimtarisë bujqësore	Korrik - Nëntor	DBPZHR-zyrtari dhe stafi	DPBZHR, MPPZHR dhe fermerët

10.	Kontakte dhe vizita në fermat prodhuese - Mbi 30 vizita te fermat individuale	Korrik - Dhjetor	DBPZHR-stafi	DPBZHR, MPPZHR dhe fermerët
11.	Përfundimi i programeve zhvillimore: -Memorandumi MBPZHR – Komuna Deçan për ndërtimin e tri kanaleve te ujitjes -Përcjellja e realizimit dhe sanimi i pengesave në realizimin e punimit të kanaleve në ndërtim	Korrik - Dhjetor	DBPZHR-stafi Komuna	DPBZHR, MPPZHR dhe fermerët Komuna
12.	Trajnime në Menaxhimin e Integruar	Gjatë tërë vitit	DBPZHR QIKB	DPBZHR, MPPZHR
13.	Aktivitete në Qendrën Informative Komunale të Bujqësisë • 116 konsulta dhe këshilla për fermer • 18 vizita në teren-pemëtarë • 15 vizita në shtalla • 5 vizita ne sera	Korrik - Dhjetor	DBPZHR dhe këshilltari	QIK DSHK Këshilltari publik i Shërbimeve Këshillues të Kosovës
14.	Organizimi i stafit për Pagesat Direkte pas përfundimit te aplikimit Aplikimi për pagesa direkte aplikimit Aplikimi për pagesa direkte për qumësht, plehut artificial, viça për majmëri dhe grurit për KG, ku janë 515 fermer aplikues-Faza e parë	Korrik - Dhjetor	DBPZHR dhe stafi	DPBPZHR-MBPZHR-AZHB-ja

15.	Ndihma për fermerët aplikues në Grande-2024	Gjatë kohës së aplikimit	DBPZHR QIKB	
16.	Ndihmë në organizimin e Ditës së Gështenjës dhe prodhimeve bujqësore	Tetor	DBPZHR dhe stafi	DBPZHR dhe stafi
17.	Menaxhimi i projektit Mëshqerra: Finalizimi i projektit Vizita tek fermerët përfitues	Korrik - Nëntor	Donatori Kryetari DPBZHR	DBPZHR dhe donatori
18.	Është përpiluar raporti për mbjellat vjeshtore 2024-25	Gusht - Shtator	DBPZHR	DBPZHR, MBPZHR
19.	Vizita brenda dhe jashtë Kosovës Shkëmbim i Përvojave	Korrik - Dhjetor	DBPZHR	DBPZHR, MBPZHR
20.	Trajnime: Në kuadër të projektit : “Zhvillimi I Zonave Rurale përmes Avancimit të shërbimeve Këshillimore të financuar nga MBPZHR dhe implelementuar nga Qendra Kosovare për Zhvillim-KDC.	Korrik - Dhjetor	DBPZHR-QKZH-KDC	DBPZHR-QKZH-KDC-MBPZHR
21.	Organizimi i stafit për aplikimin e fermerëve për Sera	Nëntor - Dhjetor	DBPZHR	DBPZHR dhe Donatori
22.	Numri i lëndëve të shqyrtuara nga Drejtoria: - Nr. i lëndëve 113 - Të miratuara 88	Janar - Dhjetor	DBPZHR-shefi i sektorit	Drejtori

	- Në proces 5 - Të refuzuara 5 - Hedhur poshtë 9 - Ceduar 0 - Pezulluar 2 - Anuluar 4			
--	--	--	--	--

➤ **Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike**

- SEKTORI PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Janar - Dhjetor 2024 aktivitetin e vet të planifikuar nga lëmi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit e ka realizuar duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 04/L-027, Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 04/L-012, Ligjin për Zjarrfikëse dhe Shpëtim Nr. 04/-L-049, Udhëzimet Administrative si dhe Aktet tjera normative të cilat e rregullojnë këtë fushë.

Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, konkretisht Sektori për Mbrojtje, Shpëtim ka arritur që ti kryej punët dhe detyrat e planifikuara rreth parandalimit, evitimit, rekomandimeve të rreziqeve të mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Gjashtë mujorin e parë të vitit, territorin e Komunës së Deçanit e kanë përcjell situata emergjente të natyrave të ndryshme si: vërshime, breshër, etj.

Sektori për Mbrojtje Shpëtim është marrë edhe me punë e detyra tjera që dalin nga objektivat dhe planifikimet e drejtorisë në mënyrë periodike ashtu siç janë të planifikuara në Planin e Punës për vitin 2024.

Raporti gjashtë mujor do të përmbajë punët e planifikuara sipas planit vjetor, situatat emergjente, planet të reja të punuara, dokumentet e nevojshme ku të gjitha këto do të jenë të përpiluara në formë tabelare në baza mujore dhe vjetore:

<u>Nr.</u>	<u>Aktivitetet</u>
1.	Përgatitja e planeve të punës, raportin vjetor dhe dokumente tjera bazike për vitin 2024
2.	Përgatitja e Dokumentacionit (lëndëve të miratuara) për Arkivim
3.	Janë inspektuar lumenjtë, përroskat, urat dhe pikat vërshuese në të gjithë territorin e komunës së Deçanit, janë bërë vlerësimet dhe janë dokumentuar në Planin “Pikat më vërshuese nga të reshurat atmosferike në territorin e Komunës së Deçanit si dhe gjendja e urave në tërësi”
4.	Gjatë 6 mujorit të parë është përgatitur “Plani – Objektet e vjetra që paraqesin rrezik për qytetarët nga shembja në territorin e Komunës së Deçanit”.
5.	Takimi i I-rë i KKSB-së
6.	Furnizimi dhe montimi i 10 (dhjetë) hidrantëve në 10 fshatra të Komunës së Deçanit
7.	Pjesëmarrje në punëtori, trajnime - Trajnim “Vlerësimi i rreziqeve” - Trajnim “Zvogëlimi i rreziqeve” - Punëtorinë një-ditore me temën “Vlerësimi i Rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë” - Punëtorinë "Hartat e rrezikshmërisë nga vërshimet dhe hartat e rrezikut nga vërshimet për të gjitha pellgjet e lumenjve në Kosovë"
8.	Është miratuar propozim vendimi nga Asambleja Komunale për themelimin e grupit punues për azhurnimin e Planit “Vlerësimi i rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit 2023-2028”
9.	Me 24 Qershor, pas reshjeve të mëdha të shiut dhe alarmimit nga qendra 112, ekipet emergjente të Drejtorisë kanë intervenuar në zhbllokimin e rrugës magjistrale Deçan- Pejë konkretisht te rruga “Bajram Kapitaj”. Gjithashtu, nga breshëri i madh janë shkaktuar dëme të mëdha në bujqësi. Komisioni për vlerësimin e dëmeve, ka dal në teren dhe ka bërë identifikimin e parcelave të dëmtuara dhe raporti i vlerësimit është duke u hartuar.

10.	Gjatë gjashtë muajve të parë, Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Sh. Publike ka pranuar 130 kërkesa në Intranet ku 103 janë miratuar, 2 refuzuar, 0 anuluar, 4 pezulluar dhe 17 janë në proces.
11.	Takimi i II-të i KKSB
12.	Furnizimi dhe mirëmbajtja e aparateve për shuarjen e zjarrit për të gjitha institucionet publike.
13.	Njoftim/ apel qytetareve për vetëdijesim dhe kujdes nga zjarret. Njoftimi është bërë në formë të shkruar ku është shpërndarë në tërë territorin e Komunës së Deçanit. Shih linkun: https://www.facebook.com/photo?fbid=997306002405308&set=a.324214523047796
14.	Ka vazhduar projekti për mirëmbajtjen dhe zgjerim i rrjetit në Komunën e Deçanit.
15.	Pjesëmarrje në punëtori, trajnime Trajnim “Vlerësimi i rreziqeve” 3-5 Prill
16.	Takime të rregullta me Policinë, Kfor-in dhe organizata tjera
17.	Komunikim i vazhdueshme dhe bashkëpunim me QRAKE-Pejë
18.	Njoftim/ apel qytetarëve për vetëdijesim dhe kujdes nga zjarret. Njoftimi është bërë në formë të shkruar ku është shpërndarë në tërë territorin e Komunës së Deçanit. Shih linkun: https://www.facebook.com/1436712959903376/videos/1127220677787611/

REALIZIMI I NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË INTERVENIMEVE, STRUKTURA E ZJARREVE DHE INT.TJERA PËR VITIN - 2024

2024	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i intervenimeve Teknike	Aksidente rugore	Pastrim ruge	Vërshime	Të rrejsh	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
Janar	5	2	3		3								
Shkurt	19	16	3		2								
Mars	6	6	0										
Prill	9	7	2		2								
Maj	2	0	2		1								
Qershor	13	11	2	1	1								
Gjithsejtë	54	42	12	1	9								

KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2024														
	Lloji I INTERVENIMIT	Jan.	Shku.	Mar.	Prill	Maj	Qersh	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nënt.	Dhje.	GITHËSEJ
1	ZJARRE	2	16	6	7	0	11							
2	INTERVENIME TEKNIK	3	2		2	1								
3	SHËRBBIME		1			1								
4	AKSIDENTE KOMUNIKACIONI						1							

5	VËRSHIME													
6	ALARME TË RREJSHME													
1. Llojet e zjarreve;														
1.1	Shtëpi	1	1		1									
1.2	Objekte kolektive (banesa)													
1.3	Malore	1			2		3							
1.4	Fushore		12	5	3		4							
1.5	Stalla te bagëtime													
1.6	Oxhaqe													
1.7	Automjete motorike/vetura						3							
1.8	Shtylla elektrike / trafo	1	2	1										
1.9	Pajisjet shpërndarëse													
1.11	Mbeturina		1		1									
1.12	Operator/biznese													
1.13	Institucione publike						1							
	Të tjera													

Ndarja analitike e zjarreve në: SIPËRFAQE TË HAPURA														
4.1		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
	Mal													
4.2	Sipërfaqja e djegur (hektar)				10 ha		0.50 ha							10.50 ha
4.3	Fushor													
4.4	Sipërfaqja e djegur (hektar)		10.3 ha	4.9 ha	10.3 ha		3 ha							28.5 ha

- SEKTORI PËR SHËRBIME PUBLIKE

Sektori për Shërbime Publike në kuadër të organizimit dhe të strukturës së tij mbi punën dhe aktivitetet, është i organizuar më organogram: Shef i Sektorit të Shërbimeve Publike, Zyrtar për ndërtim, Zyrtar për Transportin Publik, Zyrtar për Menaxhimin e mbeturinave, duke kryer edhe punë dhe detyra tjera shtesë që dalin nga drejtoria.

Sektori i Shërbimeve Publike sipas planifikimeve vjetore nga drejtoria, detyrat parësore kanë qenë realizimi i projekteve në infrastrukturën rrugore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e tyre, menaxhimi i mbeturinave, mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik, ndërtimi i trotuareve, shesheve, ndërtim dhe mirëmbajtje të kanalizimit, mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe ndërtimin e lapidareve të Dëshmorëve, kujdesi për hapësirat publike në tërë territorin e komunës së Deçanit, kanalizimin e qytetit dhe detyra të tjera dytësore që dalin gjatë vitit. Po ashtu pjesë e aktiviteteve janë edhe punët e përbashkëta që janë me ndërmarrjet komunale dhe regjionale siç është Kompania NPL “Higjiena”, kompania regjionale e ujësjellësit “Hidrodrini”, Ndërmarrja regjionale për ujitje të tokave “Drini i Bardhë”. Sektori i Shërbimeve Publike po ashtu ka bashkëpunim me KEDS-in - Njësia Deçan.

Koordinim dhe bashkërendim të punëve dhe aktiviteteve, me theks të veçantë ka pasur me NPL “Higjiena”, ku shumicën e punëve të menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike, mirëmbajtjen dhe rregullimin e varrezave dhe lapidarëve të Dëshmorëve, i ka kontraktuar me kontratën “Në Shtëpi”.

Raporti i punës do të bartë në vete të gjitha të dhënat për punët e kryera, në formë tabelare dhe tekstuale gjatë gjithë vitit siç kanë qenë të planifikuara gjatë vitit paraprak.

Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja gjatë vitit 2024



Asfaltimi i rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit Janar - Qershor 2024

Nr.	Vendi dhe emri i rrugës	Km
1.	Ka vazhduar LOT III	
	Dashinoc	3.2 km
	Ledina	1.5 km

2.	Përgatitja e rrugëve për asfaltim ne fshatin Lumbardh	/
3.	Vazhdojnë punimet në shtratin e lumit dhe trotualet përgjatë lumit Lumbardh	
<u>Gjithsej:</u>		<u>4.7km</u>

Projektet

Projektet	Projekt i përfunduar/ në vazhdim
Ndërtimi dhe asfaltimi, LOT III – rrugët dytësorë në fshatra	në vazhdim
Ndërtimi i fshatit turistik “Laku i Kryqes”	në vazhdim
Ndërtimi i fshatit turistik “Podi i Gështenjave”	në vazhdim
Ndërtimi, rekonstruimi dhe mirëmbajtja kapitale e rrugëve verore dhe dimërore	në vazhdim
Renovimi i objektit te zjarrfikëseve	në vazhdim
Ujësjiellësi në Bjeshkën e Madhe dhe bjeshkët tjera	në vazhdim
Zgjerimi i ndriçimit eficient publik neper fshatra: Baballoq, Shaptej , Dobovik, Ratish i Epërm, Ratish i Poshtëm, Papiq, Maznik, Dashinoc, Hulaj, Lëbusha, Lumbardh, Lluca e Epërme, Prapaqan, Ratavicë, Vranoc i Vogël, Ledina dhe Jasiq i Ri.	Një pjesë e projektit ka përfunduar, vazhdon projekti edhe në fshatra tjerë.
Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i hapësirave brenda në oborret e Qendrës Rinore, Higjienës dhe Kolonisë së Artisteve dhe Shtëpisë Alpine	në vazhdim

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Pleqe	në vazhdim
Ndërtimi i trotuarit në rrugën “Blerim Dervishaj” Irzniq	në vazhdim
Ndërtimi i rrugës Bjeshka e Madhe (Laku i Kryqës) – faza e parë	në vazhdim
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe impiantit për fshatin Drenoc	
Deçan, rr. “Manastiri” shëtitëria, kanali, muri mbrojtës, ulëset si dhe ndriçimi.	
Vazhdon ndërtimi i kanalizimit në fshatin Drenoc	në vazhdim

Mirëmbajtja verore dhe dimërore

Rrugët në territorin e Komunës së Deçanit mirëmbahen rregullisht si gjatë sezonit veror ashtu edhe dimëror.


Ujësjellësi

Vazhdon bashkëpunimi me Kompaninë Regjionale të Ujësjellësit “Hidrodrini”.

Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik

Edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, ka vazhduar zgjerimi i ndriçimit publik eficient në fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Deçanit.

Aktivitetet e Komunës bashkë me N.P.L “Higjiena” - Kontrata “Në shtëpi”



Ndër aktivitetet kryesore Komuna e Deçanit konkretisht Sektori për Shërbime Publike e ka pasur me Ndërmarrjen Publike Lokale “Higjiena” me punët e kontraktuara sipas kontratës “Në Shtëpi”.

Me poshtë do ti paraqesim punët dhe aktivitetet në shumë fusha së bashku me N.P.L. Higjiena si:

Mirëmbajtja e hapësirave publike

Komuna e Deçanit në bazë të dy kontratave me kompanitë e kontraktuara, ka bërë mirëmbajtjen e hapësirave publike duke përfshirë mbjelljen, ujitjen, mirëmbajtjen e mobilierisë urbane, riparimi i shtigjeve me kubëza, pastrimi dhe fshirja e rrugëve kryesore dhe trotuareve në qytet, kositja e parqeve, prerja e vegjetacionit, sanimi i gropave dhe riasfaltimi i tyre, si dhe pune me ekskavator sipas kërkesës së Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

Dekorimi i qytetit për festat zyrtare dhe festa tjera

Dekorimi i qytetit për të gjitha festat zyrtare, vendosja e flamujve, ndërrimi i flamujve, vendosja e shtyllave të flamujve, dekorimi i qytetit për festat e fund vitit dhe dekorime tjera sipas kërkesës dhe nevojave nga D.M.SH.SH.P.

Mirëmbajtja e kanalizimit

Mirëmbajtja e kanalizimit të ujërave të zeza, gropave septike dhe nyjave sanitare në territorin e Komunës së Deçanit, zhbllokimi i pusetave dhe pastrimi i tyre, zbrazja e gropave septike, gërmimi, furnizimi, ndërrimi i gypave deri me funksionalizimin e plotë të ujërave të zeza. Zhbllokimi dhe pastrimi i pusetave të kanalizimit të ujërave atmosferike. Vendosja e kapakëve të pusetave të kanalizimit të ujërave të zeza metalike dhe të betonit etj.

Mirëmbajtja e lapidarëve, memorialëve dhe varrezave të Dëshmorëve dhe varrezave publike

Plani për mirëmbajtjen e lapidarëve, memorialëve dhe varrezave të dëshmorëve, pastrimi, mirëmbajtja e tyre, mbjellja e barit në parqet e tyre, renovimi i pllakave të dëmtuara, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese përreth kompleksit të dëshmorëve duke përfshirë prerja dhe kositja e barit, largimi i mbetjeve mes pllakave apo gurëve si dhe rregullimi i pemëve dekorative. Ndërrimi i ulëseve, vendosja e ulëseve te reja, shportat e mbeturinave si dhe mirëmbajtja e rrethojave etj.

Mirëmbajtja e varrezave publike në gjithë territorin e komunës së Deçanit.

Eliminimi i deponive ilegale

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 është bërë identifikimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe janë marr masat për eliminimin e tyre, gjithsej janë larguar gjashtë (6) deponi, gjithashtu është përgatitur dhe dorëzuar raporti vjetor për Agjencionin e Mbrojtjes së Mjedisit AMMK.

Punë dhe aktivitete tjera sipas D.SH.P.-së

Gjatë periudhës Janar- Qershor është bërë vazhdimi i kontratave me lokalet afariste për shfrytëzimin e hapësirave publike. Aktivitetet dhe punë tjera shtesë të pa planifikuara si: ndërhyrjet në pikat e rrezikut nga vërshimet, pastrimi gjatë vitit i PGM-ve(Pikave të grumbullimit të mbeturinave), kanalet e ujitjes, prerja e vegjetacionit etj.

Pjesëmarrje në punëtori, trajnime

- AMMK- GIZ Aftësimi për përditësimin e Web-app, lidhur me raportimin vjetor ne AMMK 6 Mars
- Trajnim “Vlerësimi i rreziqeve” 3-5 Prill
- Trajnim “Zvogëlimi i rreziqeve” 11-12 Prill

- Punëtorinë një-ditore me temën “Vlerësimi i Rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë” 22 Maj
- Punëtorinë "Hartat e rrezikshmërisë nga vërshimet dhe hartat e rrezikut nga vërshimet për të gjitha pellgjet e lumenjve në Kosovë" 29 Maj
- Seminari “Ngritja e Kapaciteteve për Menaxhimin e Mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshe Faza2” 12 Qershor
- Takimi nismëtar për strategjinë e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 19 Qershor

Transporti Rrugor – Publik

Gjashtë muajt e parë të 2024 është bërë përcjellja e rregullt e linjave të transportit publik urban dhe rural në qytetin e Deçanit dhe fshatrat e tij.

Është bërë vazhdimi i lejeve dhe licencave për taksitë dhe kombi-busët, që operojnë në Komunën e Deçanit. Mbikëqyrja dhe vendosja e shenjave të komunikacionit si ato horizontale ashtu edhe vertikale sipas planifikimeve dhe nevojave si në qytet ashtu edhe në fshatra.

Bashkëveprim dhe koordinim me Policinë në raste të veçanta dhe kërkesa të ndërsjella. Si dhe punë dhe detyra tjera sipas planifikimit nga plani vjetor.

Nr.	Përshkrimi i detyrave	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
1.	Bashkëpunimi me subjektet me rendësi të veçantë Policin e Kosovës, Inspektoratin etj.	1	0	2	0	0	1
2.	Mbikëqyrja dhe kontrolli i masave të parapara ligjore kundër transporteve ilegale dhe të atyre që nuk e respektojnë orarin e përcaktuar nga organi kompetent.	2	0	3	2	3	5
3.	Caktimi i linjave për bartjen e udhëtareve në trafikun urban, vazhdimi i lejeve për transportin e udhëtareve.	1	0	0	0	0	0

4.	Dhënia e pëlqimit për regjistrimit e taksistëve sipas rregullores se komunikacionit.	6					
5.	Kontrollimin e transportit të udhëtareve dhe mallrave.						
6.	Kontrolli i vendqëndrimeve të caktuar për taxi nga shfrytëzuesit e tyre.	10 gjatë vitit					
7.	Mbikëqyr rendin dhe orarin e udhëtimit nga operatorët për transportin e udhëtarëve.	1	1	1	1	1	1
8.	Përkujdesja për shënjimin vertikal dhe horizontal të rrugëve lokale.	Gjatë vitit					
9.	Lëshimi i lejeve për vendosjen e pengesave në rrugë dhe prerja e asfaltit për shtrirjen e kanalizimit, ujësjellësit.	0	0	2	4	1	3
10.	Lëshimi i vërtetimeve për student dhe punëtorët administrativ.	5	4	1	3	3	4
11.	Përgatitja e procesverbaleve, aktvendime, dhe kërkesa për gjykatat kompetente.			3			

➤ Drejtoria për Inspektion

Drejtoria për Inspekcione e Komunës së Deçanit gjegjësisht inspektorët e kësaj drejtorie, gjatë vitit kalendarik 2024 kanë kryer punët dhe detyrat e punës konform Ligjeve dhe akteve nënligjore si dhe rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të Punës së Drejtorisë për vitin 2024.

Në kuadër të Drejtorisë për Inspektion janë sistemuar këta zyrtarë:

- Inspektori i Tregut

- Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit
- Inspektori i Ndërtimit (me Kontratë mbi shërbimet e Veçanta)
- Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta)
- Zyrtarja Administrative

Inspektorët përkatës sipas profesioneve të tyre kanë vepruar duke kryer inspektime (kontrolle, mbikëqyrjeje) ndaj veprimtarive tregtare, ekonomike, në fushën e mjedisit, afatizimin e prodhimeve bujqësore, si nga produktet qumështit dhe me prejardhje shtazore të mishit, duke synuar në atë të shëndetit publik, mjedisit, në ushtrimin e këtyre veprimtarive në pajtim me kërkesat e detyrueshme të përcaktuara në legjislacionin e Republikës së Kosovës;

Drejtoria e Inspektionit ka kryer inspektime të përbashkëta me: Stacionin e Policisë, Komisionin për Miniera dhe Minerale, me Inspektoratin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë e komunës ku këto inspektime kanë pasur për qëllim racionalizimin dhe koordinimin e veprimeve inspektuese.

Gjithashtu inspektimet e planifikuara – janë inspektimet të realizuara sipas planit të punës dhe planit të monitorimit; Inspektimi i paplanifikuar ka përfshirë edhe procesin e inspektimeve i cili paraqitet ad-hoc dhe sipas nevojës pozitive zyrtare profesionale të inspektorit;

Janë kryer edhe inspektimi sipas kërkesave të personave fizik dhe juridik – janë inspektime të realizuara në bazë të paraqitjes së kërkesave.

Ri-inspektimi – është inspektimi përcjellës që kryhet gjatë dhe pas kalimit të afatit të caktuar nga inspektori lidhur me përmbushjen e urdhrit apo kërkesave për eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë inspektimit.

Këshilla inspektuese të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të legjislacionit në fuqi dhe eliminimit të gjeturave subjekti inspektues si dhe marrjen e masave administrative dhe shqiptimit të gjobave që kanë për qëllim shmangien e rreziqeve që mund t'i shkaktohen shëndetit publik, sigurisë publike dhe mjedisit dhe interesave të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë, të përcaktuara nga ligjet apo me ligje të veçanta.

Në kuadër të drejtorisë janë marrë masa administrative nga zyrtarja që ka qenë përgjegjëse për lëshimin e fletëpagesave, taksave administrative, gjobave mandatorë përmes sistemit të Intranetit varësisht prej Ligjeve, Udhëzimeve Administrative dhe Rregullores Komonale në secilën fushë përkatëse të inspektimit. Duhet të theksohet edhe se janë kryer edhe punë tjera sipas fushe veprimtarisë të secilit nga inspektorët.

Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve:

Pozita zyrtare	Inspektime në teren sipas detyrës zyrtare	Inspektime sipas kërkesë-personave fizik dhe juridik	Aktvendime	Gjoha mandatorë	Inspektime për leje të ndërtimit	Inspektime për leje mjedisore	Kërkesa për gjykatë
Inspektorja për mbrojtje të mjedisit	55	137	21	20	19	12	6
Inspektori i tregut	88						
Zyrtarja administrative (asistime)	76						
Inspektori i ndërtimit	52						
Inspektori i Veterinë	37						
Gjithsej	308	137	21	20	19	12	6

➤ Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim gjatë vitit 2024 ka realizuar aktivitete të mëposhtme:

Gjatë vitit 2024, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, në përputhje me fushën e saj të veprimtarisë, ka ofruar punë dhe shërbime zyrtare të bazuar në Statutin e Komunës së Deçanit. Këto veprimtari janë zhvilluar në harmoni me ligjet e Kuvendit të Kosovës, aktet nënligjore, rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal në Deçanit, si dhe dokumenteve strategjike dhe planin e punës për vitin 2024. Punët dhe shërbimet

e Drejtorisë kanë përfshirë hartimin dhe realizimin e politikave zhvillimore, marrjen e masave për të nxitur zhvillimin ekonomik të Komunës së Deçanit, si dhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, për një zhvillim sa më të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Aktivitetet kryesore kanë përfshirë:

1. Hartimin e politikave të zhvillimit ekonomik për Komunën.
2. Bashkëpunimin me organet e tjera komunale për informim rreth planeve zhvillimore.
3. Kryerjen e analizave që shërbejnë si bazë për planet zhvillimore.
4. Caktimin dhe propozimin e prioritetëve të zhvillimit në fusha të ndryshme, veçanërisht në fushën e turizmit.
5. Organizimin e ekipeve të ekspertëve të ndryshëm për hartimin e planit të zhvillimit ekonomik në nivel komunal dhe për hartimin e projekteve kapitale për të përfituar donacione.
6. Hartimin e strategjisë së zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë të Komunës.
7. Bashkëpunimin me organet relevante në nivelin lokal dhe qendror.
8. Bashkëpunimin me ekspertë të fushave të ndryshme për të përfituar nga përvojat dhe njohuritë e tyre në zhvillim.
9. Dhënien e këshillave me interes për ekonominë private-reale.
10. Pjesëmarrjen në seminare dhe promovime me karakter zhvillimor.
11. Kryerjen e detyrave të tjera në fushën e zhvillimit ekonomik.

Këto përpjekje të drejtorisë kanë qenë të fokusuara në përmirësimin e klimës së të bërit biznes, promovimin e Komunës së Deçanit si një destinacion atraktiv për investitorët dhe turistët, si dhe në mbështetjen e ideve inovative dhe projekteve të reja, duke ofruar gjithmonë shërbime dhe konsulencë profesionale.

Aktivitetet e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim gjatë vitit 2024

Përmbledhje e mbarëvajtjes dhe ecurisë së punës

Në vitin 2024, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ka angazhuar resurset e saj për të mbështetur dhe lehtësuar zhvillimin e sektorit të biznesit në Komunën e Deçanit, me synimin për të krijuar një mjedis më të mirë për sipërmarrësit dhe për të nxitur rritjen ekonomike. Aktivitetet kryesore kanë përfshirë:

1. Regjistrimi i bizneseve fillestare, duke përfshirë bizneset individuale, shoqëritë aksionare, ortakëritë e përgjithshme dhe të kufizuara, shoqëritë e huaja tregtare, ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat bujqësore.
2. Procesimi i ndryshimeve në të dhënat e bizneseve ekzistuese.
3. Pajisja e bizneseve me çertifikata të reja me Numër Unifikues të Identifikimit (NUB), si një masë për të rritur transparencën dhe efikasitetin në menaxhimin e bizneseve.
4. Dhënia e informacioneve shtesë dhe udhëzuese për bizneset, për të ndihmuar në navigimin e tyre nëpër proceset ligjore dhe rregullatore.
5. Protokollimi i të gjitha çështjeve ligjore dhe administrative që lidhen me bizneset, duke siguruar një menaxhim të qartë dhe të dokumentuar të këtyre çështjeve.
6. Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve të rregullta, javore dhe mujore, tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), për të siguruar një linjë të qartë komunikimi dhe raportimi.
7. Lëshimi i vërtetimeve për individët që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore, duke u mundësuar atyre të vërtetojnë statusin e tyre si jobiznismenë.
8. Sigurimi i vërtetimeve për bizneset që nuk kanë borxhe apo obligime ndaj taksave komunale, duke i ndihmuar ato të vazhdojnë operacionet e tyre pa pengesa ligjore.
9. Shqyrtimi dhe trajtimi i kërkesave, ankesave dhe çështjeve të tjera që vijnë nga bizneset, duke ofruar zgjidhje dhe këshilla profesionale.
10. Përcaktimi dhe zbatimi i taksave komunale për bizneset, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e vendosura.
11. Ofrimi i konsulencave dhe ndihmës së specializuar për bizneset, për të nxitur zhvillimin dhe zgjerimin e tyre.
12. Angazhimi dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme, duke kontribuar në vendimmarrje dhe politika zhvillimore që prekin sektorin e biznesit.

Me këto veprime, Drejtoria ka synuar të forcojë mjedisin e biznesit në komunë, të nxisë krijimin e vendeve të reja të punës dhe të përmirësojë klimën ekonomike përgjithësisht, duke vënë theksin në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Statistikat e Regjistrimit dhe Shërbimeve të Bizneseve nga Zyra për Biznese 2024

Gjatë vitit 2024, Zyra për Biznese në Komunën e Deçanit ka regjistruar një rritje të konsiderueshme në numrin e bizneseve të reja. Nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, janë regjistruar gjithsej 102 biznese të reja. Këto biznese, sipas deklaratave të tyre, kanë punësuar 127 punonjës, duke kontribuar në rritjen e punësimit në komunë. Për të lehtësuar procesin e regjistrimit dhe për të ofruar një mjedis të përshtatshëm për sipërmarrësit, bizneset fillestare janë pajisur brenda ditës me certifikatën e biznesit që përmban Numrin Unik të Identifikimit të Biznesit. Poashtu, janë ofruar konsulenca të ndryshme për të ndihmuar bizneset në të gjitha ndryshimet e nevojshme ligjore dhe administrative.

Detajet mbi numrin e bizneseve të regjistruara në bazë të llojit të pronësisë janë si më poshtë:

- **Biznes Individual:** 34
- **Ortakëri e Përgjithshme:** 0
- **Ortakëri e Kufizuar:** 0
- **Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar:** 68
- **Shoqëri Aksionare:** 0
- **Ndërmarrje në Pronësi të Huaj:** 0
- **Ndërmarrje Publike:** 0
- **Kooperativë Bujqësore:** 0
- **Totali:** 102

Përveç regjistrimit të bizneseve të reja, Zyra për Biznese ka trajtuar edhe një numër të kërkesave dhe ndryshimeve në bizneset ekzistuese. Detajet e shërbimeve dhe kërkesave janë si vijon:

1. **Shuarje të Bizneseve:** 17
2. **Kërkesë për Shtimin apo Heqjen e Aktivitetit:** 31
3. **Kërkesë për Informata:** 134
4. **Kërkesë për Shtim apo Ndryshim të Njesisë:** 6
5. **Kërkesë për Ndryshim të Adresës:** 12
6. **Kërkesë për Ndryshimin e Drejtorit apo Përfaqësuesit të Autorizuar:** 7
7. **Kërkesë për Certifikatë Dublikat:** 5
8. **Kërkesë për Ndryshim Emrit Tregtar:** 3
9. **Kërkesë për Ndryshim të Kapitalit:** 0
10. **Kërkesë për Ndryshimin e Pronarëve/Aksionarëve:** 12
11. **Çertifikata të Reja për Biznese Fillestare:** 102
12. **Çertifikata të Ripërtërira me Numër Unik:** 102
13. **Vërtetime për Persona Fizik që nuk Ushtrojnë Veprimtari Jo-Biznesore:** 21
14. **Vërtetime për Persona Fizik që nuk Ushtrojnë Veprimtari Biznesore:** 16

Këto statistika dhe aktivitete dëshmojnë angazhimin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në mbështetjen e sipërmarrjes dhe në rritjen e ekosistemit të biznesit në Komunën e Deçanit. Përpjekjet e vazhdueshme për të ofruar shërbime efikase dhe të përshtatshme bizneseve kontribuojnë në një mjedis më të mirë për zhvillimin ekonomik të komunës.

Gjatë vitit 2024, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Deçanit angazhoi një sërë iniciativash me synimin për të forcuar zhvillimin ekonomik dhe social në rajon. Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- **Takime strategjike:** U organizuan takime me përfaqësues të institucioneve qendrore, organizatave vendore dhe ndërkombëtare për të arritur marrëveshje dhe bashkëpunime. Qëllimi ishte të sigurohet mbështetje dhe financim për projekte zhvillimore që do të kontribuojnë në rritjen ekonomike të Komunës së Deçanit dhe të sektorit privat.
- U organizuan takime me përfaqësues të institucioneve qendrore, organizatave vendore dhe ndërkombëtare për të arritur marrëveshje dhe bashkëpunime. Qëllimi ishte të sigurohej mbështetje dhe financim për projekte zhvillimore që do të kontribuojnë në rritjen ekonomike të Komunës së Deçanit dhe të sektorit privat.
 - Takim i Kolegjiut për Zhvillim Ekonomik (Asociacioni i Komunave të Kosovës)
 - Me kërkesë të Rektorit, Prof. Dr. Armand Krasniqi, pjesëmarrje në takimin e parë koordinues për implementimin e aktiviteteve të bazuara në memorandume bashkëpunimi ndërmjet komunave, universitetit dhe forumit ekonomik rajonal Dukagjini (FERD).
 - Marrëveshje mirëkuptimi midis Komunës së Deçanit dhe CDF.
 - Memorandum bashkëpunimi me Swisscontact për certifikimin dhe trajnimin e stafit për Via Ferrata.
 - Takim me përfaqësues nga CELIM për aktivitetet në vazhdim në kuadër të projektit NaturKosovo nga CELIM, me drejtuesin Nicola Bassi.
- **Trajnime dhe panele edukative:** Drejtoria është përfshirë në disa programe trajnimesh dhe panele edukative për të rritur kapacitetet e stafit dhe për të përmirësuar menaxhimin e projekteve.
 - Trajnim Online "Hartimi dhe Menaxhimi i Projekteve" sipas formatit të BE-së, organizuar nga TBD Consulting (2 javë).
 - Trajnimet 2-ditore me temën "Menaxhimi i Qëndrueshëm i Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore" të projektit "Rilindja Kulturore nga Liqeni i Shkodrës në Kosovë - "TIME TRAVEL", organizuar në fshatin Belle.
 - Trajnime për personelin që punon në atraksione turistike në kursin "Menaxher i Sigurisë për Kurse në Litar" (ERCA Ropes Course Safety Manager), të mbajtur më 26, 27 dhe 28 qershor në Hotel Dukagjini, Pejë.
- **Dialogu me bizneset:** U zhvilluan takime me përfaqësues të bizneseve për të diskutuar sfidat, pengesat dhe mundësitë e zhvillimit, si dhe për të hartuar plane strategjike zhvillimore.

- Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) në koordinim me drejtorë të Zhvillimit Ekonomik mbajti takim për shpalljen e Grant Skemës "Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar" 2024, për mbështetjen e bizneseve ekzistuese dhe ndërmarrësve të rinj me start-up biznese.
- **Vizita në komuna të tjera:** Drejtoria zhvilloi vizita në komunat e Ulqinit, Gjakovës, Klinës, Pejës dhe Lezhës, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet drejtorive komunale për të ndarë praktikat më të mira dhe për të nxitur inovacionin.
 - Pjesëmarrës në Panairin Ndërkombëtar Malor që u mbajt në Grenoble, Francë (5 ditë).
- **Promovimi i projekteve dhe eventeve zhvillimore:** Drejtoria mori pjesë në disa evente dhe panaire për të promovuar Komunën e Deçanit dhe për të tërhequr investime të reja.
 - Pjesëmarrës në hapjen solemne të edicionit të 23-të të Panairit Ndërkombëtar EXPOKOS, e cila nxit rritjen dhe inovacionin në sektorët e ndërtimit, energjisë, makinerisë, mbrojtjes dhe sigurisë.
 - Pjesëmarrës në Panairin e Turizmit dhe Karrierës i organizuar nga Universiteti “Haxhi Zeka”, Oda e Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës dhe Forumi Ekonomik Rajonal Dukagjin.
 - Pjesëmarrës si komunë në edicionin e 20-të të Panairit të Turizmit dhe Sportit për dy ditë rresht si Visit Deçani.
 - Vizita dhe promovimi i Panairit Veror në biznese të ndryshme në Durrës.
- **Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar:** Drejtoria bashkëpunoi me institucione rajonale dhe organizata ndërkombëtare për të përfituar nga praktikat më të mira dhe për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.
 - Bashkëpunimi me Shoqatat dhe OJQ-të: U mbajtën takime me përfaqësues të shoqatave dhe organizatave joqeveritare për të koordinuar aktivitete që do të ndikojnë pozitivisht në jetën ekonomike dhe sociale në nivel lokal.
 - Asociacioni Kosovar për Energji të Ripërtëritshme dhe Eficiencë të Energjisë (AKEREE) realizoi projektin “Rritja e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike në nivel lokal”, duke organizuar punëtorinë e dytë me temën “Ndikimi i ndryshimeve klimatike në biodiversitet dhe masat e përshtatjes në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë – përmytjet dhe erozioni”.
 - Pjesëmarrës në konferencën përmbyllëse të IPA II (2014-2020) organizuar nga Ministria për Çështje Evropiane të Malit të Zi, e mbajtur në Prishtinë më 29/03/2024 në Klan Arena, në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë.
 - Pjesëmarrës në lansimin e projektit “Mountainscape”, zbatuar nga organizatat CHwB Kosova dhe GO2 Albania, mbështetur nga Zyra Rajonale e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor në Tiranë.

- **Vizita në bizneset prodhuese:** Drejtoria vizitoi biznese prodhuese për të marrë njohuri të drejtpërdrejta mbi problemet, sfidat dhe mundësitë e ndihmës nga autoritetet lokale.
- **Hulumtime dhe studime:** Drejtoria u përfshi në hulumtime dhe studime për të vlerësuar efektivitetin e planifikimit strategjik dhe për të siguruar furnizimin me ujë në zonat rurale.
 - Hulumtim mbi Efikasitetin e Planifikimit Strategjik në Institucionet e Sektorit Publik të Kosovës – pjesëmarrës në takim.
 - Pjesëmarrës në prezantimin e Përmbledhjes së Politikave “Siguria e furnizimit me ujë në Zonat Rurale”.
- **Iniciativa të reja dhe angazhime për të ardhmen:** Drejtoria është përfshirë në planifikimin e projekteve të reja dhe organizimin e eventeve për të ardhmen.
 - Krijimi i një databaze me atraksionet turistike.
 - Pjesëmarrës në tryezën për diskutimin e ndikimit të trashëgimisë kulturore në zhvillimin lokal dhe strategjitë e marketingut për turizmin kulturor, të mbajtur më 26/06/2024 në “Seraphina Plaza” – Pejë.
 - Pjesëmarrës në punëtorinë e organizuar nga Kuvendi i Komunës së Deçanit për planifikimin e planit të punës për vitin 2024.
- **Vizita studimore:** Drejtoria zhvilloi një vizitë studimore në qytetin e Gjirokastrës për dy ditë, me fokus në agroturizëm.
- **Dialogu me bizneset:** U zhvilluan takime me përfaqësues të bizneseve për të diskutuar sfidat, pengesat dhe mundësitë e zhvillimit, si dhe për të hartuar plane strategjike zhvillimore.
- **Vizita në komuna të tjera:** Drejtoria zhvilloi vizita në Komunitet e Ulqinit, Gjakovës, Klinës, Pejës dhe Lezhës, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet drejtorive komunale për të ndarë praktikën më të mirë dhe të nxisin inovacionin.
- **Bashkëpunimi rajonal:** U zhvillua një takim me kryetarin e Ulqinit për të diskutuar organizimin e eventeve të përbashkëta, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal.
- **Vizita dhe promovimi i Panairit Veror:** U zhvilluan vizita në biznese të ndryshme në Durrës, me qëllim të promovimit të Panairit Veror në Komunën e Deçanit.
- **Bashkëpunimi me Shoqatat dhe OJQ-të:** U mbajtën takime me përfaqësues të shoqatave dhe organizatave joqeveritare për të koordinuar aktivitete që do të ndikojnë pozitivisht në jetën ekonomike dhe sociale në nivel lokal.

- **Vizita në bizneset prodhuese:** Drejtoria vizitoi biznese prodhuese për të marrë njohuri të drejtpërdrejta mbi problemet, sfidat dhe mundësitë e ndihmës nga autoritetet lokale.
- **Pjesëmarrja në Panairin e Lezhës:** Drejtoria ishte pjesëmarrëse aktive në organizimin e Panairit të Lezhës në Prishtinë, duke promovuar kështu produktet dhe shërbimet lokale.
- **Ftesa për aplikime për subvencionim:** U bë thirrje për aplikim për subvencionim me mjete financiare për NVMV, të lansuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), duke nxitur kështu sipërmarrjen në komunë.
- **Raportimi i Planit të Veprimit:** U bë raportimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2021 për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u fokusuar në arritjet dhe sfidat e zhvillimit lokal.
- **Bashkëpunimi Ndërkombëtar:** U zhvillua një takim me përfaqësues të Agjencisë Italiane dhe organizatës Celim për të diskutuar mbi projektin "NaturKosovo" dhe fazat e vijueshme të projektit, duke synuar të nxisë turizmin dhe ruajtjen e mjedisit.
- **Thirrja për propozime:** U bë një thirrje për propozime në Programin për Zhvillim Rajonal për Investime Kapitale nga Zyrat e Agjencisë për Zhvillim Rajonal, duke inkurajuar projektet që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm rajonal.
- **Krijimi i Grupit Punues:** U formua grupi i anëtarëve në Grupet Punuese Rajonale për promovimin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore në AZHR Perëndimi, duke synuar të rrisë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet komunave.
- **Punëtorja për Bashkëpunimin Ndërkomunal:** Drejtoria mori pjesë në punëtorinë me temën "Bashkëpunimi Ndërkomunal" të organizuar nga Instituti Kosovar për Qeveri Lokale, duke diskutuar mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet komunave në projekte të përbashkëta.
- **Draft strategjia e turizmit:** U zhvillua draft strategjia e turizmit në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për të përcaktuar drejtimet e reja të zhvillimit turistik në komunë.
- **Promovimi i Turizmit Malor:** U krijua lista e shtëpive akomoduese në Bjeshkët e Nemuna përmes organizatës Swisscontact në Kosovë, duke promovuar turizmin malor dhe traditat lokale.
- **Krijimi i Shtigjeve të Çiklizmit:** U ndërmor iniciativa për krijimin e katër shtigjeve të çiklizmit në zonën e Komunës së Deçanit, duke ofruar mundësi të reja për rekreacion dhe turizëm aktiv.
- **Pjesëmarrja në lansimin e publikimit “Shijet e Dukagjinit”** nga CHwB Kosova, një iniciativë që promovon trashëgiminë kulturore dhe gastronomike të rajonit.

- **Takim me Z. Arian Krasniqi:** Një takim me një zyrtar të lartë nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë u zhvillua për të diskutuar mbi atraksionet turistike të Komunës së Deçanit.
- **Bashkëpunimi me Swiss Contact dhe AZHR-Perëndim:** U zhvillua një bashkëpunim në kuadër të projektit PPSE për promovimin e punësimit në sektorin privat.
- **Dëgjim Publik për Projektligjin e Turizmit:** Pjesëmarrje në dëgjim publik të organizuar nga Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, duke kontribuar në politikat e turizmit.
- **Krijimi i Listës së Akomodimeve Turistike:** U hartua një listë e hoteleve, restoranteve dhe resorteve në Deçan, si dhe u përditësuan të dhënat për sektorin e turizmit dhe hotelerisë, duke përfshirë sfidat dhe nevojat për menaxhimin e turizmit të qëndrueshëm.
- **Thirrje për propozime në programin për Zhvillim Rajonal:** U nxitën bizneset e reja dhe ekzistuese të aplikojnë për skemën e garantëve në kuadër të Programit për Zhvillimi Rajonal të Balancuar PZHRB 2024.
- **Bashkëpunimi për promovimin e turizmit:** U bashkëpunua me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për të promovuar turizmin në Deçan.
- **Pjesëmarrja në Konferencën e Donatorëve 2024:** Propozimi i projekteve nga Komuna e Deçanit në këtë konferencë të rëndësishme.
- **Punëtorja për Zhvillimin Ekonomik Lokal:** Pjesëmarrje në punëtorinë me temën "Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030", e organizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale.
- **Bashkëpunimi me Jakova Innovation Center:** Takim për të diskutuar projekte që synojnë fuqizimin e të rinjve, grave dhe grupeve të pafavorizuara.
- **Diskutime me Swisscontact:** Takime për të diskutuar mbi projektet e turizmit në Komunën e Deçanit.
- **Vizita në biznese:** Vizita në biznese të ndryshme të Komunës së Deçanit për të marrë informacione nga afër mbi sfidat dhe mundësitë e bizneseve lokale.
- **Pjesëmarrja në Panairin e Deçanit:** Organizimi dhe pjesëmarrja në Panairin e IAAP "Tafil Kasumaj" në Deçan në vitin 2024.
- **Vizita në biznese prodhuese:** Vizita në biznese që eksportojnë produkte jashtë Kosovës për të kuptuar më mirë nevojat dhe sfidat e tyre.
- **Themelimi i Shoqatës së Miqësisë Kosovë-Austri:** Pjesëmarrja në eventin e themelimit, ku u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit për zhvillimin ekonomik të Komunës së Deçanit.

- **Trajnimet e Asociacionit të Komunave të Kosovës:** Pjesëmarrje në trajnimin "Komunat Gjithëpërfshirëse", duke theksuar rëndësinë e përfshirjes dhe bashkëpunimit ndërmjet komunave.
- **Punëtorja për Zhvillimin e Qëndrueshëm:** Pjesëmarrje në punëtori për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rajonal përmes projekteve për investime kapitale, në bashkëpunim me Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe UN-Habitat Kosovë.
- **Aplikimi në Fondet Europiane IPA:** Pjesëmarrje në thirrjen për bashkëpunim ndërkufitar Kosovë-Shqipëri në kuadër të programit IPA.
- **Trajnimet e CNASAS:** Pjesëmarrje në trajnimet e CNASAS në zonën e Bjeshkëve të Nemuna, përfaqësuar nga Zyra e Turizmit dhe anëtarë të tjerë.
- **Takimi me Kolegjiun për Zhvillim Ekonomik Lokal:** Pjesëmarrje në takimin me z. Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv i AKK-së, për të diskutuar mbi zhvillimin lokal.
- **Trajnim për pjesëmarrjen në Programet IPA:** Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale mbi pjesëmarrjen e komunave në programet IPA.
- **Tryeza për bashkëpunimin në turizëm:** Pjesëmarrje në tryezën e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për koordinimin dhe bashkëpunimin në fushën e turizmit.
- **Bashkëpunimi Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë:** Pjesëmarrje në programin IPA për bashkëpunimin ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës, veçanërisht në rajonin e Rahovecit.
- **Takim me Departamentin e Investimeve:** Diskutime me përfaqësues nga Departamenti i Investimeve në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- **Përpilimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal:** Krijimi i grupit punues për zhvillimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Deçanit.
- **Projekti për ZipLine në Deçan:** Formimi i ekipit dhe projektimi i një atraksioni turistik - ZipLine në Deçan.
- **Harmonizimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal:** Pjesëmarrje në punëtorinë për harmonizimin e strategjive për zhvillim ekonomik lokal me agjendat për zhvillim të qëndrueshëm.
- **Nënshkrimi i Memorandumit për Trashëgiminë Kulturore:** Pjesëmarrje në organizimin e nënshkrimit të memorandumit për Brendin Rajonal të Trashëgimisë Kulturore nga CHwB dhe 6 komunat rajonale.

- **Sfidat në Legjislacionin Komunal:** Pjesëmarrje në punëtorinë për sfidat e implementimit të legjislacionit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale.
- **Grantet për Mikro-Bizneset:** Drejtoria ndihmoi në orientimin e granteve drejt mikro-bizneseve, shoqatave dhe fermerëve të lidhur ngushtë me projektin Via Dinarica.
- **Fizibiliteti i shtigjeve në kuadër të #NaturKosovo:** U krye studimi i fizibilitetit të shtigjeve në bjeshkët e Deçanit si pjesë e shtegut të Via Dinarica, duke përfshirë edhe zgjerimin e tyre për të përmirësuar aksesin dhe përvojën turistike.
- **Sesioni Trajnues për Mikro Shërbimet:** Gjatë muajit Korrik, u mbajt një sesion trajnues për të gjithë ofruesit e mikro shërbimeve në Deçan të interesuar për të aplikuar për mini-grante nga "Volontari nel Mondo RTM" Kosovo në kuadër të projektit "NaturKosovo".
- **Promovimi i turizmit:** U zhvilluan reportazhe të ndryshme për të promovuar bukuritë dhe potencialin turistik të Komunës së Deçanit.
- **Promovimi i Via Ferrata-s:** Një aktivitet i veçantë u zhvillua gjatë muajit Korrik për të promovuar Via Ferrata, me pjesëmarrje falas për tërheqjen e vizitorëve.
- **Marrëveshja me Fondin për Zhvillim Komunitar - CDF:** U nënshkrua marrëveshje për shtimin e një shtegu të ri në fshatin historik Belle, i cili synon të promovojë trashëgiminë kulturore të një prej vendbanimeve më të vjetra në Kosovë.
- **Hiking për promovimin e bjeshkëve:** Organizimi i aktiviteteve të hiking për të eksploruar dhe promovuar bukuritë natyrore të bjeshkëve, duke përfshirë një ecje drejt Liqenit i Tropojës.
- **Organizimi i Aktiviteteve Turistike:** U ndërmorën aktivitete të ndryshme si organizimi i shtëpisë bjeshkatore Alpine "Shkëlzen Haradinaj", kajakimi në Liqenin e Dukagjinit, dhe kamping në grykën e Deçanit.
- **Pjesëmarrja në Sesione Informuese dhe Punëtori:** U organizuan dhe ishim pjesë në sesione dhe punëtori të ndryshme për të diskutuar mbi projekt-ide për investime kapitale, bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- **Takime me Zëvendësministrin e Zhvillimit Rajonal:** Diskutime me zv. Ministrin e Zhvillimit Rajonal për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit në projekte të financuara nga ministria.
- **Hiking në Bjeshkën e Strelcit:** Organizimi i aktiviteteve të hiking për të eksploruar dhe promovuar vende të bukura në Bjeshkën e Strelcit.
- **Promovimi i Via Ferrata-s:** Organizimi i ngjitjes në Via Ferrata pa pagesë si një mënyrë për të promovuar këtë atraksion turistik, veçanërisht gjatë muajit Shtator.

- **Aktivitet me studentët nga Zvicra:** Organizimi i një vizite në Kullat e Drenocit me një grup studentësh nga Zvicra, duke theksuar vlerat kulturore dhe historike të kësaj zone.
- **Hiking në Bjeshkën e Belegut:** Organizimi i një aktiviteti hiking nga Bjeshka e Belegut drejt Majës së Gjeravicës, një prej majave më të larta në rajon.
- **Promovimi i bujtinave:** Një kampanjë për të promovuar bujtinat përgjatë bjeshkëve të Deçanit, duke përfshirë Bujtinën Roshkodoli në Bjeshkën e Roshkodolit.
- **Promovimi dhe bashkëpunimi në turizëm:** Takime me përfaqësues nga klube dhe organizata të ndryshme, si Klubi Alpin Prishtina dhe TV T7, për të diskutuar mbi bashkëpunimin dhe promovimin e turizmit në zonë.
- **Trajnimet për Ekipin e Kërkim-Shpëtimit:** Vazhdimi i trajnimeve për ekipin e kërkim-shpëtimit në komunë, përfshirë bashkëpunimin me FSK-në dhe CAI.
- **Trajnimi i Ekipit të Kërkim-Shpëtimit Malor:** Në kuadër të projektit NaturKosovo, ekipi i Kërkim - Shpëtimit Malor të Komunës së Deçanit ka marrë pjesë në një trajnim të udhëhequr nga ekipi Nacional për Kërkim Shpëtim nga Italia për katër ditë radhazi, duke rritur aftësitë dhe përgatitjen për situata emergjente.
- **Promovimi i kalërimit:** Organizimi i aktiviteteve në ferma të kuajve në Strellc të Poshtëm, si pjesë e nismës për të promovuar hipizmin në ofertën turistike të komunës.
- **Organizimi i Hikingut me Klubin Alpin Gjilani:** Ngjitja e Majës së Marjashit, e cila u realizua në bashkëpunim me Klubin Alpin Gjilani, duke theksuar bukuritë natyrore të rajonit.
- **Promovimi i Bjeshkëve me ATV dhe TV T7:** Organizimi i një aktiviteti bashkë me grupin e ATV 4x4 dhe televizionin T7 për të promovuar bjeshkët e komunës.
- **Bashkëpunimi me Federatën e Golfit të Kosovës:** Takimi me Drejtorin e Federatës, z. Lavdim Zylfiu, për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit dhe zhvillimit të sportit të golfit në Deçan.
- **Koncerti në Përkrahje të Robin Haxhi Krasniqi:** Organizimi i një koncerti me artistë të njohur nga estrada e Kosovës në përkrahje të bokserit të njohur.
- **Bashkëpunimi me OJQ United for Clean Air:** Aktiviteti i mbjelljes së fidaneve pranë lumit Lumbardhi i Deçanit, duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

- **Trajnim për biznese të reja "STARTUP":** Organizimi i trajnimeve për avancimin e njohurive financiare për bizneset e reja, në bashkëpunim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe mbështetjen e Bankës Botërore përmes projektit “Fuqizimi i Sektorit Financiar”.
- **Bashkëpunimi me përfaqësues italian për projektin NaturKosovo:** Takimi dhe diskutimi për zgjerimin e shtegut të Via Dinarica në Bjeshkën e Madhe, duke u përqendruar në zhvillimin e turizmit malor dhe aventuror.
- **Organizimi dhe rregullimi i Shtegut të Via Dinarica:** Përkushtimi në markimin dhe rregullimin e shtegut të Via Dinarica, një iniciativë për të rritur aksesin dhe tërheqjen e turistëve në zonat malore.
- **Punëtorja në Zyrën e Turizmit Visit Deçani:** Organizimi i një punëtorie me temën e Via Dinarica, duke synuar të rrisë ndërgjegjësimin dhe angazhimin në zhvillimin e turizmit malor.
- **Promovimi i shtigjeve të çiklizmit:** Fokusimi në promovimin e katër shtigjeve të çiklizmit në zonën rurale, të lidhura me zonën urbane, për të promovuar trashëgiminë kulturore të Komunës së Deçanit.
- **Vizita në Komunën e Beranes dhe Bashkëpunimi Rajonal:** Pjesëmarrja në një vizitë në Komunën e Beranes, e cila vazhdoi në Plavë dhe Guci, dhe më pas në Komunën e Andrijevicës, me qëllim të bashkëpunimit në fondet Europiane.
- **Pjesëmarrja në Forum për Zhvillimin Rajonal:** Diskutimi i mundësive të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për zhvillimin ekonomik dhe turistik.
- **Projektimi i Atraksionit Turistik ZipLine Deçani:** Angazhimi në projektimin e atraksionit turistik ZipLine në Deçan, një shtesë e re dhe emocionuese për ofertën turistike të zonës.
- **Organizimi i Kampusit Dimëror:** Pjesëmarrja në organizimin e kampusit dimëror në zonën e turizmit të Deçanit, duke promovuar resurset turistike të rajonit.
- **Kontributi në Punëtorinë e AZHR-Perëndimi:** Pjesëmarrje dhe kontribut në punëtorinë e organizuar nga Agjencia për Zhvillim Rajonal të Perëndimit për zhvillim ekonomik dhe turizëm të qëndrueshëm.
- **Krijimi i kodeve për Menaxhimin e të Hyrave nga Turizmi:** Përpjekje për të adresuar dhe menaxhuar në mënyrë të mirëfilltë të hyrat që rrjedhin nga produktet e turizmit.
- **Sesion Informues për Investime Kapitale:** Pjesëmarrje në sesionin informues dhe punëtorinë lidhur me thirrjen për projekt-ide për investime kapitale në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal PZHR 2024.

- **Pjesëmarrje në Punëtorinë e Let's Do It Peja:** Kontribut në finalizimin e Planit të Veprimit për Cilësi të Ajrit për komunën e Deçanit.
- **Pjesëmarrja në Konferencën e Oda e Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës:** Pjesëmarrje në tryezën e organizuar për shënimin e Ditës Botërore të Turizmit.
- **Bashkëpunimi me Zyrën e Regjistrimit të Punëkërkuesve:** Takime me zyrën e regjistrimit të punëkërkuesve në ZP-Deçan për të krijuar një bashkëpunim të frytshëm.
- **Pjesëmarrje në Punëtorinë për Ligjin e Pronës:** Angazhim në punëtorinë lidhur me projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së luajtshme të komunës.
- **Takim i Komunave të Rajonit Perëndimorë me MZHR:** Pjesëmarrje në takimet rajonale me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal për të diskutuar zhvillimin e përbashkët.
- **Pjesëmarrja në Punëtorinë e Swisscontact-PPSE:** Kontribut në punëtorinë për hartimin dhe përditësimin e Strategjive Komunale të Turizmit, nën organizimin e Swisscontact-PPSE.

➤ **Zhvillimi dhe Promovimi i Turizmit në Komunën e Deçanit**

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Deçanit ka angazhuar intensivisht resurset dhe energjitë e saj në promovimin dhe zhvillimin e turizmit në rajon. Përmes një serie aktiviteteve të ndryshme dhe të koordinuara, Drejtoria ka synuar të nxisë një turizëm të qëndrueshëm dhe tërheqës që shtrihet nga turizmi malor dhe aventura deri te promovimi i trashëgimisë kulturore. Aktivitetet përfshijnë:

- **Rregullimi i hapësirave të Qendrës Informuese Turistike:** Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës së qendrës turistike për të ofruar informacion më të mirë dhe shërbime për vizitorët.
- **Lansimi i Web-Faqes së Turizmit:** Zhvillimi dhe lansimi i një faqe interneti dedikuar turizmit në Deçan, që ofron informacion të detajuar dhe të përditësuar për turistët.

- **Përgatitja dhe shpërndarja e Fletushkave:** Krijimi dhe distribuimi i materialeve informative për bjeshkët, duke ofruar informacione të detajuara dhe tërheqëse për turistët.
- **Shtigjet e shënjëzuara për ecje/hiking:** Përfshirja dhe shënjëzimi i shtigjeve të ndryshme malore si Bjeshkën e Roshkodolit, Bjeshkën e Prilepit, dhe të tjera, duke u bërë këto zona më të qasshme dhe tërheqëse për turistët.
- **Promovimi i bukurive natyrore dhe burimeve turistike:** Realizimi i katër video klipeve për të nxjerrë në pah bukuritë dhe resurset natyrore të zonave rurale dhe malore të Deçanit.
- **Programi Ndërkufitar me Malin e Zi:** Angazhimi në një program ndërkufitar me Malin e Zi, duke theksuar bashkëpunimin rajonal në fushën e turizmit.
- **Bashkëpunimi me organizata të ndryshme:** Bashkëpunimi me organizata si SWISS CONTACT, USAID, CDF, ADF, ECO, Bashkimi Evropian, dhe GIZI për të forcuar dhe zgjeruar fushën e turizmit në Deçan.
- **Krijimi i Ekipit të Kërkim - Shpëtimit:** Formimi i një ekipi të dedikuar të Kërkim-Shpëtimit në Komunën e Deçanit, i cili do të kontribuojë në sigurinë e turistëve dhe banorëve lokalë.
- **Vendosja në hartë e shtigjeve të çiklizmit urban:** Shënjëzimi dhe përmirësimi i shtigjeve të çiklizmit në zonën urbane të Deçanit, duke e bërë qytetin më tërheqës për turistë dhe banorët lokal.
- **Aktivitetet e ngjitjes malore:** Organizimi i aktiviteteve të ngjitjes malore si "Ngjitja në Bellen e Balajve" dhe "Ngjitja në Bjeshkën e Madhe", si dhe ngjitja në Via Ferrata gjatë Ditës së Çlirimit të Deçanit, duke promovuar këtë atraksion të njohur.
- **Koncerti në qendër të qytetit:** Organizimi i një koncerti madhështor në qendër të qytetit si pjesë e aktiviteteve të Panairit Veror.
- **Panairi Tradicional Veror:** Organizimi i panairit me pjesëmarrjen e 45 bizneseve dhe kompanive nga qytetet e Kosovës dhe shteteve fqinje, duke ofruar një platformë për promovimin e bizneseve lokale dhe ndërkombëtare.
- **Trajnimi për rrjete sociale nga NaturKosovo:** Pjesëmarrja në trajnime për përdorimin e rrjeteve sociale, me qëllim përmirësimin e promovimit dhe marketingut të turizmit në rrjete sociale.
- **Vizita studimore në Itali:** Pjesëmarrja në një vizitë studimore në Itali në kuadër të NaturKosovo, duke u takuar me përfaqësues dhe akterë të turizmit Italian dhe mësuar nga praktikat e tyre.
- **Pjesëmarrja në shënjëzimin e shtigjeve:** Angazhimi në shënjëzimin dhe përmirësimin e shtigjeve në bjeshkët e Deçanit, duke përmirësuar infrastrukturën për ecje dhe hiking.

- **Pastrimi dhe shenjëzimi i Via Ferrata:** Përkushtimi në pastrimin dhe mirëmbajtjen e Via Ferrata, një nga atraksionet kryesore turistike të rajonit.
- **Fizibiliteti i shtigjeve të Via Dinarica:** Studimi dhe zgjerimi i shtigjeve ekzistuese në kuadër të shtegut Via Dinarica, duke e bërë atë më tërheqës për turistët.
- **Trajnimi i Kërkim Shpëtimit Malor:** Pjesëmarrja në trajnimet e specializuara për Kërkim-Shpëtim Malor, duke rritur kapacitetet e reagimit në situata emergjente.
- **Organizmi I Takimit për projektin NaturKosovo:** Organizimi i takimeve për prezantimin e mundësive të granteve në kuadër të projektit NaturKosovo, duke nxitur përfshirjen e bizneseve, fermerëve dhe shoqatave në turizëm.
- **Organizimi i trajnimeve për aplikimin në grantet e projektit NaturKosovo:** Mbrojtja dhe promovimi i biodiversitetit përmes trajnimeve për aplikimin në grantet e ofruara nga ky projekt.
- **Takim me përfaqësues nga Shoqata e Kayakit – Deçani:** Organizimi i aktiviteteve me kayak në Liqenin e Radoniqit, duke ofruar një eksperiencë të veçantë për turistët dhe banorët lokal.
- **Trajnimi nga Utalaya për Digital Marketing:** Përqëndrimi në rritjen e aftësive digjitale të bizneseve dhe individëve lokal për të promovuar turizmin në Deçan.
- **Bashkëpunimi dhe vizita me Bashkitë e Lezhës dhe Ulqinit:** Nxitja e bashkëpunimit rajonal për të promovuar turizmin dhe kulturën ndërshtetërore.
- **Bashkëpunimi dhe vizita në Qytetin e Tetovës:** Zgjerimi i bashkëpunimit për promovimin e turizmit rajonal.
- **Emisione në TV për promovimin e turizmit:** Përdorimi i mediave për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesin për turizmin në Deçan.
- **Aktiviteti me Utalaya - prezantimi në shkollë:** Ngritja e ndërgjegjësimit mbi biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore të Deçanit nëpërmjet aktiviteteve informative në shkollë.
- **Pjesëmarrja në Panairin e Turizmit dhe Sportit në Prishtinë:** Prezantimi i ofertave turistike dhe sportive të Deçanit në një skenë më të gjerë.
- **Takim me përfaqësues nga Agjencia Italiane e Turizmit:** Diskutimi i mundësive të bashkëpunimit në kuadër të projektit NaturKosovo.

- **Pjesëmarrja në Organizmin e Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale:** Angazhimi në aktivitete që promovojnë decentralizimin dhe zhvillimin lokal..
- **Takim me Organizatën 'Celim' nga Italia:** Diskutimi i fazave të vazhdueshme të projektit NaturKosovo.
- **Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga CHwB:** Promovimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes për Brendin Rajonal të Trashëgimisë Kulturore.
- **Pjesëmarrës në Organizimin e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI):** Mbështetja e iniciativave për përfshirjen e grave në zhvillimin ekonomik dhe social.
-
- **Vizita në fshatrat turistik Belle dhe Pleqe:** Promovimi i turizmit dhe kulturës në këto fshatra.
- **Bashkëpunimi me OJQ 'Shkelzen Haradinaj':** Zhvillimi i projektit "Tourism hubs for better offer in less advantaged mountainous areas", duke theksuar rëndësinë e turizmit në zonat malore.
- **Promovimi i trashëgimisë kulturore:** Fokusi në promovimin e Kullave të Drenocit si një pikë turistike e rëndësishme.
- **Emision për të promovuar Kayak:** Nxitja e sporteve ujore dhe aventurat në natyrë nëpërmjet transmetimeve televizive.
- **Aktiviteti për shtigje në Bjeshkën e Madhe:** aktivitet i organizuar me CAI – ekipa e Deçanit për eksplorimin dhe zhvillimin e shtigjeve malore.
- **Punëtori për Via Dinarica:** në Seraphina Plaza, punëtori njëditore tryezë e rrumbullakët për të diskutuar dhe ndarë ide rreth konsorciumit të menaxhimit të Via Dinarica Kosovo.
- **Pjesëmarrje në grupin e fokusit mbi temën e taksës së akomodimit,** e organizuar nga projekti PPSE, implementuar nga Swisscontact dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK).
 - Pjesëmarrje në forum për kërkimin e partnerëve: në kuadër të **IPA III Cross Border** Cooperation Programme Montenegro-Kosovo 2021-2027.
 - Pjesëmarrje në ceremoninë e hapjes së Universitetit Ndërkombëtar **Veror UNISUM 2024**, organizuar nga Universiteti “Haxhi Zeka”.
 - **Takim me përfaqësuesit e organizatës italiane CELIM:** diskutim për vazhdimin e projektit dhe zhvillimin e turizmit në zonën tonë.
 - **Pjesëmarrje në Akademinë mbi Turizmin:** në Kampusin e UBT-së në Lipjan, në mbështetje zhvillimin e turizmit në Kosovë.

- Takim me **Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal**: diskutim për çështje të rëndësishme për zhvillimin lokal.
- **Mid-term Evaluation Workshop**: pjesëmarrje në takim me NaturKosovo.
- **Pjesëmarrës në Konferencën e Dytë të Forumit Ekonomik Rajonal – Dukagjini**: diskutim "Perspektivat dhe strategjitë për bashkëpunim dhe zhvillim të qëndrueshëm rajonal në epokën e digjitalizimit".
- Pjesëmarrje në punëtorinë nga AZHR Perëndimi: mbi Menaxhimin e Ciklit të Projekteve, për shqyrtimin e praktikave të BE-së.
- **Pjesëmarrje në Konferencë për Turizmin e Qëndrueshëm.**
- **Pjesëmarrje në "Decarbonization without Borders".**
- Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e politikave** të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.
- Pjesëmarrës në shënimin e Ditës Botërore të Turizmit në tryezat organizuara nga Oda e Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës.

Pjesëmarrje në organizimi i Ditës së Gështenjës.

- Pjesëmarrje në tryezën për zhvillimin e politikave për bizneset nga rajoni përëndimor, nën organizimin e **Ministrisë së Zhvillimit Rajonal**.
- Pjesëmarrje në trajnimin mbi rëndësinë e industrive kreative për markimin dhe zhvillimin e turizmit, organizuar nga **UNDP**.
- **Pjesëmarrje në Manifestimin Promocional të Turizmit Rural.**
- Pjesëmarrje në takimin me Ministrin e Zhvillimit Rajonal dhe kryetarët e komunave të regjionit të Dukagjinit, organizuar nga **AZHR Perëndimi**.
- **Pjesëmarrje në aktivitete të organizuara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë** për të informuar dhe koordinuar aktivitete të ndryshme në fushën e turizmit.
- Pjesëmarrje në përpilimin e **Guidebook** së bashku me komunat fqinje në kuadër të projektit NaturKosovo, me fokus në shtegun **Via Dinarica**.
- Pjesëmarrje në takim me përfaqësues të organizatave italiane, përfshirë z. Giuseppe La Carrubba nga OJQ Appennino Slow, z. Maurizio Davoli, President i AITR (**Shoqata Italiane për Turizmin e Qëndrueshëm**) dhe z. Filippo Vigani, Koordinator i projektit **NaturKosovo**.

- **Promovimi i Deçanit në revistën Travel Magazine - Balkans**, për të theksuar atraksionet dhe bukuritë e komunës.
- Pjesëmarrje në takim për diskutimin e projektit për pendën **akumuluese të ujit** në Bistricën e Lloqanit, për mundësitë e investimeve në këtë projekt me rëndësi për banorët e Deçanit.
- Pjesëmarrje në punëtorinë intensive mbi zhvillimin dhe punët e kryera në shtegun e Via Dinarica.
- **Marrëveshje e nënshkruar mes Komunës së Deçanit dhe Agjensisë Italiane** për Zhvillim dhe Kooperim për pranimin e pajisjeve të shpëtimit malor në kuadër të projektit #NaturKosovo.
- **Pjesëmarrje në inaugurimi e objekti të Trashëgimisë Kulturore**, në Kompleksin “Fitnete Ramosaj” në Deçan, me një vlerë prej 463,731.11€.
- Fillimi i punimeve për "**Zipline**"-in më të gjatë në rajon, me një gjatësi prej 1107 metrash, në kuadër të projektit "**Zhvillimi i turizmit në Komunën e Deçanit**", mbështetur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe fondet buxhetore të komunës, me një total prej 414,217.00€.
- **Pjesëmarrje Festivalin “Aquafest” 2024 - Water Festival.**
- **Promovimi i Segmentit të Shtegut Malor të Via Dinarica.**
- **Ftesë për pjesëmarrje vullnetare:** ftesë për pastrimin vullnetar të shtigjeve të Bjeshkëve të Deçanit, në mënyrë që të ruhet natyra dhe të promovohen shtigjet e bukura të bjeshkëve tona
- **Pjesëmarrje në Organizmin e Ditës së Gështenjës** si dhe aktivitetet që lidhen me fushën e turizmit.
- **Takim për Themelimin e Këshillit Publik-Privat:** U mbajt takimi i parë për themelimin e Këshillit Publik-Privat, një mekanizëm jo-formal dhe këshilldhënës për të forcuar bashkëpunimin mes sektorit publik dhe privat në zhvillimin e projekteve lokale. Kjo nismë mbështetet nga Aktiviteti i USAID-it për Qeverisjen e Pronës dhe përfshinte drejtoreshën e këtij aktiviteti, znj. Jennifer Ober.
- **Aktivitet i organizuara me Klubin e Kuajve:** aktiviteti i organizuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim së bashku me Klubin e Kuajve "Dyli Ranch" nga Strellci i Ulët solli entuziazëm dhe angazhimin e komunitetit.
- **Hulumtimi i Faunës:** Komuna e Deçanit, përmes Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Visit Deçani, vendosi 15 kamera kurth të cilat do të ndihmojnë në hulumtimin e faunës, një vlerë e shtuar për ekosistemin e bjeshkëve.
- **Pjesëmarrje zyrtare në Panairin e Turizmit në Selanik :** Panairi ndërkombëtarë i turizmit HELEXPO në Selanik, Greqi.

- **Pjesëmarrje në takim mbi Zhvillimin e Turizmit:** me ftesë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, u mbajt një takim nga Kolegjiumi i Drejtoreve të Zhvillimit Ekonomik Lokal për të diskutuar mbi arritjet dhe hapat strategjikë të nevojshëm për të avancuar turizmin në Kosovë.
- **Organizimi i ecjes drejt bjeshkëve për përmbylljen e vitit:** u organizua një aktivitet ecjeje me OJQ-të bjeshkatore të qytetit të Deçanit dhe të Kosovës, i shoqëruar nga një koncert në ambientet e Qendrës Rinore.
- **Organizimi i trajnimit mbi Marketingun Digjital:** Komuna e Deçanit, në bashkëpunim me organizatën Future Environment Of Kosovo, organizoi trajnimin e radhës për marketingun digjital, duke u fokusuar në teknikat e reja dhe përdorimin e tyre për zhvillimin e turizmit.

Përmbyllje

2024: Viti i rritjes dhe inovacionit për Deçanin

Gjatë punës në vitin 2024, është e rëndësishme të reflektojmë mbi arritjet dhe sfidat që Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Deçanit ka përjetuar dhe mposhtur. Ky vit ka qenë një periudhë transformuese për Deçanin, ku përpjekjet tona kolektive në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit kanë sjellë rezultate të dukshme dhe të prekshme.

Me një qasje të përqëndruar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovacionin, ne kemi arritur të promovojmë një model të turizmit dhe zhvillimit ekonomik që jo vetëm që nxitë rritjen ekonomike, por gjithashtu respekton dhe ruajtjen e mjedisit dhe trashëgiminë kulturore. Nga organizimi i aktiviteteve turistike të reja dhe bashkëpunimet rajonale dhe ndërkombëtare, deri te nxitja e ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi biodiversitetin dhe kulturën, vitin 2024 e kemi bërë një vit të veçantë për komunën tonë.

Projektet dhe iniciativat e këtij viti, si NaturKosovo dhe zgjerimi i ofertave turistike malore, kanë vendosur themelin për një të ardhme më të ndritur dhe më të qëndrueshme për Deçanin. Kemi dëshmuar se, përmes bashkëpunimit të fortë dhe përkushtimit të përbashkët, mund të krijojmë një mjedis më të mirë për banorët tanë dhe vizitorët e ardhshëm.

Duke u përgatitur për vitin 2025, ne jemi të vendosur të vazhdojmë këtë rrugë të suksesit, duke u përqëndruar në zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës, promovimin e inovacioneve në fushën e biznesit dhe turizmit, dhe zgjerimin e bashkëpunimeve tona për të krijuar një Deçan edhe më të fortë dhe më tërheqës.

➤ Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

1. Shefi i Shërbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referenten e ndryshimeve kadastrale

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë, përkatësisht prej fillimit të vitit 2024 e deri me datën e përpilimit të këtij raporti, Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsej **765** kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri më tani janë shqyrtuar **720** dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuate me të cilat palëve i'u është njohtë e drejta ligjore e kërkuar ose ju ka refuzuar e njëjta kërkesë dhe ju ka dhënë e drejta e ankesës në organin e shkallës së dytë. Ndërsa **45** kërkesa janë në procedurë e sipër.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohtë e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referenti për ndryshime kadastrale i cili konform këtyre vendimeve bënë azhurimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjtat prapë i azhurnon duke i fut të dhënat në kompjuter, përkatësisht në programin e SIKTK.

Krahas këtyre punëve zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit ka kryer edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronëso- juridike si dhe së bashku me referentin për ndryshime kadastrale kanë kryer edhe punë tjera me urdhër të drejtorit.

2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit.

Këta zyrtar gjatë periudhës raportuese kanë pasur **565** azhurime të lëndëve nga tereni sipas kërkesës së palëve siç janë: ndarja e parcelave, bashkimi i parcelave, regjistrimi i objekteve, korrigjimi i sipërfaqeve, korrigjimi i mexhave dhe futja e të dhënave të reja në sistem etj. Këto lëndë të gjitha janë zgjedhur me përjashtim të **10** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër.

Gjithashtu këta zyrtar gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **8** historiata dhe identifikime të mexhave sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **572** kopje plani.

3. Referenti për pranimin e palëve

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë, referenti për pranimin e palëve ka pranuar gjithsej **2243** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e komunës.

I njëjti zyrtar i ka proceduar të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët janë pajisur me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës. I njëjti punëtor krahas këtyre punëve ka kryer edhe punët e përpunuesit në SIKTK.

Gjithsej lëndë të kryera nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër deri ne përpilimin e këtij raporti janë 1376 lëndë të ndryshme.

➤ Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive, që janë realizuar me buxhetin e komunës gjatë vitit 2024:

- 17.02.2024 - 17 Shkurti - “Dita e Pavarësisë”;
- 07.03.2024 - Për nder të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare - “Nata e Zjarreve”;
- “Gruaja Dukagjinase dje dhe sot”, nga znj. Shkendije Berisha-Pacolli;
- 22.03.2024 - Për nder të “Epopesë së Dukagjinit”, Hapja e ekspozitës “Marsi i Lirisë”, nga piktori prof. Kushtrim Dacaj;
- 23.03.2024 - Për nder të “Epopesë së Dukagjinit”, “Gara e shenjëtarisë”, me veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;
- 24.03.2024 - 24 Marsi - “Epopeja e Dukagjinit”, manifestimi qendror;
- 31.03.2024 - Shfaqja e filmit dokumentar për jetën dhe veprën e komandant Deli Leka;
- 20.04.2024 - Promovimi i librit “SPEKTRUM” (roman), nga autorja shqiptare znj. Eliona Gjergo;
- 01.05.2024 - Përkujtimi i Kuvendit të Pajtitimit “Verrat e Llukës”;
- 05.05.2024 - Për nder të “Ditës së Dëshmorëve”, mbajtja e turnirit tradicional ne Futsall “Luan Haradinaj”;
- 06.05.2024 - Koncert për nder të “Ditës së Dëshmorëve”;
- 22.05.2024 - Tryezë shkencore me temën: “20 vjetori i Festivalit Gjithëkombëtar i Folklorit “Eshkë e ndezur mbi Shkëlzen” 2004-2024”;
- 23.05.2024 - Promovimi i librave: “Rastavica Vështrim Historik”, nga autorët –Muhamet Qerimi dhe Dren Brahimaj;

- “Arbërit dhe Bizanti gjatë mesjetës (XI-XV)”, Nga autori Muhamet Qerimi;
- “Historia e Mesjetës së Mesme Evropiane 1000-1300”, nga autorët Muhamet Qerimi dhe Ermal Baze;
- 06.06.2024 - Turnir Memorial në Futboll të Vogël “Ali Avdijaj”;
- 15.06.2024 - Manifestim për nder të “Ditës së Çlirimit” të qytetit të Deçanit;
- 15.06.2024 - Dita e parë e “Festivalit Gjithëkombëtar të Folklorit “Eshkë e ndezur mbi Shkëlzen”;
- 16.06.2024 - Nata finale e Festivalit Gjithëkombëtar të Folklorit “Eshkë e ndezur mbi Shkëlzen”;
- 28.07.2024 - Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit “Ndërtimi i Pishinës Gjysmë-Olimpikë”;
- 28.07.2024 - Koncert për nder të ardhjes së mërgimtarëve;
- 06.08.2024 - Zbulimi i Shtatores së Heroinës “Fetnete Ramosaj”;
- 10.08.2024 - Mbajtja e Festivalit “New Born Kosova”;
- 15.10.2024 - Përrurimi i objektit të “Kolonisë së Artistëve” në kompleksin kulturor “Fetnete Ramosaj”;
- 19.10.2024 - Hapja e klubit të karatesë “Gëzim Dervishaj”;
- 24.10.2024 - “Dita e Gështenjës”;
- 28.11.2024 - 28 Nëntori “Dita e Flamurit”;
- 29.11.2024 - Shfaqja e dokumentarit “Flamurtarët e Deçanit”, nga autori z. Faton Mehmetaj;
- 03.12.2024 - Ekspozita me rastin e “Ditës ndërkombëtare të personave me nevoja të veçanta”, nga Fjolla Januzaj dhe Endrit Januzaj;
- 22.12.2024 - Turnir Memorial Tradicional në Ping-Pong “Enver Halilaj dhe Altin Haskaj”;
- 29.12.2024 - Koncert me muzikë klasike, nga sopranot Besiana Mehmeti dhe Adelina Paloja;
- 30.12.2024 - Zgjedhja e “Laureatëve të vitit 2024”;
- 30.12.2024 - Koncert për përmbylljen e vitit 2024, nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve “Deçani”.

Gjatë vitit 2024 Ansambli i Këngëve dhe Valleve “Deçani” ka përfaqësuar me shumë sukses qytetin e Deçanit, me shumë pjesëmarrje nëpër festivale, me fitore të shumë çmimeve kryesore, po ashtu Ansambli i qytetit ka përfaqësuar Kosovën në shtetin e Turqisë gjatë muajit gusht. AKV “Deçani” me konkursin e hapur për talentet e rinj, ka formuar edhe dy grupe të reja me anëtarë të rinj.

Gjithashtu edhe në sport është arritur sukses shumë i madh gjatë këtyre muajve, si në fitore, po ashtu edhe në sponzorizim të të gjitha klubeve të sportit dhe OJQ-të që veprojnë në komunën e Deçanit.

Nr.	Emri i OJQ-së dhe Klubit Sportiv	Emri i Përfaqësuesit	Vlera e përfituar
1.	Fondacioni “EJ”	Endrit Januzaj	2000€
2.	Klubi i Kajakut “Aqua”	Fjolla Limani	2000€
3.	“Etno Kastrioti”	Miftar Januzaj	2000€
4.	KF “Deçani”	Avni Rexhaj	20.000€

5.	Klubi i Çiklizmit	Muhamet Cacaj	1000€
6.	“Teuta”	Ajete Beqiraj	2000€
7.	“Dervish Shaqa”	Mustafë Ramaj	1000€
8.	Maythai Club “Deçani”	Arben Ibërhysaj	2000€
9.	“Future Enviroment of Kosovo”	Korab Alimusaj	1500€
10.	“Visit”	Elinda Kuçi	5000€
11.	Ping-Pong “Shqiponjat e Zeza”	Kreshnik Dacaj	1500€
12.	“Agim Selmanaj”	Artan Islamaj	2000€
13.	“BWBP”	Sutki Hulaaj	2000€
14.	Fondacioni “Dhuro edhe Ti”	Zeçe Malaj	1000€
15.	KFF ”Deçani”	Avdullah Lataj	2000€
16.	KF “Besa”	Armend Çekaj	5000€
17.	Klubi i shahut “Ali Haskaj”	Ismet Haskaj”	1000€
18.	KHF “Jusuf Gërvalla”	Musa Berisha	2000€
19.	“Shoqata e Bletarëve “	Haki Tahirukaj	1000€
20.	“Iniciativa”	Saniye Thaqi	2000€
21.	GVL “GJeravica”	Bajram Çeku	2000€
22.	“Iniciativa për Zhvillim”	Ajne Ibërhysaj	3000€
23.	“Shkëlzen Haradinaj”	Jeton Berisha”	2000€
24.	OVL-Deçan	Valdet Nuraj	10.000€
25.	“Shtigjet e Lumtura të Kosovës”	Ermal Qufaj	1500€

Total 46.530.00€

-“Biblioteka e qytetit “Dëshmorët e Lirisë” gjatë këtyre gjashtë muajve ka pasur:

-102 lexues.

-Libra të dhuruar nga MKRS për vitin 2024 janë:

-604 tituj.

-1160 ekzemplarë.

-Kurse libra të dhuruara nga autorë të ndrydhëm janë 81.

-“**Muzeu Etnologjik**” i qytetit të Deçanit gjithashtu ka qenë i hapur për vizitorët e shumtë gjatë këtij viti, si dhe është pasuruar me artefakte, të cilat i kanë dhuruar qytetarët e Deçanit.

-“**Kompleksi Kulturor “Fetnete Ramosaj**” ka qenë shumë aktiv gjatë gjithë vitit me shumë aktivitete, ngjarje, seminare, trajnime, promovime, koncerte, xhirime, si dhe është bërë pikënisja e vizitorëve që vijnë në Deçan për hiking.

-**KVRL** ka qenë po ashtu aktive me pjesëmarrje në të gjitha aktivitetet e mbajtura gjatë vitit dhe duke mbajtur trajnime të ndryshme, në Deçan dhe në qytetet e tjera të Kosovës.

Komuna e Deçanit, metra katror nën menaxhimin për veprimtari të sportit për vitin 2024, ka këto hapësira:

- Palestra sportive e qytetit-1000m²
- Stadiumi i qytetit-4000 m²
- Strellc-500 m²
- Deçan-100 m²
- Rastovicë-500 m²
- Gramaqel-500 m²
- Isniq-500 m²
- Irzniq-500 m²
- Dranoc-500 m²
- Gllogjan-500 m²
- Lumbardh-500 m²
- Maznik-500 m²
- Ratish-500 m²
- Strellc i Ulët-500 m²
- Llukë e Ulët-400 m²
- Pobërgjë-350 m²
- Voksh-500 m²
- Lëbushë-500 m²
- Prapaqan-500 m²
- Dubovik-500 m²
- Beleg-500 m²
- Prejlep-500 m²
- Baballoq-500 m²
- Carrabreg-500 m²
- Prokolluk-2200 m²

Gjatë vitit 2024 është shtuar edhe hapësira sportive tek Kompleksi Kulturor “Fetnete Ramosaj”, me 226 m².

Arkivi Komunal në Deçan, funksionin e vetë të punës e kryen në harmoni dhe në përputhje me dispozitat ligjore, në harmoni me rregulloret e pushtetit qendror dhe atë të pushtetit lokal.

Ne si punëtor të këtij sektori jemi angazhuar që të bëjmë klasifikimin dhe sistemimin e lëndëve arkivore.

Për periudhën Janar - Dhjetor, në Arkivin Komunal të Deçanit janë kryer punë dhe detyra të caktuara sipas programit të punës, në mënyrë që sa me mirë të bëhet ruajtja e dokumentacionit arkivor.

Në kuadër të qeverisjes janë të ndërtuara disa aplikacione për administratë elektronike siç është SMAED, E-Arkivi dhe Intraneti.

Gjatë kësaj përdhe kemi pasur pale, të cilat kanë kërkuar lëndë të ndryshme për shfrytëzim. Lëndët e kërkuara kanë qenë: raporte të LAL Kurorave, Aktgjykime, Aktvendime, Vendime të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Për/To/Za :	Kuvendin e Komunës së Deçanit
Nga/From/Od	Komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e Shesheve, Rrugëve dhe Lagjeve Urbane, në teritorin e Komunës së Deçanit Kryetar i Komisionit, z.Hajdar Sutaj
Tema/Subject/Subjekat	Propozim Vendim i komisionit Komunal për emërim të rrugëve - Lista me emra rezervë të rrugëve të Komunës së Deçanit,

Të nderuar ,


Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në harmoni me Ligjin Nr.04\ L-071 për Sistemin e Adresave, si dhe në bazë të nenit 26 pika 6 dhe pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e Shesheve, Rrugëve dhe Lagjeve Urbane, në teritorin e Komunës së Deçanit, i propozon Kuvendit të Komunës së Deçanit, në mbledhjen që do të mbahet me dt.27.02.2025, për miratim:

LISTA ME EMRA REZERVË TË RRUGËVE TË KOMUNËS SË DEÇANIT

Propozimi i dërgohet KPF-së dhe Kuvendit të Komunës së Deçanit për shqyrtim dhe marrje të vendimit.

Me respekt,

Deçan, dt.19.02.2025



Fshatrat	Nr	LISTA REZERVË ME EMRAT E RRUGËVE TË APROVUARA SIPAS FSHATRAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT
Beleg	1	Fatmir Vishaj
Belle	2	Marash Pali
	3	Hasan Beqiri
	4	Hazir Laha
	5	Ali Meta
	6	Naim Shala
	7	Bajram Meta
	8	Lul Giga
	9	Nysret Shala
	10	Himë Zeqiri
	11	Col Sokoli
	12	Lan Halili
	13	Zeqir Ahmeti
	14	Smajl Demushi
	15	Demush Tahiri
	16	Zenel Çekaj
	17	Gilë Martini
Carrabregu Ulët	18	Elez Dema
Carrabregu Epërm	19	Xhavit Dobraj
	20	Bajram Lataj
	21	Xhemajl Rexha
	22	Azllan Balaj
	23	Zeqë Rexha
	24	29 Maji
	25	Kodra e Loshit
	26	Tahir Cena
	27	Zenel Balaj
Dashinoc	28	Besart Kadrijaj
	29	Ali Mustafaj
	30	Xhafer Cacak
Deçan	31	Kamer Homza
	32	Halil Sejfiqaj
	33	Ura mbi Lumëbardh
	34	Nezir Bardhi
	35	Sadri Tolaj
	36	Jeta
	37	Bilall Demukaj
	38	Ukë Iberhysaj
	39	Rexhep Iberhysaj
	40	Halim Tolaj

Dubovik	41	Brahim Zeqiri
	42	Musa Shala
	43	Agush Shala
Irnqiq	44	Spitali ushtarak
	45	Mësuesja Fatime
	46	Isat Mushkolaj
	47	Ramë Zejnaj
	48	Col Dervishaj
Isnig	49	Isuf Tafaj
	50	Shaban Sadiku
	51	Haxhi Bajraktaraj
	52	Hysen Tahirsylaj
	53	Halil Rama
	54	Zenun Mulaj
	55	Ramadan Demushi
	56	Ali Meta
	57	Metë Ahmetxhekaj
	58	Beteja Gushtit
	59	Miftar Balaj
	60	Selishta
	61	Xhevat Tahiri
	62	Xhemë Sinanaj
	63	Elvis Osadautaj
	64	Ramë Haxhnikaj
	65	Musë Tahiri
	66	Ukë Bojku
	67	Hysen Haxhia
	68	Emin Demushi
	69	Fazli Abazi
	70	Mustafë Haklaj
Lëbushë	71	Pavadave
	72	Shaim Musaj
	73	Mehmet Shabani
	74	Isuf Rrustemi
	75	Liria
Lloqan	76	Ali Rexha
	77	Rifat Rama
Llukë e Epërme	78	Sadri Brahimi
	79	Qerim Uka
	80	Isuf Sutaj
	81	Hoxhëve
	82	Nezir Meta
	83	Sylë Shaqa
	84	Rexhep Sokoli
	85	Tahir Efendi Lluka
	86	Isë Xani

Lukë e Ujë	87	Jashar Gecaj
Lumbardh	88	Rizë Lekaj
	89	Isuf Lokaj
	90	Ramadan Gashi
	91	Myshyr Barahimi
Maznik	91	Kushtrim Sylaj
Pemishtë	92	Selim Sokoli
	93	Haxhi Muhameti
Pobergjë	94	Ilir Tolaj
	95	Trimat e Vokshit
	96	Hasan Bajrami
	97	Naim Tolaj
	98	Bekim Tolaj
	99	Islam Avdia
	100	Isuf Sejdia
	101	Shtegtimi
	102	Brahim Shaqa
Prapaqan	103	Qazim Shala
	104	Ukë Ibishi
	105	Asllan Dina
	106	Mustafa Pejçinoviç
	107	Hisen Gecaj
	108	Bekë Lajqi
	109	Jashar Ahmetaj
	110	Bolloboshnica
Prilep	111	Kreshnik Qufaj
	112	Brahim Qufaj
	113	Ali Tolaj
	114	Musë Kukalaj
	115	Malë Kukalaj
	116	Isë Halili
	117	Bekë Hulaj
	118	Imer Rama
	119	Miftar Latifaj
	120	Musë Latifaj
Rastavicë	121	Blerand Hasimi
	122	Sadik Kadrijaj
	123	Batalioni Atlantiku
	124	Amir Bego
	125	Shefqet Sejda

Ratish i Ultë	126	Rexhep Hasanaj
	127	Ukë Ukaj
Strellc i Epërm	128	Elez Shabanaj
	129	Selmon Hasanramaj
	130	Jakub Demalijaj
	131	Brigada Mergimi
	132	25 Maji
	133	Isuf Milaj
	134	Ahmet Povataj
	135	Shaban Mahmutdemaj
	136	Selim Alimusaj
	137	Zeqir Povataj
	138	Halil Zenelaj
	139	Haxhë Shabanaj
	140	Mulliri Istrefaj
Strellc i Ulët	141	Ali Hajdari
	142	Demë Rabushaj
	143	Zhel Hylaj
	144	Arif Jusaj
	145	Mehmet Pajazitaj
	146	Bajram Pajzitaj
	147	Daut Hylaj
	148	Selman Elezaj
	149	Eshref Rabushaj
	150	Ali Dautaj
	151	Demë Balaj
	152	Osman Pajazitaj
	153	Xhavit Kamishaj
	154	Shaban Bajramaj
	155	Sejdi Balaj
Gramaqel	156	Halil Dautaj
	157	Ukë Qelaj
Voksh	158	Ali Avdiu
	159	Demë Dobraj
Pozhar	160	Beqir Agë Vokshi
	161	Brahim Sokolaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit

02 Nr. _____ /2024 Dt. ____ / ____ /2024

DRAFT PLANI VJETOR I PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL TË SIGURISË NË BASHKËSI PËR VITIN 2025

HYRJE

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) funksionon duke u bazuar në udhëzimin administrative Nr. 027/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe vendimit për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi nga Kuvendi Komunal Deçan me Nr. 01.Nr.II-3 të themeluar me 30.12.2021.

Roli i KKSBB-së, është organ këshillues - konsultues për çështje të sigurisë, me përfaqësim të gjerë të të gjitha bashkësive të Komunës, si dhe përfaqësues të Shoqërisë civile, duke marrë parasysh edhe kriteret e përfaqësimit gjinor, i cili në bashkëpunim me policinë shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë në bashkësi në të mirë të të gjithë qytetarëve të Komunës. KKSBB-ja ka si synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive që lidhen me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e Komunës së Deçanit.

Qëllimi i KKSBB-së, është kryesisht i përqendruar në aktivitete për çështje të sigurisë, në bashkëpunim me policinë, qytetarët dhe institucionet tjera të sigurisë, bashkësitë fetare dhe përfaqësuesit e Shoqërisë civile për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet që lidhen me problemet e sigurisë në bashkësi, me synim të zgjidhjes konkrete të këtyre problemeve.

Plani vjetor i punës së KKSB-se për vitin 2025 përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSB-së me qëllim të realizimit të detyrave të parapara sipas Udhëzimit Administrativ. KKSB-ja nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e përcaktuara në këtë plan por do të jetë aktiv edhe në jetën e përditshme të qytetarëve, do të identifikoj dhe trajtoj problemet e përgjithshme të qytetarëve.

Objektivat KKSB-së :

- ❖ Mbajtja e të gjitha takimeve të rregullta për vitin 2025;
- ❖ Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e sigurisë;
- ❖ Monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së sigurisë në Komunën e Deçanit;
- ❖ Identifikimi i dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike;
- ❖ Parandalimi i veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi;
- ❖ Ndërtimi i besimit dhe bashkëpunimit në mes Komunës së Deçanit. Policisë së Kosovës, institucioneve tjera të sigurisë dhe qytetarëve në nivelin sa më të lartë që është e mundur me qëllim të rritjes së sigurisë në bashkësi;
- ❖ Rritja e sigurisë në shkollat në të gjitha nivelet;
- ❖ Të gjitha diskutimet, vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat e parashtruara nga pjesëmarrësit e KKSB-së, të zgjidhen në afatit sa më të shpejtë që është e mundur.

Nr.	Muaji	Agjenda	Folësit/pjesëmarrësit	Parashtruesit e kërkesës	Aprovoi:	Informon	Vërejtje
1.	SHKURT	- Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; - Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; - Situata në Komunë, me ndriçim, parkingje, mbeturina dhe pastrim të rrugëve, trotuareve dhe hapësirave tjera nga dëbora; - Siguria në shkollë, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme; - Situata me qentë endacak në Komunën e Deçanit - Të ndryshme	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtorja e Arsimit Drejtorja e MSHSHP	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	
2.	PRILL	- Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; - Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; - Situata me zjarre pranverore, fushore dhe malore. - Trotuaret, liri i tyre dhe shenjat sinjalizuese - Të ndryshme	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtorja MSHSHP	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	

3.	QERSHOR	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Plani Operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave 4. Të ndryshme	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtoria MSHSHP	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	
4.	GUSHT	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Fillimi i vitit të ri shkollor, gjendja e sigurisë në shkolla 4. Të ndryshme	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtoria e Arsimit	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	
5.	TETOR	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Diskutim rreth aktivitetit për sigurinë , infrastrukturën me personat me aftësitë e kufizuara në qasjen e tyre në institucione publike, biznese etj.	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtoria MSHSHP	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	

		4. Diskutim rreth aktivitetit për sigurinë e personave me aftësi të kufizuara-pengesat, ndalesat, shkallët, qasja në institucione dhe biznese private. 5. Plani operativ për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit. 6. Të ndryshme					
6.	DHJETOR	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Marrja e masave parandaluese për mënyrën e parandalimit të përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit 4. Aktivitet – Dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara. 5. Të ndryshme	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtorja MSHSHP	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	



Komiteti për Politikë dhe Financa

01.Nr.XII

Deçan, dt. 26.12.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e XII-të të rregullt të KPF-së, me dt. 26.12.2024.

Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtar të KPF-së, Drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi, Agnesa Vokshi, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, Ramë Melaj, Shefja e Inspektionit, Ajne Iberhysaj, Shefja Kabinetit të Kryetarit, Manjolla Shala, Zyrtarja për Informim, Edone Kameraj.

Fillimin e mbledhjes e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPS-së, z. Hajdar Sutaj dhe pas shqyrtimit të pikës së parë, kryesuesi ka kërkuar që të vazhdohet mbledhja nën udhëheqjen dhe kryesimin e znj. Hyri Dobrunaj, meqenëse ai ka disa obligime tjera në të cilat patjetër duhet të merr pjesë.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë dhe Planit të veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027;
3. Shqyrtimi i Listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komitetit të Komuniteteve;
5. Shqyrtimi i raportit të performancës komunale;
6. Shqyrtimi i Draft-Statutit të QKMF-së;
7. Shqyrtimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2024-2032;
8. Shqyrtimi i kërkesës së komunitetit të fshatit Pobergjë për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit për nevoja të komunitetit të fshatit Pobergjë;
9. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e XII-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së dhe konstatoj se 7 anëtarë të KPF-së janë të pranishëm në mbledhje, pastaj e prezantoi Rendin e punës, në vazhdim e hapi debatin rreth rendit të punës.

Meqenëse nuk kishte të lajmëruar për debat, Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Njëzëri miratohet procesverbali pa vërejtje.

II. Shqyrtimi i Draft-Strategjisë dhe Planit të veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027;

Kryesuesja e mbledhjes, Hyri Dobrunaj- e ka prezentuar pikën e dytë të rendit të punës, pastaj e ka hapë debatin rreth saj, por fillimisht fjala për Ajne Ibëhysaj si hartuese e këtij dokumenti.

Ajne Iberhysaj- ka thënë se për këtë Draft-Strategji janë zhvilluar të gjitha procedurat e shqyrtimit, është mbajtur edhe konsultimi publik, por nuk ka pasë propozime për ndryshim të tekstit, prandaj dokumenti është në versionin e parë, pa ndryshime.

Yllarta Thaqi- ka thënë se është një dokument i mirë dhe kërkohet vetëm të zbatohet në praktikë.

Hyri Dobrunaj-e ka vlerësuar si një dokument dhe punë të mirë të Ajnës, ndërsa ka kërkuar që te objektivi nr.3 fjala “femrat” të zëvendësohet me “gratë”, kurse te banimi social kisha pasë dëshirë me pa kurë do të realizohet.

Ajne Iberhysaj- ka sqaruar se te banimi social konkret te rasti i (Dashinocit) e kemi diskutuar, i kemi objektivat për këtë rast dhe do të punojmë në atë drejtim, në vazhdim Ajna ka thënë se rastet e dhunës në familje janë në rritje, komuna e ka dokumentin tani por niveli lokal nuk i ka mundësitë ligjore për kryerjen e shumë veprimeve parandaluese të dhunës, unë jam hartuese e dokumentit ka thënë ajo, por hartimi dhe ekzekutimi janë dy çështje të ndryshme.

Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar këte pikë për të cilën sqarime ka dhënë hartuesja, Ajne Iberhysaj, pas shqyrtimit KPF njëzëri e përcjellin për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, me rekomandimin që te objektivi nr.3 në vend fjalës “Femrat” të jetë “gratë”.

III.Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025;

Kryesuesja- e prezantoi këtë pikë pastaj e hapi debatin rreth saj.

Vatan Istrefaj- fillimisht ka pasë vërejtje që në mbledhje nuk është prezent iniciuesi i kësaj pike dhe nuk di si kemi me diskutu ne pa prezencën e tij, plus ka ardhë vetëm lista pa material.

Rifat Stojkaj- drejtor i BPZHR kërkon të njoftohet a është në listë parcela ku është Eco Tregu, nëse nuk është kërkon të futet në listë.

Yllarta Thaqi- thotë nëse na vjen materiali si duhet, ne mund ta diskutojmë.

Florim Mataj- thotë se ne jemi për shtimin në listë edhe të parcelës së Eco-Tregut, por si do ta epni sepse kini tentu edhe dy herë të tjera para kësaj, mirëpo te ky treg qëndron edhe fakti se nuk mirëmbahet fare ashtu siç është tash dhe kisha propozuar që këtë ta bënë Higjiena.

Faton Selmanaj- thotë se nuk është hera e parë por po përsëritet disa herë që na vjen veç një listë pa material.

Agron Muslijaj, i cili ka ardhë në mbledhje menjëherë pas fillimit të shqyrtimit të kësaj pike - thotë se ne e bëmë materialin (i cili është përcjellë në zyre të kuvendit pas shpërndarjes së materialit të mbledhjes), por për çka do të ipet çdo parcellë, aty vendosë kryetari sepse është kompetencë e tij, por në listë është edhe parcela Eco Tregut.

Vatan Istrefaj- parcela Eco tregut është në listë, por pse nuk mirëmbahet Eco Tregu bile nga Higjiena ashtu si kërkoj Florimi dhe është hera e tretë që na vjen kështu pa metrial kjo pikë.

Drejtori Rifat- ka sqaruar se si është vepru me këtë parcelë ku është i vendosur Eco tregu , si dhe për pengesat që kemi hasur në procedurë për shkak të gjendjes së pandemisë që kemi kaluar.

Faton Selmanaj- pyet Rifatin, si ka funksionu atëherë meqë deklarove se është hapë disa herë tregu.

Drjtori Rifat- sqaron se ne kemi tentu 4 herë në pandemi, ku dy herë ka punuar nga një javë por nuk ka funksionu.

Yllarta Thaqi- tani nëse dëshiron me zhvillu procedura dhe mi dhanë në shfrytëzim si do ta epni tash.

Hyri Dobrunaj- fillimisht ne kemi kërkuar për këtë pikë me u paisë me material dhe mu votu në fund të debatit, por tash pa material nuk di si do të debatojmë sepse nuk dimë ku janë faktikisht ato parcela.

Drejtori Agron Muslijaj- sqaron se të gjitha janë prona komunale dhe kërkohet të zhvillohet procedurë për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, por paraprakisht duhet të merret sot vendimi për këto parcela që të kemi mundësi gjatë vitit 2025 të zhvillojmë ato procedura.

Florim Mataj- për mu është në rregull kjo listë sepse në momentin kur vendoset të zhvillohen procedurat landa vjen komplet.

Rekomandim: KPF pas shqyrtimit të pikës dhe pas sqarimeve të dhëna nga drejtori, Agron Muslija, KPF e përcjellin për shqyrtim dhe miratim në kuvend me shumicë votash, 4 për, 2 abstenim (Hyri Dobrunaj dhe Faton Selmanaj). Në kuvend duhet të prezentohen edhe Fletët poseduese dhe kopjet e planit të gjitha parcelave që janë në listë.

IV.Shqyrtimi i raportit vjetor të Komitetit të Komuniteteve;

Rekomandim:KPF i rekomandojnë kuvendit që kjo pikë mos të shqyrtohet fare meqenëse nuk ka ardhë material për te, si dhe nuk ka ardhë personi zyrtar mi mbrojtje si temë.

V. Shqyrtimi i raportit të performancës komunale;

Rekomandim: KPF edhe për këtë pikë rekomandojnë mos të shqyrtohet meqenëse nuk ka ardhë zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e saj.

VI.Shqyrtimi i Draft-Statutit të QKMF-së.

Kryesuesja- e ka prezentu Draft Statutin e QKMF-së, pastaj fillimisht për sqarime fjalën ia kalon drejtoreshës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale, Agnesa Vokshi, e cila për të pranishmit sqaron se Drafti i prezentuar është formë unike që ka ardhë nga ministria për të gjitha QKMF-të e komunave të Kosovës.

Hyri Dobrunaj- thotë meqenëse është unik për krejt është në rregull, por te neni 30 të rregullohet kush është përgjegjës për zbatim.

Vatan Istrefaj- pyet a ka ndryshim prej Statutit të QKMF-së të vitit 2017.

Drejtoresha, Agnesa- përgjigjet, po, ka ndryshim, te neni 14- procedura për zgjedhjen e drejtorit, sepse qartë sqarohen procedurat këtu.

Vatan Istrefaj- thotë se te neni 14 pse jini ra ne kundërshtim me ligjin dhe ne QKMF e kini caktu një ushtrues detyre të Drejtorit i cili nuk i ka plotësu kushtet ligjore, dhe nëse hyn në fuqi ky statut çka don me ba me ushtruesin e detyrës së drejtorit, të emëruar ditë më parë.

Faton Selmanaj- thotë se në 2017 është miratu statuti i QKMF-së kurse në 2020 ka ardhë Udhëzimi Administrativ i cili e ka përcaktu qartë zgjedhjen e drejtorit dhe pse nuk janë bërë këto ndryshime sipas udhëzimit Administrativ.

Drejtoresha Agnesa ka dhënë sqarime.

Rekomandim:KPF e kanë shqyrtuar edhe këtë pikë dhe pas sqarimeve të dhëna nga drejtoresha, Agnesa Vokshi, Statutin e përcjellin për shqyrtim në kuvend, atje debatohet prap për te.

VII.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2024-2032;

Rekomandim: KPF edhe për këtë pikë rekomandojnë mos të shqyrtohet meqenëse nuk ka ardhë në mbledhje drejtori, për të dhënë sqarime rreth saj.

VIII.Shqyrtimi i kërkesës së komunitetit të fshatit Pobergjë për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit për nevoja të komunitetit të fshatit Pobergjë;

Kryesuesja e mbledhjes, znj.Hyri Dobrunaj- e ka prezentu pikën pastaj e ka hapë debatin rreth saj.

Vatan Istrefaj- thotë se kërkesa ka ardhë e kopletime dhe për mu është ne rregull.

Yllarta Thaqi- thotë se materiali ka ardhë në rregull dhe jam për.

Florim Mataj- jam për, pastaj procedurat të zhvillohen sipas ligjit.

Faton Selmanaj- edhe unë jam për.

Rekomandim: KPF njëzëri e përcjellin për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

Kryesuesja- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse, Dyke Llluni

Kryesuesja e mbledhjes së KPF-së
Hyri DOBRUNAJ



KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

DECANI

Mbledhja e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII , mbledhja e XI) me dt.30.12.2024

DEÇAN

e Hënë, 30 Dhjetor 2024

Hajdar Sutaj

Përsëritet anëtarë të Kuvendit, Kryetar i Komunës, drejtor të drejtorive komunale, përfaqësues nga shoqëria civile dhe gjithë ju të pranishëm, mirë se keni ardhur në mbledhjen e fundit të rregullt të vitit 2024 dhe ashtu siç i keni marrë edhe materialin ditë më parë, edhe kopje fizike dhe mënyrë elektronike, për rend dite kemi propozuar këto pika.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Strategjisë dhe Planit të veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komitetit të Komuniteteve;
5. Shqyrtimi i raportit të performancës komunale;
6. Shqyrtimi i Draft-Statutit të QKMF-së;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2024-2032;
8. Shqyrtimi i kërkesës së komunitetit të fshatit Pobergjë për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit për nevoja të komunitetit të fshatit Pobergjë;
9. Të ndryshme.

Fillimisht dhe si zakonisht e hapi diskutimin nëse ka dikush për me shtu ose me propozu diçka sa i përket rendit të ditës, Arian Dobraj pastaj Orges Tafilaj mundësisht e ndezni mikrofonin te Arjan Dobraj pastaj te Orgesi.

Arjan Dobraj

Faleminderit i nderuar kryesues Sutaj i nderuar kryetar i komunës Bashkim Ramosaj të nderuar koleg asambleistë, të nderuar kolegë nga drejtoritë e ekzekutivit, ne si grup e kemi një propozim lidhje me rendin e ditës, propozoi që në bazë të rëndësisë që ka si temë plani zhvillimor me të cilën edhe është punuar gjatë nga personat që janë të autorizuar për këtë punë, mendoj që të zëvendësohen me pikën e 2-të që i bie do të thotë që të jetë menjëherë pas shqyrtimit të procesverbalit do të thotë jemi propozim si grup dhe e 2-ta desha që te të ndryshmet pastaj ta bëje një raportim të shkurtër në lidhje me komisionet e bursave, pasi siç dini këtë javë ka dalë lista preliminare e fituesve do të thotë të studentëve fitues faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit zotri Dobraj, fillimisht po i dëgjojm propozimet e pastaj gjithsecilin propozim e qesim në votim, është lajmëruar për fjalë Orges Tafilaj, pastaj Mon Selmanaj, pastaj Albasa Cacaj, Orgesi e ka fjalën.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues, me qenë se sot është dita e vetera nëve, të gjithë veteranëve ju urojmë ditën e veteranit, dhe përkulemi para veprës së tyre dhe dëshmorëve të kombit. Realisht, unë fjalën e mora për çështjen që e ngriti Arjani, që komisioni për ndarjen e bursave në pajtim me rregulloren për ndarjen e bursa ve të raportojë sot ose mbledhjen e ardhshme, po meqë e ngriti Ariani, atëherë, pajtohem me kërkesën e Arian Dobraj.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kolegë nder dhe respekt përgjithmonë për veteran të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, për luftën dhe sakrificën e tyre, zotri Mon Selmanaj fjala për ju.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues përsëritet për të gjithë ju të pranishëm. Unë do të lidhem me pikën 4 shqyrtimi i raportit vjetor të komitetit të komuniteteve, unë nuk kam material në kopjet fizike as përmes emailit nuk më ka ardh material prandaj nëse kjo është si pikë 4 aëher unë propozoj që të hiqet nga rendi i ditës dhe rendi i ditës të miratohet pa këtë pikë ju faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë zotri Mon, Albesa Cacaj.

Albesa Cacaj

Përsëritet për të gjithë atëherë të nderuar asambleist në fillim të vitit hartojmë bashkarisht 1 plan të punës së kuvendit dhe vazhdimisht si këshilltare komunale kamë kërku që të përmbushet ky plan i punës, edhe pse jo në kohën osenë muajin në cilin është parapa, por brenda vitit të paktën të realizohet plani i punës. Shmangie ose mungesë nga plani i punës së kuvendit të komunës së Deçanit kemi në këto pika, në muajin majë është dashtë me ardhë raporti i planit të veprimit të këshillit rinor është plan i miratuar në qershor të vitit 2023 dokumenti i hartuar nga drejtorja e kulturës dhe i financuar nga departamenti i rinisë në minis trinë e kulturës sportive. Ky plan ka të bëjë me veprimin pjesëmarrjen arsimimin, punësimin, shëndetësisë dhe shumë çështje, probleme me të cilat ballafaqohen të rinjtë e Deçanit çdo ditë. Mungesa ose mos shqyrtim te pikes kemi nga raporti i komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave tjera publike pra u bënë pothuajse 3 vjet dhe nuk kemi 1 raport final për punën e këtij komisioni në qershor është dashtë të vij edhe të shqyrtohet, te diskutohet raporti i planit për barazi gjinore, mos të harrojmë të nderuar 22 vjet komuna nuk ka pasur plan kjo ka qenë kërkesë nga Apl-ja për monitorimin dhe zbatimin e këtij plani obligohet zyra e kryetarit nëpërmjet zyrës për barazi gjinore, e cila ka për detyrë të informojë në mënyrë të rregullt për arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të parapara në planin komunal për barazi gjinore, ku të paktën 1 herë në vit kryetari i komunës raporton në kuvendin e komunës mbi realizimin e këtij plani dhe në fund kemi prap shkelje nga kryesuesi i kuvendit te neni 11 pika 1 ku thuhet specifikisht që në seancën e fundit të vitit kuvendi aprovon planin e vet të punës për vitin që pason, pra për vitin 2025 në këtë seancë është dashur të vije propozimet e plani fillestar për vitin që pason faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Albesa dikush tjetër, atëherë nuk ka në rregull Vatan Istrefaj e ka kërkuar fjalën

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues përsëritet për të gjithë pasi që jemi në prag të festave të fund vitit, gjej rastin të ju uroj festat të gjithë ju të pranishëm, desha të ndalem tek pika e 4-t, pra te planit raporti vjetor i komitetit të komuniteteve nuk është hera e 1-rë që vjen për raportim ky raport dhe asnjë herë nuk vjen me material të bashkangjitur a jeni duke pasur komunikim me kryesuesin e komunitetit dhe çfarë? Me zyrën përkatse, edhe pse asnjë herë nuk vjen raporti pra pasi që këta mbajn mbledhje të rregullta çdo muaj faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë dikush tjetër i lajmëruar për rend dite me diskutu diqka nuk ka ? Atëherë fillimisht te kërkesa e Arionit pika e 4-të shqyrtimi dhe miratimi i planit zhvillimor komunal pzhk 2024 2032 po pika e 7 faleminderit, që të zhvendoset të jetë pika e parë diskutimet mbas shqyrtimit të transkriptit që i bie pika e dytë ju lus kush është për pa e votuar rendin e ditës veq kush është për me pas këtë lëvizje faleminderit a ka kunder a ka abstenim Konstatoj që me shumicë votash kuvendi i komunës e ka miratuar që pika e 7 të diskutohet tek pika e 2-të si pikë e rendit të ditës, pastaj e kemi si kërkesë të komisionit për ndarjen e bursave shqyrtimi i raportit kush është që kjo pikë të futet tek të ndryshmet

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që edhe kjo pikë futet si pikë e rregullt tashti më si pika e 9-të ndersa e 9-ta zhvendoset që është te të ndryshmet zhvendoset te pika e 10-të sa i përket pyetjes së kolegut zotri Mon Selmanaj në lidhje me pikën e 4-të nuk e kan sjell raportin jemi dakord që me larguar këtë pikë është në plan të punës me diskutu ë të njëjtën çështje e ngriti edhe Vatoni gjithashtu, kush është për me larguar këtë pikë

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që kuvendi në mënyrë unanime pikën e 4 e ka larguar si pikë të rendit të ditës. Te diskutimi i kolegës Albesa sa i përket raportit planit vjetor të kvll-ës është e vërtetë që janë 2 a 3 pika në planin e punës, të cilët nuk janë diskutu në mënyrë të përveçme po raporti planit të veprimit është diskutuar në kuadër të raportit të planit të punës së kryetarit të komunës. Pastaj të puna e komisionit për emërtimin e rrugëve, me të vërtetë kemi menduar që brenda vitit arrijmë me kompletu komplet dhe këtë çështje po situata ka qenë më e ndërlikuar sesa që është menduar, për shkak se gjitha propozimet të cilat komisioni i ka votu i kemi përcjellë

në agjencionin katastral të Kosovës, të cilët i kanë kthyer disa rekomandime kolegë të cilët janë këtu prezent, veç e dinë edhe është kërku që mu bo disa ndërrime të emrave të cilët përfaqësojnë familje të caktume ose sipas kritereve dhe ligjeve të cilat janë në fuqi dhe besoj që në seancën e janarit do ta kemi do ta kemi në diskutim plani i raportit për barazi gjinore nuk na ka ardhur asnjë herë kemi insistuar për ta pasur po e shihni që edhe plani të cilën e patëm për komunitete e larguan për shkak se nuk kemi pasur diçka të shkrueme, përderisa nuk kemi pasur diçka të shkruar nuk kemi pasur qysh me sjell përndryshe nëse jeni dakord, na mundemi me shti por përderisa nuk kemi material dhe ju jeni kunder të plani punes eshte tradite kuvendin komunal të Deqanit që ta miratojmë në seancën e janarit për këtë arsye edhe e kemi lene për seancë të janarit rregullisht kështu edhe kuvendet komunale me heret por edhe ne që 3 vite e kemi miratuar në janar të ju falënderuar për kontributin që e dhat sa i përket rendit të ditës më lejoni që ti lexoj pikat e rendit të ditës ashtu si që i propozuat do të thotë nën 1 e kemi shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e kaluar e 2-ta është shqyrtimi dhe miratimi i planit zhvillimor komunal pzhk 2024-2032 e 3-ta është shqyrtimi dhe miratimi i draft strategjisë dhe planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2024 - 2027, 4 e kemi shqyrtimi dhe miratimi i listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikuan për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, e 5-ta është shqyrtimi i raportit të performancës komunale, 6 është shqyrtimi i draft statutit QKMFS e 7-ta është shqyrtimi i kërkesës së komunitetit të fshatit, Pobjërgjë për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit për nevojat e komunitetit të fshatit po pobjërgjë e 8-ta është pika e shqyrtimit ose diskutimit të raportit të komisionit komunal për ndarjen e bursave dhe e 9-ta është të ndryshmet të cilat kemi pasë realisht po më lajmërohet edhe zyrtari i sindikatës që e ka një kërkesë e cila ju ka ardhur në imell të cilën e diskutojmë të ndryshmet. Para se me hap diskutimin e qes në votim me këto ndryshimet që e bëmë rendin e ditës kush është për A ka kundër?

A ka abstenim? është një abstenim?

Atëherë me 2 vota abstenim, ndërsa pjesa tjetër e anëtarëve të kuvendit me 18 vota për dhe 2 vota abstenim kuvendi komunal e ka miratuar rendin e punës për seancën e datës 30.12 e hapi diskutimin sa i përket pikës së parë shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e kaluar a keni diçka me thanë në lidhje me transkriptin e mbledhjes së kaluar meqenëse nuk ka të lajmruar për fjalë e qesë në votim kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatohet që kuvendi komunal e ka miratuar transkriptin e mbledhjes së kaluar. Jemi te pika e 2-të shqyrtimi dhe miratimi i planit zhvillimor komunal pzhk 2024 - 2032 fillimisht para se me kalu fjalën të drejtorit i urbanizmit zotëri Ram Melaj, më lejoni që ta përgëzoj kryetarin e komunës, drejtorin e urbanizmit zotëri Ram Melaj kolegë zyrtarët nga drejtoria përkatëse për punën e tyre shumë profesionale dhe gjithë ata të cilët çdo formë kanë dhënë kontributin e tyre në hartimin e këtij plani, i cili është shumë përmbajtësor por që është edhe thelbësor për zhvillimin e komunës së Deqanit në vitet në vazhdim drejtor zotëri Ram Melaj fjala për juve fillimisht ju lus që ta ndizni mikrofonin në foltore.

Ramë Melaj

Faleminderit kryesisht nderuar kryetar i komunës të nderuar drejtorë të drejtorive të nderuar asambleist të nderuar zyrtar komunal dhe ju gjithë pranishëm më lejoni të falenderoj edhe Ylber Veseli të cilin sod e kemi prezent nga osbe-ja këtu edhe profesorin Modes Gashi i cili është pjesë e hartimit të dokumentit e falenderoj shumë që ka gjetur kohë për me ardhur sod në këtë seancë të nderuar të pranishëm unë mendoj se seanca e sotme e asamblesë komunale mund ta quajmë edhe si seancë solemne, sepse sot para jush e kemi 1 dokument i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm për komunën e Deqanit mund të them dokumenti themel apo bazë e komunës së Deqanit në kuadër të viteve të ardhshme 2024-2032 e drejton zhvillimin e komunës së Deqanit në të gjithë sektorët në të cilët në komunën e Deqanit zhvillon.

Në momentin kur ne e kemi kompletuar dokumentin të planit zhvillimor komunal e kemi dërguar me datën 29.11 në ministrinë e ambientit për ta marrë vendimin për pëlqim për miratim nga asambleja komunale të këtij dokumenti dhe atë vendim e kemi pranuar me pranimin e atij dokumenti ne kemi vendosur të sjellim në seancë solemne për miratim të këtij dokumenti me miratimin e juaj këtu prezence që jeni i do të thotë dokumenti merr fuqinë e plotë të saj të zhvillimit. Të nderuar të pranishëm më lejoni që ti falenderoj shumë kryetarin e komunës i cili kontributi i tij ka qenë i pamundshëm për shkak se gjithmonë ka qenë aktiv gjatë hartimit të dokumentit dhe na ka mundësuar që të kemi edhe ekspertë të jashtëm, të cilët ka dhënë kontributin e tyre profesional siç është Modest Gashi, është Idriz Shala, Vlora Aliu që këta janë ekspertat mund të them më të mirë në kuadër të shtetit tonë Përpos këtyre që janë angazhuar, janë angazhuar të gjithë asamblistët që jeni ju këtu jeni të gjithnjë në njohuri si ka shkruar rrjedhat e këtij dokumenti, por janë edhe drejtor të drejtorive, të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në hartimin e këtij dokumenti edhe zyrtar komunal, pa marrë

parasysh në cilin sektor janë më lejonit ta falenderoj edhe kompanin () që e kemi pasur bashkpuntor gjatë hartimit të këtij dokumenti dhe mendoj që ky dokument e ka marr formën finale të gjithë neve. E veçanta e kësaj jamë i detyruar të falënderoj detyrën time, të cilët asnjë çast nuk kanë munguar gjatë aktivitetit të cilat kemi zhvilluar për hartimin e dokumentit dhe ka raste kur keni punu edhe jashtë orarit të punës, kemi punuar dhe vikendëve po duhet ta veçoj edhe 1 zyrtar që ka vlen me me të vërtetë me veçu Shkëlzeni, i cili ka punuar edhe të shtëpia në këtë dokument dhe mendoj që kemi arritur, atë që është më e mira e mundshme. Une them që ky dokument mund të jetë edhe baza dokumenteve të tjera që i kemi parë nëpër komunat tjera është punuar nga vetë zyrtarët komunal, drejtor të drejtorive dhe asamblistët e komunës mendoj se të gjithë jeni të njoftuar me krejt rrjedhën e dokumentit mendoj se edhe kontributi juaj është përfshirë të gjithë secili e mirë po dhe ajo që është më e rëndësishmja gjatë hartimit të këtij dokumenti, neve kemi apliku transparencën me qytetarët, sepse kemi organizuar shqyrtime publike në çdo lokalitet dhe mendimet e tyre i kemi marrë për bazë ato që ka leju ligji i kemi vendosur në dokumenta ato që nuk i ka lejuar ligji nuk kemi pasur qfar të bëjm se nuk ish pranuar dokumenti e mira e kësaj është do të thotë se çdo gjë është aprovuar nga ministria e ambientit nga departamenti për planifikim ndërtim dhe banim kështu që sot e keni dokumentin para jush ju jeni tash ata që e vendosni e miratoni këtë dokument i cili pa këtë dokument zhvillimi i komunës nuk do ishte bërë ne korniza të duhura kaq sa për sqarim të dhjedhës së këtij dokumenti që ka dikush ndonjë pyetje apo diçka mundeni lirisht me u drejtu do të mundohem me u përgjigj faleminderit që më dëgjuat

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtor e përgëzime për punën që e keni bërë tu fillu prej kryetarit juve si drejtor zotrit Shkëlzen për punën dhe përkushtimin e tij kolegët e tjerë të drejtorisë së urbanizmit, partnerëve dhe bashkëpunëtorëve, të cilët kanë ndihmuar në hartimin e këtij plani zhvillimor, ashtu siç e kemi edhe rregullin fillimisht ne emer të grupeve të subjekteve politike, e pastaj e hapim diskutimin për anëtar të kuvendit, nga grupi i AAK-s Arian Dobraj.

Arjan Dobraj

Faleminderit edhe njëherë kryesues poashtu shfrytëzoj rastin që pasi që jemi te tema e planit zhvillimor të përshëndes edhe ekspertin e fushës Modest Gashi të cilin po ashtu e falënderoj në emër të kolegëve nga grupi i asamblistëve të Aak-s për punën dhe angazhimin e tij deri në realizimin final të këtij projekti madhor por falenderim të madh meriton edhe kryetari Ramosaj për mbështetjen në veçanti që i ka dhënë anëtarëve të komisionit punues ose atyre që kanë kontribuar drejtor të drejtorive gjithë tjerëve në këtë dokument bazë apo themel siç e quajti drejtori Ram të mbarëvajtjes së punëve të të gjitha sferave të komunës së Deçanit nuk kemi diçka tjetër me shut, grupi asambleistëve së Aak-s e mbështet plotësisht këtë dokument faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Arian, nga grupi i Ldk- së Hyri Dobrunaj e ka fjalën.

Hyri Dobrunaj

Përshëndetje për të gjithë. unë kamë qenë në dëgjim publik kur ka qenë për asambleist dhe e kamë parë planin zhvillimor komunal ne si Ldk nuk pajtohem dhe nuk jemi pajtuar ne fillim që Deçani me qytet kompakt, sepse ne mendojmë se nëse doni Deçanin me shpall si qytet me destinacion turistik, atëherë nuk përputhet me Deçanin kompakt siç ju e keni parapa, mendoj që ky plan është bo për me i mbulu ose për me ...nuk përputhet edhe me planin zhvillimor ky plan është i punuar sipas kërkesës së ndërtuesve cilët po presin për ..që i kanë ngritur objektet për ti legalizuar objekte tyre që i kanë ndërtu edhe ky plan do të ishte i plotë nëse do të përputhet me planin e veprimt mjedis nuk përputhet as me ato. Ky plan do të ishte i plotë sikur përpara të ishin punuar hartat zonale dhe ne ta dinim cila pjesë qka do të paraqitnin në komunën tonë, kështu që ne e abstenojmë nuk e votojmë këtë plan faleminderit.

Hajdar Sutaj

Nga vetëvendosja Orges Tafilaj e ka fjalën.

Orges Tafilaj

Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, fillimisht i falenderoj të gjithë që kanë punuar në planin zhvillimor të komunës, që në fillim të dokumentit e kemi vendimin që është marrë për hartimin e planit zhvillimor komunal dhe ky vendim është marrë në vitin 2018, Neni. 7 që tregon, që flet për afatin e hartimit, tregon që ky dokumentacion ky dokument është dashtë formulohet dhe të krijohet brenda 18 muajsh. Kryetar ose drejtor, pse është dashur të pritet kaq gjatë për hartimin e 1 dokumenti të tillë me kaq rëndësi për

komunën, te pjesa e planit të veprimit realisht na kan ardhur shumë projekte, vlera e të cilave është shumë e madhe, arrin në qindra miliona euro, të njëjtën kohë janë qindra projekte. Unë e shoh që është vështirë të realizohen brenda një afati 8 mujor dhe kur jemi këtu, njëjtën kohë realisht kisha disa pyetje. E para stacioni i autobusëve, a do ndërtohet në vendin ku ka qenë? Përderisa e dijmë që aty ka një kontest pronësor, e 2-ta që për mua është e rëndësishme kur përmenden pendat në Grykën e Lloçanit, a është menduar të ketë hidrocentrale prapë aty apo edhe diku tjetër? Dhe njëjtën kohë në fund kisha sugjeru që projektet që janë esenciale për qytetarët të realizohen në fillim duke filluar nga 2025-ta, nëse nuk realizohen të gjithat, të paktën shkojnë paralelisht me ato të turizmit në beshkët, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Orges, Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues përshëndetje kryetar edhe pse kemi shumë kohë, shumë vite ndoshta që e presin me padurim plani zhvillimor komunal gjithë në këtu po dhe qytetarët unë si përfaqësues i partisë demokratike jap mbështetje këtij plani zhvillimor, edhe pse në vetvete ky ngërthen disa të meta që mendoj që ndoshta me kalimin e kohës do të mund të përmirësohen gjatë rrugëtimit edhe 1 herë unë i falënderoj të gjithë ata që kanë punu, sepse ma mirë 1 plan sado i vonë dhe me të metat të vogla të jetë është shumë më i mirë se mos me qenë fare prandaj unë jap përkrahje dhe mbështetje këtij plani zhvillimor.

Hajdar Sutaj

Faleminderit zotri Mon ju e dini që kryetari i komunës ka drejtë me u përgjigj çdo kohë dhe drejtori për urbanizëm këta ose munden me mbajt shenime me u përgjigjen në fund për gjithë ose kurdo që lajmëron për fjalën e kanë edhe tash është lajmruar për fjal Florim Mataj e lus regjin me ja leshu mikrofonin.

Florim Mataj

Përshëndetje kryesues përshëndetje drejtor kryetar koleg e asambleist gjithë të pranishëm sot para nesh e kemi planin zhvillimor pzhk 2024-2032 ky plan mendoj që është gjithëpërfshirës i cili parasheh zhvillimin e të gjithë sektorëve në komunën tonë zhvillimin ekonomik turizmin, planifikimin hapësinor, shëndetësi, arsim, bujqësi, kulturë dhe sektorët tjerë ky plan gjatë hartimit ka qenë transparent dhe gjithëpërfshirës po ashtu janë mbajtur dhjetra takime me qytetarët e komunës sonë dhe janë marrë propozimet nga qytetarët dhe janë inkurperuar në këtë planë ky dokument është dokumenti më i rëndësishëm që ka komuna jonë më lejoni ti falënderoj të gjithë ata ekspertë drejtor që kanë punuar në hartimin e këtij plani në krye me kryetarin Ramosaj kështu që unë jap mbështetje si asambleist dhe mendoj që është... nga sot ne do i hapim komunë tonë edhe një zhvillim në vitet në vazhdim kështu që unë i jap përkrahje dhe i falënderoj të gjithë ata që kanë punuar në hartimin e planit zhvillimor 2024-2032. Faleminderit shumë Florim a është dikush prej anëtarëve të kuvendit që dëshiron me marrë fjalën Miftar Ahmetxhekaj është lajmruar për fjalë.

Miftar Ahmetxhekaj

Përshëndetje për të gjithë, i vetëdijshëm se një prej dokumenteve më të rëndësishëm për zhvillim është plani zhvillimor komunal megjithatë për shkak të dilemave për shkak të paqartësive duhet 2-3 elemente ti potencioj. U tha dhe u vërtetua se plani zhvillimor është, nuk është prej dokumenteve multifunkionale është dokument i cili paraqet dhe përfshin zhvillim në vija të trasha, por është dokument i cili përfshin shumë fusha dhe ne veçanti, përfshirën edhe fushën e ndërtimit i cili prap po them dokument i cili buron nga 1 ligj që është ligji për planifikim hapsinor kur jemi te pjesa e ndërtimit unë jo që e njoh shumë mirë këtë fushë për shkak të përfaqësimit në institucion tjetër i kam dilemat se ky dokument nuk ka respektuar në detaje pjesën e ndërtimit me theksin në pjesët urbane, më saktësisht në afërsi të aseteve të trashëgimisë kulturore meqenëse jemi në këtë situatë për të respektuar edhe fushën time, unë rezervoj të drejtën time për ta mbështetur në këtë fazë këtë dokument faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë zotëri Miftar dikush tjetër, po Vatan Istrefaj e ka kërkuar fjalën.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues unë desha të ndalem pak vetëm tek pjesa e ndërtimeve për shkak të këtij plani zhvillimor, siç e dimë në komunën tonë, pra në komunën e Deçanit janë lejuar shumë mbi ndërtime pa leje atë pra keni bërë drejtorët së bashku me kryetarin e komunës dhe për këtë arsye i kemi edhe disa drejtorë të

dënuar me burgim nga gjykata themelore a mos është kjo arsyeja pse është vonuar prani zhvillimor deri më tani për tu japur legjitimitetin këtyre ndërtimeve, këtyre mbindërtimeve për leje, pasi që kjo është 1 plan kompakt dhe pastaj dispozitat për ato mbindërtime për tu pajisur me leje janë në rregull faleminderit.

Hajdar Sutaj

Dikush tjetër Leotrim Hadergjonaj e ka kërkuar fjalën.

Leotrim Hadergjonaj

Përsëritet për të gjithë kryetar kolegë asambleist drejtorë zyrtarë të urbanizmit, arkitektë prezent siq e dimë të gjithë plani zhvillimor komunal është baza zhvillimit ekonomik të një komune e cila i trajton çdo problem tjetër zhvillimit ekonomik, përveç ndërtimeve diskutimi publik ka qenë për çdo fushë si dhe arsim urbanizëm gjatë 6 muajve të fundit edhe çdo kërkesë është inkorporuar në këtë plan prej individëve apo qytetarët komunës Deçanit, qfar duhet me përgëzue ni aspekt se për herë të 1-rë në komunën e Deçanit po caktohet një zonë industriale e cila është bazë për zhvillim ekonomik për biznese ose kompani, fabrikat për të ardhmen a e kanë një zonë të caktuar industriale për këtë lami e plani zhvillimor komunal, besoj që i ka kaluar të gjitha mbikëqyrjet institucionale si komunale si të ministrisë dhe kur ka marrë aprovimin që është rregull nga ministria atëherë besoj që nuk ka arsye që të mos përkrahet nga ana jonë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Leotrim dikush tjetër nuk ka të lajmëruar për fjalë, atëherë edhe 1 herë t'ju falënderuar për kontributin që jepni ju si anëtar të kuvendin e diskutimet kryetar, kryetari i komunës Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

Kryetari i Komunës, Bashkim Ramosaj

Faleminderit kryesisht përshendetje për gjithë juve të nderuar asambleist kolegë po ashtu Ylber veçanti për ty se u gëzoja që të pash sot ktu gjithashtu rrespekt Modest dhe faleminderit për punën e madhe që keni bërë ju dhe komplet stafi i drejtorisë së urbanizmit e në veçanti drejtori që e ka pasur preokupim që një kohë tepër të gjatë në rast se kemi qenë të vëmendshëm në fjalën e drejtorit të urbanizmit e shpalli si seancë solemne ku me atë pretendimin që të gjithë ne duhet të jemi të gëzuar të përmbushur dhe po ashtu të lumtur që më në fund po arrijmë me pas një dokument që është plani zhvillimor komunal një sfidë tepër e madhe një sfidë në vetë e që është ndërlidh me faktorë edhe të jashtëm mirëpo edhe me faktorë të brendshëm, për shkak se është dashur me pasë një mendësi tjetër gjatë hartimit është dashur me pasë një ekspertizë tjetër gjatë hartimit si plan zhvillimor dhe është dashur me i arrit disa objektiva, të cilat nuk kanë qenë as ëndërr për komunën e Deçanit. E dini sa herë që jam pytur pse plani zhvillimor komunal nuk është i përfunduar dhe pse është kthyer sa e sa herë prej ministrisë, e cila ka pasë të drejtën ekskluzive zyrtare si subjekt për me e miratuar për me dhan lejen për me ardh në shqyrtim ose mos me dhënë lejen gjithmonë kemi thënë që sjemi të gatshëm që pa e inkorporuar një pjesë të interesave tona si komunitet si komunë si qytetarë të këtij qyteti nuk jemi të gatshëm për me pranuar në dokumentin të tillë dhe po më bën shumë përshtypje reagimi me kompetencë përreth këtij dokumenti ndoshta pa e ditur në tërësi kur flasim për planin zhvillimor nuk jam duke folur për ndërtimin më së paku jam duke folur për ndërtimin kur flasim për planin zhvillimor më së paku jam duke folur për objektet me leje ose pa leje të legalizuar ose të pa legalizuar sepse ka ligjë në Deçan që e rregullon fushën e legalizimit, pasë rrenimit të këtyre objekteve dhe po ashtu kur flasim për shumë objekte të ndërtuara në Deçan këtu jetoj dhe nuk po e di ku janë shumë objekte të ndërtuara në Deçan për faktë mirëpo janë ndërtuar 4 apo 5 objekte që i kanë jep shije qytetit dhe po besoj që ish dashur të rishikohen shumë norma ligjore dhe shumë ligje të cilat ndoshta pengojnë në një ecje. Po ashtu këtu ka njerëz që i përgëzojnë për qasjen konstruktive, sepse ndoshta kanë lexuar si materie pak më shumë është shumë vërtet shqetësimi për stacionin e autobusëve, sepse jemi në një kontest gjyqësor, ka përfunduar ky kontest gjyqësor realisht e ka fituar kontestin gjyqësor dhe të gjithë ne bashkë duhet me pas një projektion se ku duhet me u ndërtuar një stacioni i autobusëve dhe cila është metoda, mënyra që ne me pasë këtë stacion të autobusëve. Kur po flasim për pendat akumuluese në grykën e Lloqanit një projekt që e kemi mbrojtë përballë çdo qeverie, përballë çdo fondi buxhetor ndërkombëtar e detyrat projektuese kur i kemi japë në fillim e kemi thënë që duhet me u adaptuar me normat ose me konventat ndërkombëtare që janë të menaxhimit të pëllgjeve lumore ku kryesore për ne ka qenë ekosistemi habitatit që mos me pasë ndryshime negative dhe na është garantuar prej ekspertizave prej juris që e ka përcjellë e ka përzgjedh si projekt që nuk ka efekte negative në habitatin e ekosistemit në tërësi, e kur bëhet ky grumbullim na ka interesuar normal qashtja e sigurisë po ashtu na kanë dhënë këtë farë të drejte me menu që jemi duke e zbatuar, duke shkuar drejt një projekti i cili nuk e cenon jetën e qytetarëve ose pasurinë e qytetarëve në ndërkohë kapaciteti i ujëmbledhësit ka qenë detyrë projektuese që me prodhu edhe ujin e pijës ndoshta në

rast se qyteti i Deqanit rritet edhe për 100.000 banorë e po ashtu edhe për sistemin e ujitjes së pronave bujqësore në një mas tepërt të madhe e deri te asistimi që ndoshta edhe për komunat tjera sipas ekspertizës që e kanë bërë projektin ka mujt me pasë ujë të pijes në sezona të ndryshme dhe krejt në fund është fabrika e cila ka me prodhu me ambalazhim ka mu liqensu ka me u patentu janë procedura që unë nuk i kuptoj shumë mir se sjam marrur me to ndonjëherë dhe krejt në fund duhet me prodhuar dhe hidroenergjia jo me kuptimin e prodhimit të hidroenergjisë sikur jemi mësuar me pasë debate që në Deqan ka pasur debate e futjes lumit në gypa ose të ndalimit të një pjese Mirëpo që është në përputhje me konventat ndërkombëtare të menaxhimit të pellgjeve lumore me ndërtimin e pendave dhe po ashtu në zbatim të ligjeve të Republikës së Kosovës. Te harta te plani zhvillimor komunal dhe te harta sezonale jam duke folur për dy dokumente që realisht e suportojnë e mbështetin njëra tjetren mirpo nuk mundemi me hartu hart sezonale në asnjë mënyr pa e pasur planin zhvillimor komunal, është sikur me i thënë një fëmije pa mësuar abetaren ke me dalë në klasë të 4-t të shkolles fillore dhe po ashtu nuk ka familjet e Deqanit të komunës së Deqanit e cila nuk e ka pas mundësinë me i qasë me i propozu idet e veta nevoja të zhvillimit të biznesit të veta në këtë plan që shumica e njerëzve që janë në këtë asamble ose shumica e bizneseve të Deqanit e kanë sjell nga një shkresë e kanë sjell nga një ide që ne me ju japë munda mbrenda këtij plani zhvillimor komunal, ajo që është tepër e rëndësishme për mua është ata që e thanë 2-3 folës prej asambles e që i jep koncept të zhvillimit të sektorit më të rëndësishëm në Deqan që është turizmi për arsyen e vetme se kemi bërë një punë tepër të madhe një përkushtim tepër të madh që unë i falënderoj shumë njerëz që na kanë ndihmuar në këtë pjesë është nis në rrethana krejt thuaja të vetme mirëpo që na kanë mbështetur me pasë një zonë zhvillimore ose qdo bëshk me pasë zonën zhvillimore në gjeografinë e vet e deri te plani hapsinor i parkut kombëtarë ku komuna e Deqanit e ka i korporuar kërkesën për 750 hektar tokë në 18 () ose thonë më saktësisht në 14 () që janë më të rëndësishme për ne thjesht plani zhvillimor komunal ka të bëjë me zhvillimin ekonomik të shtetit ka të bëjë me ëndrrën e madhe për këtë qytet kan me qenë qindra miliona kan me qenë miliona te caktum ka me qenë aftësi e menaxhmentit dhe ka me qenë aftësi e jona që me bo drejt me kuptu buxhetin. Po si e tillë po ju lus sinqerisht them sinqerisht përkraheni këtë plan zhvillimor komunal sepse është plani ma e mirë që dikush e ka hartuar në Republikën e Kosovës për këtë ju garantoj faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kryetar e ka kërkuar fjalën si anëtar i kuvendin Arian Dobraj a mu dukë që e ngrite dorën, në rregull Leotrim a pate diqka për të shtuar në rregull faleminderit shumë, po drejtori Ram Melaj.

Ramë Melaj

Faleminderit kryesus një pyetje që e bëtë ju kryetari u përgjigj për të gjith dhe me të vërtet me pasë qenë në institutin e planifikimit ma mir nuk kishte mundur me thënë plani zhvillimor komunal duhet të dini një gjë është gjithëpërfshirës, nuk merret me legalizime, nuk merret me leje ndërtimi ne nuk kemi shanc me këtë dokument të bëjmë legalizim të ndonjë objekti ky është dokumenti bazë, i cili pastij vjen harta zonale e hartës zonale do të bëhet shqyrtime publike, do të bëhen gjitha takime me qytetarë dhe aty do ti vihen kornizat e ndërtimit do të thotë në tërë teritorin e komunës së Deqanit. Ndërsa sa i përket stacionit të autobusave ne e kemi parapa aty ku ka qenë nëse ai e ka fitu si kontest që është ne normal që me ndihmen e asambles mundemi me shpall me interes dhe apo diku tjetër nuk është me rëndësi. sa i përket pendave, pendat i kemi përfshir në këtë projekt mendoj që kemi bërë mirë dhe janë në plan të 1-rë kombëtar që pa qenë në planin hapësinor ne nuk kishim mujt mi futë në dokumentin e pzhk-ës kështu unë u dëshiroj suksese dhe punë të mbarë besoj që kjo është ajo që pata për me shut.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtor, Faton Selmanaj është lajmëruar për fjalë..

Faton Selmanaj

Përsëendetje kryesues, faleminderit për fjalën nuk e pata plan me fol hiq me ju thanë të drejten po drejtori pak më nxit me fol, sepse ka sa vite që komuna operon pa plan zhvillimor, spo e tregon të vërtetën pse pa plan. Qyteti është ngulfat nga ndërtimet pa leje asnjëherë inspeksioni nuk e kom pa, as nuk ka as në raporte zyrtar që 1 inspektim që ka bërë qoftë që kanë lëshuar ndonjë urdhër për rrënim apo veprime tjera kështu që bëhuni më të sinqert pak e keni lënë vet keni vepru gjatë pa plan zhvillimor komunal ju keni përshtat grupeve re interesit e tash vini këtu dhe thurni lavde po është e vërtetë që ka arsye edhe me votu për po thuajeni realitetin mbi të gjitha se për sa vite e keni lënë komunën pa plan zhvillimor komunal

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë po kryetar.

Bashkrim Ramosaj

Nganjëher po me vjen gjynah pse jam në këtë përball edhe me ndëgju ndoshta kësi diskursi Faton që e ke ti po më vjen shumë keq nga vetja më se pari, edhe prej të gjithë kolegëve këtu që janë për shkak se komuna nuk ka funksionuar pa një plan zhvillimor është një plan zhvillimor në fuqi i cili zëvendësohet me këtë plan zhvillimor kjo është në rast se po thu bëhuni të singert dhe në rast se po thu grupet e interesit ose po pretendon diçka, për nga inspeksioni nuk e ke haberin e punës që u bë nga inspeksioni dhe nuk e ke as haberin në ndërtime me leje ose pa leje në këtë qytet mua mv vie keq për kete qasje qe e ke më vjen keq sinqerisht për një djathtë këti shteti qe e ka nje qasje te tillë.

Hajdar Sutaj

Më thënë të drejtën po edhe pse emrin nuk tu ka përmendur Albesa a po vjen ulu ti këtu nrregull ligjin e di unë kaloja fjalën Fatonit.

Faton Selmanaj

E para punës kryetar ti ske nevoj me ndje keqarj dhe per mua sepse qytetarët me kan sjell këtu nuk me ke vendos ti e dyta ti duhet te ndjehesh i turpëruar që dy drejtorë me vendim gjykate i ke afër i ke në krahun tënd të djathtë këta 2 drejtura janë ndër njerëzit që kanë punuar në këtë plan kështu qe per mua ske nevoj me u ndje i turperum sepse vlersimin e japin qytetart smundesh me japë ti.

Hajdar Sutaj

Kështu më falni më falni të përmbahemi sa të mundemi më kështu nuk ka diskutime tjera faleminderit për kontributin që e dha gjithsecili ne diskutime, tha drejtorit që sot duhet me u nisesi seanc solemne në atë aspektin që kuvendi komunal e ka mundsin me miratu një nga dokumente si dokumentin kryesor që munet me pasë komuna e Deqanit sa i perket zhvillimit, kryetar të përgëzojm për këtë punë drejtor po ashtu, koleg ju tv gjithë proferor zyrtar te drejtoris dhe partnes të cilët e kanë dhënë kontributin në hartimin e këtij plani kaq të mirë edhe urojm suksesetë mëtutjeshme me kaq un e qes në votim planin kush është për ta miratuar planin zhvillimor komunal të njohur si pzhk për vitin 2024-2032 Falemnderit shumë 12 vota për, kush është kunder a ka abstenim? 10 vota abstenim 12 vota për kuvendi komunal e ka miratuar planin zhvillimor komunal për vitin 2024-2032 urime dhe përgëzime, Faleminderit shumë vazhdojm me pikën e 3-të që është shqyrtimi dhe miratimi i draft strategjisë dhe planit të veprimt për mbrojtje nga dhuna në familje 2024-2027 ftoj Ajne Yberhysaj për fjalën fillestar e pastaj hapim debat në diskutime në kuvend.

Ajne Iberhysaj

Përsëritet të nderuar të pranishëm kryesus anëtarët e asamblesë drejtor të pranishëm shoqëri civile dhe të gjithë ju, për mua është një kënaqësi e veçantë që sot jamë përpara jush ku para njëviti ju kam uruar vitin 2024 është mirë që drejtorja e urbanizmit të qëndrojë sepse iku një temë e cila u miratu dhe është shumë e rëndësishme plani zhvillimor komunal koha nuk më është kufizuar dhe kërkoi nga kryesuesit ta bëj këtë gjë, faleminderit atëherë në programin politik te subjektit politik të aak-së më është besuar nga kryetari i komunës për të hartuar ku pjesë e këtij programit politik, të cilin më është dashur të gjithë këto dokumente brenda legjislativ të cilin ju qëjeni për mua është 1 kënaqësi e veçantë që ju ndal gjithnjë shpesh përpara jush dhe ju kam prezantuar dokumente, draft, dokumentet dhe të cilat janë miratuar nga ju që ju falënderoj sinqerisht për punën, përkushtimin dhe angazhimin e juaj, por gjithashtu për nga plani zhvillimor komunal, duke filluar nga të gjithë dokumentet dhe ky dokument që është tani që përmbyll gjithë atë qëllimin tim që unë i kam vënë brenda këtij legjislativ dhe kësaj pune është me rëndësi që kemi përfunduar mbet pa falenderuar punën, përkushtimit të cilin kam punuar në secilin dokument dhe kam dhënë maksimumin tim po duhet të falënderoj edhe kolegun tim të punës se u dha shumë prioritet, nuk jamë kundër askujt ju them sinqerisht, falënderoj secilin koleg që mund të thotë çdo mëngjes edhe mirëmëngjes dhe nuk ka dëshirë, por duhet të falënderoj gjithashtu Enver Cocaj për punën, përkushtimin që kemi dhënë bazën, bazën bazën të plani zhvillimor komunal dhe do të thoja që do të ishte mirë që drejtorja e urbanizmit të ishte dikush këtu dhe të thonin pikërisht

Hajdar Sutaj

Ajne vetëm një pyetje do të ishte

Ajne Iberhysaj

stafi Shkëlzen Shehi ngjan ..

- Ajne një pyetje me ta bë

Hajdar Sutaj

Ajne më falë që po të ndërprej unë nuk dola nga tema,

Ajne Iberhysaj

por unë thashë të gjithë dokumentet draft dokumentet që sjellim vetë për 4 vite unë kam realizuar dhe plani dhuna në familje, i vetmi rekomandim plotësisht i është dhënë nga kpf-ja nga anëtarë i asamblesë komunale, e cila është Hyrije Dobrunaj falemnderit.

Hajdar Sutaj

Unë të kërkoj falje Ajne se nuk e pata me të ndërpre unë e pata thjesht kisha pyetje nga asambleistat nëse ka mundësi me na tregu pse u ndërpre transmetimi në rregull të kërkoj falje për ndërprerjen, sepse unë edhe nuk mbërri me e përcjellë vazhdimisht ashtu duke u transmetuar Ajne mundesh me vazhdu.

Ajne Iberhysaj

Një përparësi e komunës që ka raste të raportuara poshtë rasti të cila janë këto raste gjithnjë dhuna në familje është duke patur raste të shumta pranë në rritje gjithashtu dhe divorce, të cilat janë raportuar nga gjykata komunale gjithashtu ka pra rritje do të thotë është 1 gjendje shqetësuese në këtë drejtim, atëher të dhënat të cilat analiza gjendjes është bazuar nga të dhënat që kanë afruar anëtarët e mekanizmit të dhunës në familje është mbajt 1 takim me anëtarët e mekanizmit dhunës në familje me anëtarë të përfaqësueses asambles komunale të cilët kanë qenë pjesë e këtij takimi gjithashtu u mbajt dhe takimi, i cili është mbajt takimi publik në këtë kpf duhet të falënderoj edhe vetmi deri më tani që më është dhënë 1 plotësim ndryshim ka qenë vetëm nga anëtarë i asamblesë komunale nga lidhja lidhja demokratike e kosovës, që është pikërisht përfaqësuesja Hyrije Dobrunaj të cilët rekomandimi kanë përfshirë dhe janë pjesë e këtij sa i përket elektorim dhe redaktim unë kam bërë gjithmonë më të mirën e mundshme dhe redaktimin e këtij dokumenti gjithmonë ka shkuar në personat që janë specializuar të kësaj fushe atëher pres që ky dokument të jap të marrë si gjithë dokumentet e tjera, por është ajo që zbatueshmëria jynë edhe politikat buxhetore, planifikimit në të ardhmen pikërisht të janë në raport me këto dokumente, të cilat janë të miratuar nga anëtarët e asamblesë komunale falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë Ajne dhe me vjen keq se të ndërpreva vetëm për me i pyet pse ka ndodh ndalja e transmetimit sepse ishte edhe kërkesë kolegëve të anëtarve të kuvendit dhe më falë që të ndërpreva ishte vetëm kjo a jemi në rregull Falemnderit shumë Ajne falemnderit dhe përgëzime për punën me thanë të drejten të gjitha dokumentet që i ke pas ndoshta aty është veqar po sa i përket atij plani po ne nuk e dimë detalisht domethonë kush ka jep kontribut më shumë po e ki vlerësi min dhe respektin maksimal për punën profesionale që e bëni jo vetëm tash sa i përket draft strategjisë, po edhe për dokumente tjera të cilat ka hartuar komuna e Deqanit kolegë fillimisht nga grupi parlamentar të aleancës e ka fjalën Arjan Dobraj pastaj nga anëtarët e kuvendit gjithë shumë respekt falemnderit Ajne mundesh edhe nëse don të ulesh aty afër ose përball qysh ti e vlerëson veten ma mirë, jo po po drejtor pastaj ju i keni ato të cilat mundeni me i diskutu, prej grupit të Aak-s prej grupit të Aak-s a mundeni me u përqendru koleg Arjan Dobraj e ka fjalën.

Arjan Dobraj

Falemnderit kryesisht ndoshta e prishi pak nëse shtojë ndonjë fjalë nga ato të cilat i theti edhe ne e përgëzojm Ajnen edhe tash u bën 3 vite e pak që jemi dëshmitarë të punës madhore ose maratonike që dinë të krijoj Ajna pa ndashur me i anashkalu kolegët ose ata që kanë përkrahë këtë dokument, Ajna të përgëzojm për punën dhe të urojmë suksese në vazhdimësi falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë kush është nga Ldk-ja Hyrije a dëshiron me fol ti në rregull se nuk po e di kush dëshiron të flasë urdhëro Hyrije.

Hyri Dobrunaj

Ajne si gjithmonë që të kemi falenderu dhe të kemi mbështet në punën tënde edhe kësaj radhe është e njëjta

gjë mirpo diqka që më bëri me u ndi shumë keq fillimisht për ata dhe abstenova dhe procesverbalin është kur kërkuam me i ndryshu pikat e rendit të ditës e arsyeshme është në qoftë se drejtori thotë që unë kam punë e më duhet të shkojë dikund mirëpo sa i përket rëndësisë së pikave, unë besoj fuqishëm që ky draft strategji është shumë i rëndësishëm, jashtëzakonisht i rëndësishëm. Mirëpo këta e ndryshuan, sepse 1 është më e rëndësishme se tjetra e këtu po e dinë pse është më e rëndësishme kjo se sa kjo, edhe serioziteti i kësaj që ti ke punu më erdh keq për ty kryetari u ndje keq për veti, për ne që spo lexojmë po mua më erdh keq për ty që në momentin që kaloi pzhk-ja të gjith shkuan një nuk pati interesim me nejt këtu dhe me fol për draft strategjinë komunale për mbrojtje nga dhuna, e cila është shumë e rëndësishme mirëpo unë e di në fakt, kjo nuk është e rëndësishme për këta sepse kjo komunë nuk ka zyrtar për barazi gjinore këtë komunë të gjith dokumentin e punon Ajna sepse nuk...më falë kryesues fol ma vonë kur vjen radha edhe ty një minutë të lutem nese ki durim, nese nuk ke po e lë nuk ka lidhje mundem me lënë faleminderit për krejtë dokumentet që ti kanë dhënë ty si pjesë me bo, mirëpo dokumentet duhet me u zbatu e deri në fund kjo draft strategji më vjen keq se unë e di që ti ndihesh keq dhe kjo nuk ka me u zbatu as nuk ka mu implementu kurr Komuna e Deçanit prej muajit prill nuk ka pas asnjë cent me zhvillu asnjë aktivitet e lere ma për kete strategji e tjera si kjo faleminderit edhe një herë Ajne mirëpo edhe kjo si strategji të tjera të cilat janë në të mirë të qytetarëve mesin këtu sot me neve, drejtorët e kryetari nuk janë në gjendje as me i dëgju e planin zhvillimor komunal po edhe i 2004-s kanë pasur interes mirëpor kanë pasur interes atëher me lënë zonën e veçantë jashtë atij plani edhe sot kanë lënë xhانا që kam pas interes jashtë, por ato që kanë pas i kanë shti faleminderit kryesues.

Hajdar Sutaj

Faleminderit po ashtu nga Vetvendosja Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues Ajne, përgëzime për punën, fillimisht besoj që në faqën 5, fjalë e fundit e paragrafit të pare, duhet të riformulohet që të merr 1 kuptim, besoj ndoshta nga ngutija është harruar ndonjë shkrojnë ose ndonjë fjalë dhe po ashtu paragrafi i 2-të i faqes vijues në anën tjetër edhe në faqet 12 besoj që të mbrojtësi i viktimave duhet prapë të riformulohet që të merr një kuptim të duhur. Te plani i veprimit realisht janë parapa kosto që në total arrin 28.500.00. Ajne, kisha pyet a je kordinuar me drejtoreshën për buxhet dhe financa nëse janë mjetet dhe nëse këto mjete mund të parashihen për zhvillimin e këtyre aktiviteteve, sepse, kam frikën se si çdo strategji tjetër edhe kjo strategji do mbetet vetëm në letër dhe për hirë të performancës jo diqka e zbatueshme në fund si çdo herë dhe për çdo plan dhe strategji që na sjell këtu, Ajne a beson që realizohet vërtetë, apo është vetëm për performance, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges, ta përfundon edhe Moni..po zotri Mon a dëshiron Mon Selmanaj e ka fjalën pastaj ja kalojm fjalën Ajnes.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues mendoj se grupi punues për hartimin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit ka bërë një prej dokumenteve më të rëndësishëm të komunës i cili na prezanton të dhëna të institucioneve të ndryshme që punojnë në këtë fushë të cilat po që se implementohen nga mekanizmat relevant do të parandalojnë dhunën familjet tona dhe do të zhvillohen mirëqenien e shoqërisë sonë ky dokument na ofron në mënyrë të detajizuar qëllimet dhe objektivat strategjike kundër dhunës në familje. Hartuesit e këtij dokumenti na paraqesin edhe fushat e veprimit për eliminimin e pa barazive gjinore dhe dhunën në familje përmes arsimit dhe informimit, fuqizimin e bazës ekonomike, bashkëpunimin institucional etj. Në kapitujt e strategjisë, në paraqitjen dhe objektivat përmes aktiviteteve të specifikuar dhe sipas prioriteteve për zbatim, për implementimin e kësaj strategjie hartuesi i ka parapa edhe buxhetin për 3 vitet në vijim në shumën prej 28.500 euro mjete këto të cilat do të mundësojnë implementimin e kësaj strategjie me shumë interes vetëm se nuk është i specifikuar se nga cili kod buxhetor i merr ato dhe kishte me qenë me interes që ne ta dimë ju faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Mon, dikush tjetër nga kolegët Faton Selmanaj, Albesa Cacaj, Vaton Istrefaj janë me radhë Fatoni e ka fjalën.

Faton Selmanaj

Kryesues po e nisi fillimisht më pak jashte teme kështu nuk dua të bëhem paragjykas për këtë zotni që është

duke e transmetu seancën po është e disata herë që ka raste që nuk transmetohen fare ka raste që ndërprëjnë ka raste që nuk e përcjellin deri në fund kështu që veç po du met palajmëruar publikisht se do ti kontaktoje sot drejtuesit e kosovapressit dhe të interesohem për të vërtetën mbi transmetimin që është duke ndodhur në kuvendin komunal sepse ai zoteriu që më ofendoj këtu edhe pjesa ku unë fola u ndal transmetimi, u ndal vetëm pjesa ime jo e të tjerëve nuk është më këtu tash për kryetarin e kamë fjalën ndërsa sa i përket kësaj pike, po e përkrahim dhe e përgëzoj Ajnen për punën që e ka bërë

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë me thënë të drejtën, une i shkruva dhe do më thanë që ku është këtu edhe transmetimi live tha që është ndal rryma atje derisa ta ndezim gjeneratorin domethonë qeveria e territ e ka kthyer në të 2000-tën e patë Albesa Cacaj fjalën po më vjen keq për besë po më vjen keq apo kupton po tasht në gjenerator jemi kthyer, jemi duke i marr gjeneratorët jemi duke i kerkuar Albesa Cacaj e ka fjalën.

Albesa Cacaj

Atëherë edhe unë edhe 1 herë përsëritet për të gjithë edhe une jappërkrahje të pa kushtëzime planeve në përgjithësi që sjell zonja Ajna edhe që i punon me aq përkushtim, e vlerësoi punën e saj pa fund, por të jemi të sinqertë me veten fillimisht dhe me të tjerët, të cilët na ndjekin se edhe planet paraprake, siç kërkova dhe plani për barazi gjinore që nuk ka ardh në asamble raportit edhe ky plan dhe gjitha planet e tjera mbesin thjesht në sirtar janë obligim ligjor që duhet të plotësohen e që kërkohen edhe te raportit i performancës komunale unë e di që ky është obligim ligjor i dalë nga ministria e drejtësisë, por kam dyshime vazhdimisht sepse koha e ka treguar që këtu nuk realizohen nga paaftësia e përgjegjësve që e kanë për obligim ekzekutimin dhe mbikëqyrjen monitorimin për të arritur objektivat të cilat i parasheh ky plan faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Albese, Vatan Istrefaj e ka fjalën.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues, po filloj nga transmetimi i seancës probleme teknike ndodhin gjatë punës por nëse e marrim shembull komunën tonë ndodhin gjithmonë probleme teknike tek pikat më të nxehta që jemi gjatë diskutimit shpresoj që kjo të jetë vetëm problem teknik e jo ndonjë tendencë tjetër. Qështje tjetër është kryesus nuk ju duke udhëhequr seancën qysh duhet gjatë ditës së sudit, pasi që vjen kryetari, rrinë një pikë të cilën e ka me interes e pothuajse interesi të madh për komunën Deqanit është strategjia komunale për mbrojtje nga dhuna në familje pasi që janë rastet e rritura, por kryetari pasi e përfundoj pikën e planit zhvillimor nifare lloj () të shikon me vetulla që bëhet nervoz edhe del nga seance duke mos të rrespektuar ty si kryesues as duke mos të marrë leje që po del apo po hynë në seancë do të thotë këtu hyn e del sikur të ishte zyre private ky është kuvend komunal kështu që është mirë edhe ti me jep ato vërejtje tua si kryesues i kuvendit ku del kryesuesi nga seanca duhet të japë një arsye e kam një delegacion ose jam duke dalur vetëm për qef sikur në këtë rast u bë nervoz dhe doli jashtë nëse flasim për strategjinë dhuna në familje për të marrë fjalën për këtë strategji e mos me falenderu Ajnen nuk bën asesi, kështu që Ajne me gjithë rrespektin të përgëzoj për punën që e keni bërë desha të ndërlihem vetëm nëse keni ndonjë statistikë të rasteve të raportuara dhuna në familje nga polici e Kosovës respekti visht stacioni policor në Deqan nëse ke ndonjë numër jam i interesuar që ta dija atë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, ju e dini jam duke folur publikisht jamë si kryesus kuvendi ju kam drejtuar kosovapressit me vërejtje me shkrim te protokollume ta kamë dërguar kopje, jau kam lënë gjithsecilit këtu përpara personalisht ty edhe gjithsecilit a po kupton edhe ne rregull unë e kuptoj që jemi tu shku te zgjedhjet po zgjedhjet nacionale janë e para ti Albese je shumë e zgjuar dojmë me të shpallë në akademi të shkencave në rregull unë nuk jom ai që e ndali as një anëtar të kuvendit këtu as kryetarin e askënd sepse gjithsecili për juve mundet me pasë ndonjë nevojë që mundet për me dalë edhe nuk mundem me i pytë se ku po shkoni se mundet me pas nevoj mu përgjigj në telefon mundet me pas një rast mundet të ketë nevojë fiziologjike nuk e di tash nuk mundem me i thënë ndalu tek dera, megjithatë faleminderit për kontributin që e japët për pikën e 3-të, e cila është shqyrtimi i draft strategjisë për planin e veprimt dhe mbrojtjes dhunës në familje për pyetje të cilat i ngritëtja kaloj fjalën Ajnes për me dhanë përgjigjet.

Ajne Iberhysaj

Faleminderit atëherë sa i përket pyetjeve Orgesi është konsultu me buxhetin dhe gjithashtu a do të jetë

pikërisht i realizueshëm, gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti normal që konsultohen edhe pjesët e çdo dokumenti janë të gjitha drejtorit gjatë procesit të hartimit me datën 8 dhjetor në kuadër fushatës së 16 -të ditëshit kundër dhunës në familje ka qenë 1 prej kërkesave të cilat për vitin 2023 është themeluar mekanizmi kundër dhunës në familje, në të cilën unë jam caktuar nga kryetari i komunës, pikërisht koordinatore e këtij mekanizmit dhe pjesë e këtij mekanizmi, i cili ka të bëjë edhe pikërisht hartimi i këtij dokumenti. Për mua është shumë e rëndësishme se brenda 1 periudhe kohore, prej vitit 08.12.2023 dhe deri tani ne përmbyllëm pikërisht procesin e finalizimit dhe plotësimet me këtë dokument me këtë strategji. A do të jetë i realizueshëm pikërisht varet pikërisht rëndësishme është momenti që merr miratimin atëherë politikat e buxhetimit, planifikimet gjithmonë konsultohen, shqyrtohen, analizohen dokumentet të cilat kanë kaluar nga asamblja komunale. Pjesa tjetër se pikërisht kjo a ka kod të veçantë Mon Selmanaj, i cili bëri pyetjen në kuadër të zyrës së kryetarit është zyra e barazisë gjinore dhe kuadër të kësaj zyre pikërisht duhet të ndahen mjete buxhetore për plotësimin pikërisht mbështetjen e aktiviteteve sensibilizuese që kanë të bëjnë për çështjet e cilat kanë të bëjnë me të cilat po ballafaqua qoftë për 1 fuqizim të gruas në ekonomi, por gjithashtu në sektorët e tjerë që janë aktivitete të parapara edhe në planin për barazi gjinore dhe gjithashtu edhe në këtë dokument draft strategji që është për momentin të të cilat janë parapara aktivitetet me linja buxhetore që unë jam shkuar në atë form të jenë të realizueshme të kapshme dhe të matshme, duke marrë gjithmonë sipas parimeve brenda një kohe të caktura 3 viteve që ky dokument, pra të jetë edhe me linja buxhetore i realizueshëm. Mbetet gjithmonë politika planifikuese që ka të bëjë me planifikimin e buxhetit gjithmonë merret dokumentet të cilat janë miratuar dhe janë në fuqi të konsultohen dhe të përfshihen aktivitetet të cilat janë edhe me mjete buxhetore të realizueshme kjo mbetet pjesë e sektorit tjetër. Unë jam hartuese e këtij dokumenti sa i përket pjesës tjetër hartimin bjen ndesh një hartues i dokumentit deri te finalizimi ta sjellë deri në asamblë komunale dhe miratimi i tij që unë duhet ta mbrojë vazhdimisht dhe gjithashtu pjesa tjetër që ka të bëjë, monitorimi raportimi dhe zbatimi i takon komplet 1 zyrtari tjetër, sepse kjo është e specifikuar shumë mirë se edhe të jesh hartuese dhe të jesh pikërisht monitoruese zbatuese dhe raportuese që në mënyrë të vazhdueshme do të thotë se unë kam si hartues i këtij dokumenti gjithmonë raporti im do të jetë ma i miri të mirës sepse duhet ta bëjë dikush tjetër që nuk ka marrë pjesë ose mund të ketë qenë pjesë e procesit gjatë hartimit por te raportimi është diçka tjetër që duhet të caktoni zyrtar tjetër. Atëherë të a ka numër Vatani, i cili theksoi për rastet të cilat janë në rritje për vitin 2023, sipas duke u referuar, thashë anëtarëve të mekanizmit, pjesë anëtarët e mekanizmit është edhe stacioni i policisë janë edhe institucionet e tjera por referohem gjithmonë rasteve të raportuara nga stacioni i policisë dhe raporti që do të jetë përfundimtar raporti gjashtëmuor i barazisë gjinore është i hartuar është i protokolluar dhe keni në webfaqen e komunës është në vegëzën pikërisht tek njësia e barazisë gjinore pjesë e këtyre të dhënave, numri i referohem me kërkesë që do ta marrë nga stacioni i policisë dhe i cili do të jetë pjesë e raportit përfundimtar të raportit të barazisë gjinore. Raporti 6 muor është në webfaqen e komunës raporti vjetor i planit për barazi gjinore është në webfaqe të komunës do të jetë gjithashtu edhe raporti i rasteve të raportuar në stacionin e policisë duke u bazuar gjithmonë burimet anëtare të mekanizmit që do të jetë pjesë edhe numri i raportuar në stacion policisë të rasteve të dhunës në familje kaq faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Ajne Albese për replikë dashte Alebsa për repik është fjala, Orgesit po ashtu ju ka përmend emri për replikë ndersa fjalën e ka kërkuar Folim Mata po këta kanë te drejtë që kanë replikë.

Albese Caca

Kryesues edhe mbledhjen e kalumeseancën e kalumemur ke drejtuar me fjalët unë kam bërë shkelje që ty ta kam dhënë fjalën dhe nuk më ke jap mundësi me u deklaruar atëherë po ta them edhe të sodit edhe të mbledhjes se kalume ti kryesues je këtu thjesht udhëheqës i seances edhe roli yt nëse nuk e dinë është unifikues ti nuk ma jep fjalën mu, ligjet në fuqi ligji për vetëqeverisje lokale, statuti rregullorja ma kan jap fjalën me anë të votës së qytetarëve, të cilët më kanë zgjedhur me i përfaqësu edhe të cilët më vlerësojnë a me shku në akademi të shkencave, siç e theksove më parë kështu që ti edhe 1 herë po ta rikujtoj duhet të jesh unifikues i kuvendit jo përçart faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kolege dhe të kërkojë falje nëse u shpreha gabimisht po ne mundemi me pasë ndonjë moment që që nuk shkon diçka në rregull i kërkoj falje faleminderit për mirëkuptim Orges a pate?

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues, Ajne mora fjalën jo vetëm se përmende emrin, por edhe..

Faleminderit kryesues. Ajne, e morra fjalën jo vetë se ma përmende emrin, por edhe për ta sqaruar pse unë

hezitoj që plani është i realizueshëm, është arsyeja se sot jemi më 30 dhjetor dhe normalisht janë shumë aktivitete në plan të veprimit që janë parapa të bëhen gjatë vitit 2024, kështu që, për mua është e pamundur të realizohet, kjo ishte ideja faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Folim Mataj e ka fjalën.

Florim Mataj

Përsëritet kryesues unë dua të falenderoj Ajnen për punën e palodhshme që po e bënë, unë e ngrita një shqetësim që po ngritet nga të gjithë sidomos opozita desha të ja bëj një pyetje Ajnes a është mbështetja e kryetarit dhe drejtorive përkatëse në këtë planë kështu që është mir ta qartësojmë këtë pjesë se po mundohet të nxirret nga kontesti se mos me dasht kryetari dhe egzekutivi nuk e besoj që mundet me u realizu as me ardh këtu një planë dhe me u zbatu në të ardhmen kështu që kish me qenë mir me na dhanë a është përkrahja e kryetarit dhe drejtorive përkatëse faleminderit Ajne kështu që të uroj suksese edhe një herë për punën e palodhshme që e ke bë

Hajdar Stuaaj

A ke me u përgjigj Ajne Yberhysaj e ndezni mikrofonin në foltore.

Ajne Iberhysaj

Atëherë falenderoj gjithë secilin për pyetjet dhe gjithashtu për përkushtimin që keni dhënë dhe mbështetjen njëkohësisht në një proces të tillë, pak a shumë është i ndjeshëm sot për sot që ka të bëjë pikërisht me rastet të cilat janë në rritje të dhunës në familje. A është mbështetja e kryetarit, normal që është mbështetja e kryetarit, momente që unë e theksova në fjalën e fillim që pa mv thënë kryetari, unë nuk do të isha ajo që jam hartuese e 1 projekt dokumentit shumë të rëndësishëm strategjik planifikues që ka të bëjë pikërisht hapat të cilët kanë qenë edhe për procesin të cilin nga vini ju gjithashtu pjesë e atij procesi, siç theksova, ka qenë qëllimi im, dokumente të cilat i kanë paraparë mbrenda atij dokumenti të jenë pikërisht të realizueshme për mua është e rëndësishme që në vitin 2024 ti realizoj të gjithë të cilat janë pjesë e 1 procesi thjeshtë për ta mbajtur ndërgjegjen dhe fjalën në të cilën unë brenda ni procesit 4 vjeçar kam arritur ti realizoj normal që ka përkushtim, por gjithashtu brenda këtij përkushtimit mos shikojmë nganjëherë vetëm sa unë si hartues e këtyre dokumenteve që janë paguar e kanë bërë 1 punë, të cilën kam vënë qëllim vetes dhe jam, po them në atë kuptimin e fjalës krenare për qëllimet që kam arritur për ti finalizuar dokumentet që ka në planifikuar në programin të cilën ju ma keni besuar, sigurisht që ma ka besu kryetari i komunës me stafin tim të cilën unë e kam realizuar jo vetëm, asnjëherë vetëm nuk kam mundësi pa kolegët e mi mbështetës profesional theksova që unë dorë të djathtë e kam një prej kolegëve i cili është pikërisht këtu i pranishëm Enver () të falënderoj gjithashtu edhe për këtë dokument për planin për barazi gjinore, jam që 2 vite me vendim të kryetarit të komunës, që më është besuar për ta realizuar planin barazi gjinore, aktivitetet të cilat kanë të bëjnë për barazi gjinore, përfaqësimin e komunës në takimet, trajnime që më kërkohet nga agjencioni barazi gjinore dhe nga niveli qendror kështu që pa qenë vendim i kryetarit të komunës që unë ta realizoj një punë zyrtare të 2-të, nuk kam pasur mundësi që unë të vija edhe këtu para jush edhe ky dokument i cili ka të bëjë me 2023-tën ju theksova që është kërkuar në kuadër të 16 ditëshit kundër dhunës në familje, me mbështetjen përkrahjen që duhet ta falënderoj gjithashtu edhe osbe që ka...më vjen shumë keq që nuk është e pranishme sot por mënyra të vazhdojë që kanë kërku të themelohet mekanizmi kundër dhunës në familje ta ketë edhe komuna e Deçanit, pikërisht ky me anëtarët e mekanizmit kundër dhunës në familje, të cilat mbajnë takime të vazhdueshme, janë 3 takimet e cila ka mbajtur dhe këto 3 takime kanë qenë te përgjegjshëm të cilët janë thirr të cilët janë përgjigjur anëtarët e mekanizmit, ku pjesë e anëtarëve të mekanizmi, ka qenë edhe ky dokument që u shqyrtuar nga ata dhe unë po theksoj gjithnjë, në qoftë se nuk do të kisha vendimin e kryetarit të komunës, në qoftë se nuk do të kisha miratimin e tij, unë nuk do ta merrja forcën për me i ardhë me ju humb kohën me ju marrë kohën me ardh deri këtu për mua është e rëndësishme kjo që kam finalizuar gjithë procesin dhe duhet të ju falënderoj prap dhe dua të ju uroj prap 2025 sukses edhe jemi 1 legjislativ që unë gjithmonë jam ballafaquar me ju për mua është kënaqësi që ka marrë ndihmë dhe kemi shkëmby por gjithmonë në suazat e saj se për të mirën për të gjithë, pra për qytetarët e komunës së Deçanit, ashtu sikur ju edhe unë e kam qëllimet të përbashkëta faleminderit shumë për gjithçka që më keni mbështetur dhe jemi deri këtu shumë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Ajne faleminderit shumë, edhe të përgëzojm për punën juve edhe Enverin se e kamë mik shumë të mir, mirpo e qes në votim

Kush për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatohet që në mënyrë anonime kuvendi komunal e ka miratuar 22 vota për. Kështu kolegë keni me i marrë do dhurata këtu dhe kemi me hyrë lart dhe kemi me pregadit sikur vitin e kaluar pak ushqim ndonjë pije e kështu, po hyjmë në pauzë pak faleminderit shumë.

4 shqyrtimi dhe miratimi i listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe lista e veçantë e pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023 listën e keni a ka nga Aak-ja në rregull e përkrahin nga Ldk-ja Hyri Dobrunaj

Hyri Dobrunaj

Për shkak të materialitë kemi marrë sot materialin, por është vonë materialin e kemi kërkuar nga fillimi me sjell të paktën në mbledhje të KpF-s kështu që po e diskutojmë pak a e mbështesim.

Hajdar Sutaj

Në rregull nga Vetëvendosja, Orges Tafilaj

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues, realisht ne e përkrahim që më dalësi listë, megjithatë i kisha disa pyetje. E para, a kemi ndonjë vlerësim se ndërtesat që peshon në një pjesë e tyre, çfarë gjendje janë edhe a është parapa ndonjëherë nëse mund të investohet pak që të bëhen më atraktive për investitorët potencial dhe njëjtën kohë një pjesë e kullosa në mal që përmendet këtu, për çfarë destinimi mund të jenë, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Mon Selmanaj a ke diqka, pajtohet dhe e përkrah kryetari a ke diqka me thanë Kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën.
Orges nëse mundesh me e përsërit

Orges Tafilaj

Po, një pjesë e po shoh që ju në oborr shtëpi, shtëpi, ndërtesë, shtëpi, ndërtesë e 8-ta, 7-a, 6-a, edhe ideja ke çfarë gjendje janë këto ndërtesa, edhe a është parapa ndonjëherë që të bëhet ndonjë investim, qoftë riparues që bëhen më atraktive për investitorët potencial.

Hajdar Sutaj

Faleminderit kryetari i komunës e ka fjalën Bashkim Ramosaj

Bashkim Ramosaj

Kështu po filloj me e pasë një sqarim për të gjithë këto prona që ne i kemi listu për dhënie në shfrytëzim së pari komuna e fiton një të drejtë për shkak se ka prona të cilat janë komunale mirëpo që nuk e ka ndonjë përfitim prej tyre, ose thënë më mirë nuk e ka ndonjë kontroll ndaj tyre.
Shembull po e marrim në listat tek zalli i Strellsit nuk qa bëhet ose si bëhet aty dhe i kemi pasur disa konteste që ka qenë edhe prone e ujërave ka qenë pronë e Okp-së, mirëpo që është edhe pronë komunale dhe tashmë ky kontest është zgjidh dhe është bërë një farë vlerësimi për vitin e kaluar që është bërë vlerësimi total i pronave në aspektin valutues për ndërtesat janë.. ndërtesa na kemi pas si tendencë e kemi bërë një përpjekje bukur serioze për me e renovu një objekt këtu që është publik është ndërtesa e komunës mirpo nuk ju ka dhënë në bazë të një ligji të kaluar ju ka dhënë njerëzve në shfrytëzim për shkak të koncepteve që ajo kohë i ka pas dhe tashmë kur e hapim si ofertë nuk na ka lejuar për me renovu bazuar në kriteret që ne kemi pas për efikasitet, jo që i kemi pasur ne por shteti që i ka protokollu cilat janë kriteret ku mundesh ti me përdor buxhetin për me bërë një ndërtesë me efikasitet me lymë ja bërë dritaret me jau ndrru kall dajat gjera te tilla dhe nuk na është miratuar së paku 2 herë unë e di që kam bërë përpjekje por nuk na është miratuar dhe si trend tashmë kohëve të fundit është ardhë që ti mundesh me i dhënë me koncesion ku kompani të ndryshme të ndërtimit po kanë interes në marrveshje me banorët sepse si hapë ti mundesh me e dhënë në shfrytëzim por asnjë hapë nuk mundesh me bërë tutje nëse nuk e ki dakordimin dhe pëlqimin e banorve e që kjo është një ankand i hapur ku kompanit i ofrojnë më shumë edhe për komunën që me thene shkurt përputhen edhe me interesat e banorëve që janë aty atëherë pse mos me dhanë. E vlerësimi ka edhe për këtë pjesë vlerësimi monetar mirpo që nuk na u ka lejuar për me pas ndonjë renovim ose ndërtimi i cili ia kishte rritë vlerën e

çfarëdo forme dhënjes me koncesion në të ardhmen, unë ju kisha sugjeruar ju kisha lut që me me kalu si pikë për shkak se është ndoshta hera e 5-të ose e 6 që na e miratojmë këtë listë mirëpo që nuk kemi palë të interesume që vijnë për me i marr këto prona i kemi dhënë 2 deri tash ama çdo vjet e bëjmë këtë listim.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kryetar, Hyri Dobrunaj ka një pyetje.

Hyri Dobrunaj

Kryetar këtu kemi kuptu se përnime po keni problem me kuptu se ku janë këto parcellat unë bile kom kërku edhe 1 hartë me kanë e mundur edhe shejzru rrugët e për skaj tyne me kanë parcellat na me ditë përafërsisht se ku i lexojm kështu por unë e bindur jamë që as kolegët e mi nuk e din për cilat bëhet fjalë, e kam kuptuar në KpF se bëhet fjalë edhe për pazarin e kam kuptuar dhe po e shoh që behet fjalë po thot komuna e Deqanit shtëpia e shëndetit a ka kontest gjygjësor kryetar te shtëpia e shëndetit se unë e di që e shfrytëzojnë këta () nëse jame qartë për atë pronë se për këtë pasi që nuk e dim sakt se ku janë edhe pazarin a ka kontest gjygjësor për pazarin në Deqan nëse nuk ka kontest Ekotregu, nëse nuk ka kontekst, atëherë besoj dhe na e mbështesim edhe pse materiali prap po i jep vërejtjen time materiali ka ardhur vonë edhe është i mangët.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Hyrije kretari e ka fjalën me u përgjigj.

Bashkrim Ramosaj

Personalisht jam marrur me katastrin edhe nuk e di me keni prej drejtorëve kemi shku deri atje ne kataster që me ju than me pas kujdes ne qartësin e këtij materiali dhe kam qenë i bindur që ky material është qartësisht i prezatuar para krejt juve dikush duhet me më kërkuar falje edhe pse nuk qenka i beme ky material e para e dyta te ekotregu nuk është tendenca e parë që na e hapim si ofertë e jemi munduar në një kohë sidomos në kohën e pandemisë i kemi marrë disa masa për këtë ekotreg ku i kemi grumbulluar te gjithë këta tregëtar mobil që janë të cilët i kemi ftuar për me qenë pjesë atij ekotregu mirpo që nuk kan pranuar për shkak të qasjes ndoshta është edhe në natyrën tonë se si njerëz që gjatë rrugës që ecim pritojm me deviju rrugen me shku te ekotrego dhe kërkojm që me pasë karrshi rrugë mu ndal 2 minuta me bë pazarin dhe me shku e kemi mbajtur një kohë me zorë mirëpo ka rezultuar që askush nuk ka pas interes për këtë ekotreg për me marrë në fakt pronari i 1 pjesetë tokës që është ku është pazari tash i qytetit tregu i qytetit ka shprehur gadishmëri me marrë mirpo që nuk ka pasur ndonjë kosto ne si komunë nuk kemi mundur me përfitu diqka uroj që ndoshta me pas një ndërgjegje pak më të madhe edhe këta që blejn mirpo edhe këta që shesin për shkak të kushteve sanitare që duhet me i posedu një tregë dhe a i posedon këto kushte mirëpo që me pagu dikush diqka për me hy në funksion ky tregë nuk e ka shpreh gatishmërinë ende askush kryesore për neve është me qenë të gatshum me dhënë në shfrytëzim, a ka me paës palë të interesuara a nuk ka me pasë nuk e di nuk mundem me thënë uroj të ketë palë të interesuara që e marrin në shfrytëzim sa i përket këtyre ndërtesave shembull kemi venime prej të kalumes që është dhënë një parcell ku ka ndërtuar Likaj ku ka ndërtuar Gogaj dhe na ka mbet një ndërtes aty afër Drinit të bardhë e që janë bukur shum banor që e kanë shpreh gadishmërinë për me pasë marrëveshjen me kompaninë e cila e ka të ftuar në bazë një mandati mirpo që po duhet të renovohet si procedur edhe një herë uroj që edhe kjo me përfundu mirë për shkak që në aspektin vizual është e pa pranushme për qytetin me qellu ajo ndërtes ne atë form dhe se si është.

Hajdar Sutaj

Faleminderit kryetar Florim Mataj e ka fjalën.

Florim Mataj

E kemi diskutuar edhe atë ditë me drejtorin Rifat në komitet politik e financa është e vërtet që ekotregu që disa e ka përsëritë njëta procedur unë kam kërkuar atë ditë edhe nga drejtori që të mos na përsëritet prapë njëta procedur që disa herë është duke ndodhur kështu që ndoshta ka edhe ndonjë procedurë që mundet edhe komuna me me e marrë edhe me udhëheq vetë Edhe sa i përket u diskutu atë ditë që është edhe në gjendje jo të mirë kam kërku që ndoshta dhe higjiena ta bëjë pastrimin, rregullimin e tij kështu që kërkesa ime është që të gjindet ndonjë opsion tjetër i 2-të që të vihet në shfrytëzim ekotregi dhe tu japet tu afrohet mundësia qytetarëve që ndoshta ta marrin barrën ne ata ta kenë pagesën zero këtë e kisha si propozim faleminderit.

Bashkrim Ramosaj

E kemi pasur një kampanjë që tregtarët mobil mos mi lënë në gjendje të rrugës që shesin perime, zarzavate të ndryshme dhe kemi marrur këtë masë një kohë më vonë na ka rezultuar që është e pa... jo fort funksionale në jetë janë detyruar masandë që me i marrë disa me qera për shembull e keni parë të Cacak atje të kanali ose afër stacionit të policisë ose kur shkon të udhëkryqi i Carabregut janë detyruar me i marrë disa shitore me qera edhe me i qit këto produkte të veta dhe mandej janë bërë pengesë edhe për trotuarin deri dikund e tash nëse në këto kushte këto rrethana e ashpërsion gjobë për ta ose taksa për ta përbesë unë nuk jam i kësaj logjike edhe po na dhimben njerëzit me vështirësi po ja dalin me shkuar tash me ju vendosë edhe gjobë duhet me ju besë proceseve si komunë nuk e di që kemi me pasur produkt prej saj përpos që kemi me shpenzuar shumë para për me mbajtur gjallë, kemi me hargjuar shumë mjete për me mbajtur në funksion

Hajdar Sutaj

Faleminderit kryetar faleminderit Florim dikush tjetër Miftar Ahmetxhekaj

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë, e para të materiali po përsëritem por me gjithatë ishte dashtë të vijë më heret në këtë nuk ka dilema e dyta të emertime nuk po duam me shfaqur por megjithatë janë marrë emertimet nga fletat poseduese që është qertifikatë pronësisë dhe faktikisht kështu janë a është dashur të jepet një qartësim ma të mirë për ne me kuptuar se jo se në secilin rast të gjeoportalit ta tregon parcelën mund të jap një numër 46-90 por mund të jetë gjeoportalit gabim dhe nuk ma pasqyron parcelën. Meqenëse i kemi 19 prona po e shoh që pjesa dërmuese po e quaj janë ma shumë () të cilat janë të pashfrytëzueshme a ka një pronë këtu që ndër vite e dhënë ndonjë herë në shfrytëzim prej këtyre 19 që i kemi këtu, nëse po a ka ndonjë raport thjesht po cila ka qenë benefiti i komunës së Deqanit nga kjo punë që i ka dhënë në shfrytëzim.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar, Yll lësho mikrofonin të kryetari.

Bashkrim Ramosaj

Nuk e besoj që ndonjë nga pronat është dhënë në shfrytëzim ndonjë herë nuk e besoj në rast se flitet për një parcelë e ka edhe një natyrë pak më ndryshe të spjegimit për shkak se është dhënë në 2001 një pjesë në shfrytëzim dhe është fituar me kontest gjyqësor ku pala ka pasur të drejtë, mirëpo që është shkuar në gjykatë supreme procedurë në vizion bëhet fjalë për fshatin Strells nëse e patë fjalën për këtë është dhënë në kohën e Mehmet Bujkut në shfrytëzim mandej i ka skaduar afati i kontratës pala e ka fituar me të drejtë në bazë të arkivës dhe në bazë të gjykatës mandej kjo ka shkuar prej avokatit të komunës ka shkuar në provizion është procedurë që është afër mbylljes nuk besoj që ka ndonjë lëndë tjetër e cila mundet me u dhënë në shfrytëzim.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë dikush tjetër atëherë e qesë në votim kush është për? faleminderit A ka kundër?

A ka abstenuim?

Konstatohet që kuvendi komunal në mënyrë unanime e ka votuar listën e përgjithshme, prona të paluajtshme dhe listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie dhe shfrytëzim vitin 2025 dhe vazhdojmë tek pika e 5-të që është shqyrtimi i raportit të performancës komunale raportin e keni në emër të grupit të Aak-s Arjan Dobraj.

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesues në fakt. kemi thënë edhe shpesh po është për tu përgëzuar normalisht puna që është bërë vitet e fundit unë e kom pa vetëm deshta mu u ndal pak diçka nuk e di janë gabime a po qfar për shembull të 13.1.2 gratë thotë në pozita udhëheqëse në institucione arsimore, shëndetësore, kulturore dhe sportive është shënuar me 0 për shembull ka dikund 4-5 vende gabime të tilla po e quaj gabim për shkak se ne i kemi të vendosura gratë nëpër institucione nuk e di tash pse a nuk kemi pozita udhëheqëse a kom pa dëmet në 3 a 4 vende gabime të tilla për ndryshe nuk kemi diçka tjetër me shtu ndoshta janë gabime teknike nuk po e di faleminderit.

Hyri Dobrunaj

Të kënaqun se nuk e kemi përfituar grantin me performancë me pasë qenë mirë performanca e kishim fituar edhe në grantin nuk e di ku është problemi a është problemi të raportimi jo i duhur a është të vonësia e raportimit atë ju duhet ta dini më mirë se sa ne mirëpo edhe unë e kam vërejtur këtu disa që unë e di që veq kanë

ndodhur në komunën e Deqanit janë të raportuara me zero disa që nuk kanë ndodhur e shoh një përqindje shumë më të madhe se sa ka ndodhur hiq domethënë ky raport nuk është i saktë ku është problemi ju duhet me kqyrë unë sjame kënaqur, momentin që s'kemi përfituar kurrë grand performancë do të thotë që performancat sekemi të mirë për 1 arsye ose tjetër ata e dini ju më mirë. Faleminderit shumë prej Vetëvendosjes Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesisht, realisht ne kemi diskutuar shpesh edhe kur e kemi ndërlidhur me raportin e auditorit që një pjesë e madhe është për shkak mos raportimit në kohën e duhur dhe mënyrën e duhur, megjithatë po i referohem dokumentit që e kemi sot për rend të ditës fillimisht për mu shqetësuese është niveli i adresimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit vlerësimi është mbi 0 po është i ulët të njëjtën kohë niveli i pagesave brenda afatit ligjor prej 30 ditëve kjo besoj që është ndiku shumë edhe nga përbarimet e ndryshme që nuk kanë leju që pagesat me u kry brenda 30 ditëve, shqetësuese po ashtu është edhe realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit, që është me zero këto që po i cekim me zero ndoshta nëse nuk është raportuar kisha pas qef me marrë përgjigje ndodh që nuk janë zero pjesa tjetër është realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave ne e kemi kalu ktu planin komunal për menaxhim të mbeturinave megjithatë pse është vlersuar zero a nuk u realizua vërtet apo është realizuar pjesërisht dhe nuk është raportuar, ndërtesat e reja që kanë zbatuar lejen mjedisore komunale a është e vërtetë që asnjë prej tyre nuk e ka zbatu lejen komunale lejen mjedisore komunale dhe normalisht pjesa që e ngriti Ariani për gratë e punësuar në institucione arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive në pozita udhëheqëse dhe në të njëjtën kohë kjo ndërlidhet edhe me përfaqësimin gjinor në këshillat e fshatrave fatkeqësisht është shqetësuese një pjesë ndoshta ka ndikuar pak edhe mentaliteti tek pjesa e këshillave të fshatrave edhe pse ne bashkërisht besoj që është dashtë të bëjmë më shumë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Mon Selmanaj.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesisht ky raport i performancës i ofruar në këtë formë pa asnjë shenjë identifikuese të asnjë institucioni për mua është jo serioze dhe diskutabil. Çdo dokument zyrtar duhet ta ketë paktën stemën e komunës vulën e një organi nënshkrimin e personit të autorizuar etjera në këtë rast ne nuk e kemi asnjë nga këto përveçse zyrtarët komunalë raportuan për performancën e vitit 2023, në brendi të këtij raporti ne kemi shumë mospërputhje pa saktësi në përqindje dhe të dhëna, po e lexoj disa nga raporti për shembull te shërbimet publike administrative, te paragrafi 2.1.1 thotë mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejt online 49.09, ju e dini se transmetimet online bëhen, nga ky vit kanë filluar e jo në vitin 2023 tjetër te përgjegjshmëria komunale 3.1.1 publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takime publike është zero është notuar me notën zero me sa unë e di qdo rregullore draft rregullore draft strategji këtu i kanë edhe diskutimet publike në kohë të caktuara, prandaj jo në të dyja këto janë të notuar me zero përqindje vazhdojmë 3.2.6 mbledhjet e kuvendit komunal me pjesëmarrjetë kryetarit të komunës qindpërqind çka këtu ka mospërputhje, sepse kryetari në disa takime po mungon edhe këtë vit dhe vitin e kaluar e tjerë në fakt është përqindja është qind për qind tjetër raportimi i planit, pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me aktakuzat e ngritura ndaj tyre qindpërqind e në fakt është krejt ndryshe tjetër aktivitetet e kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal 0 për qind ne, po e marr shembull festivalin () mbi shkëlzen domethënë edhe kjo përqindje nuk qëndron, por e marr vetëm një si shembull ka edhe të tjerë, tjetër infrastruktura rrugore, gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare është zero përqind unë veç 1 shembull nga Prokulluku në Jerznik është ajo që u bë përveç tyre që janë ndërtuar këtë vit e kemi domethënë, i kemi edhe një trotuar që nuk e di a ka diku tjetër, po që kish me e ngrit këtë përqindje në performancë, te shërbimet publike, paragrafi 11.1.2 realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit është qindërqindë a mundet dikush me na dhanë ndonjë sqarim këtu tjetër te përfaqësimi gjinor 13.1.2 gratë në pozita udhëheqëse në institucione arsimore shëndetësore dhe unë e potencova po e potencoj sikur kolegët i kemi në shkollën fillore në Glllogjan e kemi drejtoreshën Femer, domethënë edhe drejtoresha e shëndetësisë dhe kjo e kulturës, domethënë këto performanca zero në realitet qëndron ndryshe Nuk e di këta zyrtarë a janë që rri në shtëpi apo janë zyrtar komunal të cilët i kanë dhënë këto edhe mos me qenë në gjendje me raportu me këto çka i shohin me sy e i prekin qdo ditë, këto i pasna pasë të gjeturat e mia në këtë raport ju faleminderit.

Hajdar Sutaj

Kryetar a ti a Manjolla Shefja e kabinetit Manjolla e ka kërkuar fjalën, urdhëro Manjolla kryetari fillimisht e ka shkurt një fjalë e pastaj Manjolla.

Bashkrim Ramosaj

Manjollen e kemi ngarkuar me këtë detyrë që me u kujdes për performancë bashkë me një ekip që e mbështet por dua të them paraprakisht diçka që e thatë shumica prej jush është krejtësisht e raportimit dhe po ashtu afati i raportimit është gabim në këto dy gjëra faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit kryetar Manjolla Shala e ka fjalën.

Manjolla Shala

Përshëndetje për të gjithë unë në shkurt të këtij viti jam caktuar si koordinator e procesit të raportimit për performancë komunale nga kryetari së bashku me 14 zyrtarë tjerë raportues nga të gjitha drejtoritë dhe sektorët ku janë kërkuar të dhëna, e pra raporti i performancës komunale treg pasqyron punën që është realizuar përgjatë 1 viti në vitin 2023 kanë qenë 85 tregues prej 16 fushave, të cilat janë në përgjegjësi të komunës unë po i sqaroj disa prej pikave treguesve ku i kemi marrë 0 pikë edhe diku kemi pasur ndoshta nivel më të ulët ka qenë publikimi i njoftimeve për mbajtjen e takimeve publike këtu ka qenë problem për shkak se nuk janë postuar 2 ftesat e takimeve publike në të 2 gjuhët zyrtare ka munguar në gjuhën serbe për atë arsye jemi vlerësuar me 0 pikë kemi pas pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultime publike ka munguar 1 raport që pas çdo konsultimi publik duhet që me u përpilua 1 raport i konsultimit publik edhe ne nuk e kemi pas këtë raport po ashtu e njëjta vlen edhe për aktet komunale, dokumentet publike lokale të konsultuara me publikun po ashtu edhe tek publikimi i raportit për procesin e konsultimeve publike nuk kemi pasur raporte konsultime publike, tek hapësira për aktivitetet e sportit, kjo ka qenë në kuadër të drejtorisë për kulturë rini dhe sport dhe aktivitetet e kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal ne krejtësisht e dimë se të gjitha aktivitetet që janë mbajtur për gjatë atij viti edhe kostot sa kanë kushtuar krejtësisht po këtu kërkohej të gjitha dokumentet që duhet të ngarkohen në sistem duhet të bazohen sipas 1 dokumenti kryesor që është i hartuar nga ministria e administrimit të pushtetit lokal dhe nëse bashkëngjitet ndonjë dokument që nuk është sipas dokumentit, atëherë ai nuk pranohet si dëshmi e saktë. Ne kemi bashkëngjitur domethënë vendimet për pagesat që janë mbajtur në këto aktivitete, apo edhe për sa i përket hapësirave për aktivitetet e sportit është dashur me qenë të shënuara në raportin vjetor të drejtorisë por nuk kanë qenë dhe për këtë arsye i kemi vlerësuar me zero pikë, është vlerësuar nga ministria e administrimit të pushtetit lokal kemi sipërfaqje të territorit të komunave të mbuluar sipas planit zhvillimor të komunës, për shkak se ka munguar plani zhvillimor komunal, nuk është marrë si dëshmi apo nuk janë pranuar dokumentet tjera të cilat ne i kemi bashkëngjitur në raport. Kemi sipërfaqetë këto sa i përket hapësirave publike, infrastrukturës rrugore të gjitha këto që i vlerëson 0 ka qenë vetëm mungesë e planit zhvillimor komunal edhe mungesa e hartave zonale që dokumentet e tjera që do që ne kemi bashkëngjitur nuk janë pranuar si të sakta apo si dëshmi që këtu ekzistojnë, tek realizimi i planit komunal për transport lokal publik, planin është kërkuar që të bashkëngjitur plani i mobilitetit parasysh që është mungesën e nuk është pranuar si e saktë kemi pas realizimin e planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit janë kërkuar që të bashkëngjiten kontratat për punë të realizuara që janë kryer disa punime, por për shkak se si kemi pas këto kontrata, jemi vlerësuar me 0 pikë. Është () i planit kombëtar për menaxhimin e mbeturinave është e vërtetë që ne kemi 1 plan për menaxhimin e mbeturinave, por nuk kemi pas raport për punët e kryera dhe për shkak se nuk janë përputhur domethënë të dhënat që janë vendosur te raporti nuk janë përputhur me planin, atëherë jemi vlerësuar me 0 pikë, kemi ndërtesat të reja që kanë zbatuar lejen mjedisore komunale këtu është dashur që mu vendos në raportin vjetor të drejtorisë dhe për shkak se nuk kanë qenë të vendosura në raport të drejtorisë ne kemi përpiluar 1 raport me qëllimet e raportimit, mirëpo nuk është pranuar si saktë për shkak se nuk kanë qenë të shkruara në raport vjetor. Gratë në pozita udhëheqëse në sesionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore këtu është kërkuar që të dërgohet lista e pagave nga që merret nga zyra e personelit ne kemi së bashku me zyren e personelit ne kemi përgatitur, domethënë 1 listë të këtyre që janë kërkuar të grave në këtë rast, mirëpo nuk është pranuar si e saktë për shkak se është dashur të dërgohet lista e pagave, por për shkak të që nuk është lejuar ne nuk i vendos jemi vlerësuar me 0 pikë. Barazia gjinore të këshillave lokale është shqetësuese për shkak se nuk kemi, as nuk kemi asnjë femër në këshill lokal. Buxheti dhe shpenzimi i përgjithshëm gjinor këtu unë mund të them se është.. jemi vlerësuar padrejtësisht me 0 pikë për shkak që janë të vendosura dhe buxheti gjinor është i publikuar po ashtu dhe ne krejtësisht e dinë po nuk është pranuar si i saktë, unë kam dërguar edhe ankesë por nuk më është pranuar, e planit komunal për barazi gjinore edhe këtë e kemi pas por nuk e kanë pranuar si të saktë, shkolle me masat e efikasitetit të energjisë e

këto janë ne kemi dërguar raporte të cilat janë marrë nga sistemi fëmija mirëpo është dashur që të gjitha këto që janë vlerësuar tek arsimit është dashur që të vendosen tek raporti vjetor i drejtorisë mirpo për shkak se nuk kanë qenë, nuk janë pranuar si të sakta edhe strategjia për zhvillim ekonomik lokal ka munguar dhe për atë arsye kemi marrur zero pikë, nëse keni ndonjë pyetje tjetër.

Hajdar Sutaj

Të falenderojm shumë dhe të përgëzojmë për komunikimin, është lajmruar për fjalë Florim Mataj dhe po veç Florimi pastaj më radhë mundësisht e lëshoni mikrofonin te Florimi dhe mundësisht e afron mikrofonin Florim.

Florim Mataj

Përsëritet kryesues raporti përfundimtar i performances për vitin 2023 komuna e Deqanit nga kolegja ne fjal u raportuan gjithashtu që gjithashtu veprime ka ndodhur në komunë qfar mund te ketë një neglizhenc ndoshta administrative që ne si komune dhe është duke u na përsëritur vit pas viti. kështu që kisha kërkuar nga kryetari dhe nga gjithë stafit që merren me atë punë që ta kem një performancë vitin tjetër të pa kten te fillon një ngritjesesa ju përket procedurave të veprimit të gjitha kan ndodh por kemi një neglizhenc por kështu që uroj që vitin tjetër komuna jonë të rënditet sa ma lartë në performancën që bëhet kështu që ju përgëzoj për punën por në aspektin administrativ keni dështuar

Hajdar Sutaj

Yll qka janë ndalur televizionet a i ndaleti a e ka kërku fjalën Vatan Istrefi pastaj Syl Balaj Albes me radhë është Moni është Orgesi pastaj jeti

Vatan Istrefaj

A mundem me vazhdu kryesues? Faleminderit për fjalën së pari është për keqardhje të flasim për këtë rezultat të raportit përfundimtar të performancës për vitin 2023 po më vjen mirë se edhe kryetari edhe shefja kabineti po i pranojnë gabimet dhe shpresojmë që këto të përmirësohen sa më shpejt arsyeja pse është nevojë urgjente që të përmirësohen këto gabime dhe ky raportim me kohë të jetë sa ma në rregull është.. se kështu nëse vazhdoni atëherë ne si komun e Deqanit do të jemi hendikep i granteve që merren ose përfitohen nga performanca komunale, kështu që ne si komun e Deqanit kemi një buxhet për vitin e ardhshëm 14.500.000 euro nëse ne do të përfitonim ndonjë grant nga kjo do të ishte një infuzion i mirë për komunën tonë që e kam një vretje këtu për ta shpjeguar bashkarisht me ju është siguria në institucionet e arsimit para fillor është vlerësuar me zero nuk e di a e keke pra universitar nuk e di a e keke edhe ti ndoshta nuk të kam dëgjuar a është mungesa e raportit me kohë apo diqka tjetër faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Vatan, Manjolla a dëshiron me u përgjigjë në rregull qysh ta vlerësoshja dëshiron me u përgjigjtani apo në fund nëse dëshiron me marr fjalën .. për shkak të transkriptit sepse nuk regjistrohesh a dëshiron me fol tani apo në fund në rregull atëhere Syl, Albesa pastaj Moni, Sylë Balaj e ka fjalën

Sylë Balaj

Atëher përsëritet për të gjithë pasi që shumica edhe i thanë të gjitha unë e kam vetëm 1 pyetje për kryetarin, pse kryetar nuk po merrni hapa adekuat për ta ngritur performancën e e komunës së Deqanit, pasi gjithmonë po i prin listes nga fundi faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Albesa.

Albesa Caca

Atëher raporti i performancës komunale, mbështetet në 27 tregues të sistemit të menaxhimit të performancës komunale du me ja u rekujtu të gjithëve këtu të pranishëm dhe atyne qe po na ndjekin se premtimi i 1-rë i kryetarit ne vitin 2021 ka qenë qe ka me dal i 1-ri te performanca komunale dhe ka vite qe ky vazhdon të jetë te renditja e fundit ose para fundit, te ato komunat e mitrovicës ashtu janë raportet. Është fakt edhe është shumë e vërtetë që ka punë qe janë të faktume në internet që janë bërë por nuk janë raportuar në menyren që është kërkuar nga sistemi i menaxhimit të performances por është edhe fakt dhe realitet që këta tregus tregojn realitetin në hapsirat ku ne jetojm po nisem nga fakti te hapsira për aktivitetet e sportit, aktivitetet e kulturës, rinisë dhe sportit me buxhet komunal zero është tepër e vërtetë edhe niveli i adresimit të rekomandimeve të zyrës kombëtare të auditorit, që është me 6,6, sepse vazhdimisht auditori i jashtëm bën

rekomandime që të përmirësohet komuna e Deqanit po asnjëherë nuk ndërmerren masa, pastaj sipërfaqja e hapësirave të gjelbra në metër katror për kokë banori edhe kjo është fakt sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht, hapësira publike të pajisura si ndriçimi publik rrugë lokale të mirëmbajtura gjatë sezonit të verës dhe të dimrit pamë edhe borën e 1-rë që ra edhe na zuni të papërgatitur, po besoj që pajtohesh kryetar, edhe pse me mijëra qindra euro paguhet kontrata brenda vitit për tu mirëmbajtur rrugët dhe qytetarët e Deqanit hasin vështirësi, kur jam duke folur ti veq degjon kryesues pastaj e merr fjalën, e plani komunal për barazi gjinore këtë e diskutova edhe në fillim që nuk ka ardhur asnjë, barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokal pastaj kemi.. është fakt edhe regjistrimi i pronësisë në emër të 2 gjinive, niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë, 32 dotëthotë nuk e ka arrit as mesataren në bazë të këtij vlerësimi që e ka bërë mos të harrojmë që komuna e Deqanit 2022 një vitë përpara në performancë ka dalë e 26-ta më në fundë dhe ato ato..

Hajdar Sutaj

Jo i nderum nuk ja vazhdova fjalën po 3 minuta i kishe ku në cilën rregullorejo që don me vazhdu edhe pak po a je e interesuese nëse don pa problem, është lajmruar për fjalë Moni, Mon Selmanaj dhe në fund Manjolla mundësisht përgjigjesh edhe në diskutimet e kolegës Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Kryesues mendoj se këtu ke bo një lëshim sepse ne si kuvend nuk e kemi ditë se kush qëndron prapa këtij raporti ose kush është përgjegjës i dhene edhe fjalën si grupe. edhe une deshta një pyetje përfaqësues se këtij raporti a i mbajte mend qato dilema se nuk mora asnjë prej qështjeve që i ngrita faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Manjolla a ke mundsi nëse ke diqka me shtu urdhëro.

Manjolla Shala

Në të gjitha tregues që ne jena vlerësuan me zero, unë në të gjitha dhashë sqarime apo shpjegime nëse doni unë po filloj edhe njëherë nga fillimi unë të njëjtat ato që i përmendëm unë dhash sqarime për ato.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë a ka dikush tjetër diqka, po Miftar Ahmetxhekaj e ka kërkuar fjalën.

Miftar Ahmetxhekaj

Pa dasht mu lëshuar shumë për hirëtimen po edhe për hirë të kolegëve realisht nuk kam pritur njdonjë rezultat tjetër në raport me këtë dokument u përmend grandet, dëgjomëni momentin që raporti i auditimit ta ka dhënë një kualifikim nuk ki çka pret rezultat tjetër qysh në start ti je i përjashtuar nga grandit qe keni pritur që të ketë një veprim më të mirë që ju në fushat e caktuara, unë po dua të pajtohem që ndoshta në rastet e caktume ndoshta kanë qenë gabime teknike në rastet se nuk keni mundur ti raportoni me kohë mund të ketë veprim të mirë, por ti si ke raportuar si veprim të mirë megjithatë duhet të bëni përpjekje që raportin kryetar të auditimit të ndryshoni performancën të ndryshoni.. të i aplikoni rekomandimet, ti zbatoni rekomandimet me qëllim që ju ta merrni vizën për vitet e ardhshme që të merrni grand përndryshe qysh në start ti je disfalifikuar faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar, po kryetari, Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

Bashkim Ramosaj

Kur jemi te diskutimet e kolegëve të asambles është qdo shqetësim i ngritur është shqetësim me vend për shkak se nëse i marrim 2 objektiva dhe i masim mes vete që ne na u ka thënë edhe nga kolegët tjerë është një () teper i madhë ku në asnjë komunë nuk ka aktivitete më shumë se komuna e Deqanit mirpo në perofrmanc nuk e mbërrim nivelin e dëshiruar dhe këtë e kemi shpjeguar me shumicën e kolegëve që jemi kryetar komunash dhe normal qe duhet me pasë një kujdes më të shtuar kujdes më serioz jemi munduar të bëjmë të pamundurën po që kurr skemi mundur mi ra në fije kësaj saktësisë kohore të raportimit edhe llojit të raportimit ku gjithmon ka munguar nga një dokument megjithëse ndoshta nuk ke dokument të bashkangjitur me të qitë nga loja e kemi arrit në një kohë ndoshta me pas vendin e dytë e kemi pas vendin e dytë kemi arritur me pasë vendin e 8 tash jemi dikund ne mesë të tabelës diku në vendin e 16 ka fusha në të cilat jemi edhe në të 29-tën ka fusha që jemi edhe më lart ka fusha që jemi në të dytin ka fusha që jemi në të parin mirpo

kur të mbledhen krejt këto kategori rëndisemi nga mesi i tabelës dhe është shumë e nevojshme shumë e domosdoshme tu e ditë ciklin buxhetor secili në komunë e Deqanit dhe cilin bugjet e kemi kish me qenë shumë e rrugës për me përfitu këtë grand i cili na e kish kry ndonjë punë të mir për interesin publik qytetarë dhe të komunës së Deqanit unë kordinatores dhe komplet ekipit po i sygjeroj dhe po i inkurajoj që me qenë ma të sakt në këtë temë po ashtu të gjith njerëzit që e kanë për detyrë me bashkupunu me ju me qenë më të kujdesshëm në këtë bashkëpunim, është e pa pranushmë në një afat kohor nuk është dërguar një ftesë publike me u qitë në tabelen e komunës në faqen e komunës edhe ti me u konsideru me zero pikë është e pa falshme faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kryetar, a nuk është duke punuar a Albesa a ke diqka me shtu në rregull fjalën e ka Albesa Cacaj.

Albesa Cacaj

Kur flas gjithmon e kamë një bazë nuk flas si thon populli ne hava kur thash e kam diskutimin kohë zgjatjen 5 minuta, the jo 3 minuta domethënë në rregullore që e kemi miratuar pikërisht ky kuvend thuhet çdo anëtar i kuvendit ka të drejtë të diskutojë për 1 pikë të rendit të ditës, vetëm 1 herë në kohë zgjatje prej 5 minutave a e kem të qart.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë raporti i performancës nuk votohet vetëm diskutohet edhe kështu e kalojmë si pike dhe diskutojmë në pikën e 6 që është shqyrtimi i draft statusit të Qkmf-s fillimisht ja kaloj fjalën drejtoreshës për shëndetësi, Agnesa Vokshi, dhe po ashtu i lusim mediumin kosovapress që të bëjnë përpjekje ta bëjnë transmetimin live se nuk e di për çka kanë pengesa.

Agnesa Vokshi

Faleminderit kryesues përshëndetje për gjithë, fillimisht drejtorja për shëndetësi dhe mirëqenie sociale ka pranuar 1 shkresë nga ministria e shëndetësisë, ku thotë që ky statut i qendrës kryesore të mjekësisë familjare duhet të jetë unifikues për të gjitha qendrat kryesore të mjekësisë familjare.

Andaj sot për herë të 1-rë është shqyrtimi i këtij drafti, duke e pas parasysh që është në formë unike për të gjitha qendrat kryesore të mjekësisë familjare andaj nga ju pres në rast se keni me shtu diqka konform legjislacionit në fuqi ndonjë sugjerim ose rekomandim e mirëpres secilën fjalë të juajën faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, drejtoreshë nga grupi i Aak-s a ka dikush diqka me thanë Florim Mataj.

Florim Mataj...

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë nga Ldk-ja Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesues pikrisht po filloj nga e para drejtore unë kam pritur që aj dokument i arsyeshmëris të jetë pjes e materialit meqenëse se statusi i vjetër i qkmf-s parasheh format edhe të amandetimit edhe të ndryshimit të statutit një prej tyre është kërkesa e juaj të cilën ne nuk e kemi pjesë të materialit është dasht meqenëse është draft dhe ka kohë ku për të shqyrtuar unë te pjesa e 1-rë që është rregull është norm që secili dokument, referencat ligjore qysh në hyrjet të ketë mbështetur në ligjin për vetëqeverisje lokale, mbështetur në ligjin për shëndetësi në statutin e komunës, në udhëzimin administrativ, i cili rregullon kujdesin parësor shëndetësor, ish dashtë po e vlerësoj që në përpunim e sipër ju do ta vendosni këtë paragrafi i cili është referenca ligjore që ty ta rregullon rrugën se si me trajtu këtë dokument një dilemë që du me theksu është te neni 14 që për mua është në shpërputhje me udhëzimin administrativ kur flitni për emërimin e drejtorit unë di që gjithçka që është me rekrutim nuk është emërim por është zgjedhje apo përzgjedhje këtu duhet të ndërhyri neni 14 nëse nuk gaboju kur flitet për emërimin e drejtorit, duhet të thuhet ose të përshkruhet meqenëse ai nuk emërohet po zgjidhet nëse ka konkurs, është zgjedhje ose përzgjedhje në ndërkohë, nëse unë eventualisht të shohë dhe besoj që ka me pa të arsyeshme unë do ta japi kontributin për ta pasuruar edhe më shumë këtë dokument faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, atëherë mundësisht nga Vetvendosja

Vetvendosje

Faleminderit kryesues para se me marrë fjalën për pikën veq po du me njoftu që është hera e 2-të që po ndërprehet transmetimin i seances dhe pak më herët pika e raportit përfundimtar të performancës para 25 minutash u ndërpre domethanë ajo pjesë pak apo hiq u transmetu drejtoresh pyetja ime është që përditësimi i fundit i statutit ka qenë në vitin 2017 në vitin 2020 ka një udhëzim administrativ të ri nga ministria e shëndetësisë në lidhje me shëndetin dhe kujdesin primar shëndetësor edhe pse prej asaj kohe nuk e keni përditësuar statutin po kërkon në këtë moment përndryshe edhe atë urdhëres që është lëshuar nga ministria në këtë kohë kish me qen mir me na u bashkangjit me pa edhe na qfarë urdhërese është me qfar arsytimi.

Hajdar Sutaj

Faleminderit, Mon Selmanaj a ke diqka me thanë

Mon Selmanaj

Veq përkrahje.

Hajdar Sutaj

Në rregull faleminderit shumë Mon, drejtoreshë fjala për drejtoreshen Agnesa Vokshi

Agnesa Vokshi

Faleminderit kryesues po filloj me, veq një sqarim për Miftarin meqenëse më dha disa sugjerime, padiskutim i kom parasysh meqenëse është vetëm një draft dhe është hera e 1-rë që po vjen në asamblenë me u shqyrtu këto rregullohen ka me pas edhe dëgjime publike dhe gjithashtu që faleminderit shumë. po kaloj te kolega tjetër unë edhe atë ditë kam potencuar në Kpf unë jam emëruar drejtoreshë në vitin 2022 dhe mundem të flas vetëm nga periudha kur unë jam emëruar drejtoreshë nuk e di që ka ndodhur para asaj kohe e me qenë se shkresa nga ministria e shëndetësisë na ka ardh këtë vit në qast jam interesuar dhe e kemi marrë iniciativën që me qenë shumë rregull me ata që na ka dërguar ministria e shëndetësisë, duke e falënderuar çdoherë kryetarin për përkrahjen që na jep në sektorin e shëndetësisë faleminderit kryesues.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Orges Tafilaj është lajmruar për fjalë.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues meqenëse na ka ardhur si draft fillimisht pikën 1.1.6.1 besoj se duhet të përmirësohet termi dhe duhet të jetë shërbimet konsultative te pika 4 si sistem të informimit shëndetësor në Qkmf realisht pata me e ngrit si shqetësim, sepse më ka ndodhur personalisht që shpesh analizat laboratorike pas përfundimit të orarit lihen në ulëse dhe besoj që kjo lidhet shumë me ruajtjen e () te cekur këtu. Është mirë që të informohen personat përgjegjës që analizat mos të lihen aty, për shkak se pacientët të caktuar mund të ken informacione, mund të vijë deri te zbardhja e ndonjë informacioni që ndoshta edhe vetë pacienti nuk dëshiron me e zbulu edhe te pika tjetër te procedurat e emërimit të drejtorit, drejtoreshë pika 2.1 thotë, duhet të jetë mjek specialist nga mjekësia familjare të ketë 5 vite përvojë pune në sistemin shëndetësor publik prej tyre, 3 vite përvojë pune në pozita menaxheriale kjo pjesa tjetër ke tek pika 2.3 për hirë të informimit të publikut, doktori Hasan a i ka plotësuar këto kritere apo jo faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges drejtoresha Agnesa Vokshi e ka fjalën.

Agnesa Vokshi

Në rregull faleminderit kolegë realisht na jemi tu fol për draft statutin e qkmf-së që ka me u miratua në të ardhmen sa i përket pyetjes që e bëre nuk po besoj që i përket kësaj pike dhe nuk konsiston me të kështu që nuk mundem me dhënë ndonjë përgjigje në rast se ka dikush sa i përket vetëm statutin e Qkmf-së mundem me u përgjigj jo rasisht është pika tek të ndryshmet ku mundeni me bë pyetje sa i përket pjesës tjetër faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë në lidhje me statutin e Qkmf-së apo se në lidhje me këtë draft statutin, lidhur me këtë pikë mundeni me diskutu edhe të të ndryshmet sa i përket procedurave të zgjedhjes të ushtrisë të detyrës po Hyri Dobrunaj e ka fjalën.

Hyri Dobrunaj

Kemi diskutuar edhe në KpF meqenëse kjo është një draft ka me dal me ju nënshtrë diskutimit publik ka me psu ndryshime sigurisht të neni 5 pika 1 aty të emërimi duhet me shënu emrin () shtëpia jonë e shëndetit e mban atë emër duhet me qenë, e kemi cek se neni 30 është, duhet me e shtu përgjegjësit për zbatimin e kësaj e këtij statuti, ose draft statutin, statut më vonë sa i përket edhe pyetjes së Orgesit ndoshta nuk lidhet me këtë, mirpo a bjen në ndesh me këtë pyetje lidhet pikërisht me statutin për këtë nuk e dinë drejtoreshë, mirëpo herën e kalimeve njëjtë situatë ka qenë një dentist e kemi pasur drejtor ka qenë ndesh me statutin a bjen ndesh lidhet me këtë a bjen ndesh me dokumentin...

Hajdar Sutaj

Po drejtoreshë si ta përfundon ki drejtë me u përgjigjë

Hyri Dobrunaj

duhet patjetër selidhet a bie ndesh me këtë dokument qajo zgjidhje që e keni bërë

Agnesa Vokshi

Për zgjedhjen që e kemi bërë, pavarësisht se nuk po du me e zgjat shumë si temë e kemi bërë duke u bazu konform statutin aktual që e kemi në fuqi dhe në rast se e keni lexu statutin aktual që e kemi në fuqi për qendrën kryesore të mjekësisë familjare e përcakton saktë çka na mundemi me vepru a është ligjshëm a i kundërligjshëm ministria na ka aprovu e kemi të plotfuqishëm edhe në veprimet baza të atë statuti kaq nuk kam tjetër me shtu.

Hajdar Sutaj

Më falni shiqoni është e drejtë edhe me u bërë pyetje edhe me u përgjigjë vetëm ta ruajm qetësin se jemi edhe në fund vitit a të ka mbetur diçka pa tu përgjigjur Hyrije më falni a keni mundesi me ndez mikrofonin të Hyrija se regjistrohët në transkript

Hyri Dobrunaj

Kjo ish pyetje ndër tjerat para kësaj pata edhe 2 sygjerimet tjera maspari drejtoresha është dashur që të thotë po kemi me bërë është diçka që duhet me bërë edhe këta me u përgjigjë si pyetje mos me marrë personale po e shoh ketu që është njëfar tendence dikush me u tregu më i mençur se tjetri mi kallcu diku sht diku t'kush po lexon më shumë, kush është akademik e kush është puntor edhe këto janë seriozisht edukat nuk mundemi me ja mësuar kërkujt por duhet me pasë elementare

Hajdar Sutaj

Janë këto momente Hyrije edhe në nganjëher edhe unë edhe ti

Hyri Dobrunaj

Drejtoresh fillimisht falendero për kontributin që po mundohemi me dhënë në pastaj mu përgjigjë në pyetje nëse nuk është në kundërshtim është në rregull ti ki me zbatu se ti je këtu ti ke me dhënë edhe përgjigjësi nëse nuk është ashtu kështu që nuk ke nevoj me marr personale është pyetje.

Hajdar Sutaj

Draft statuti sot është në lexim të parë ka me dal në dëgjim publik ka me ju nënshtrë procedurave ka me na ardh prap për me bërë shqyrtimin përfundimtar deri tek votimi, dikush tjetër Vatoni Istrefaj.

Vatani Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues unë i kam pyetjet direkt për statutin, atëherë nëse drejtoresha nuk e ka vullnetin mu përgjigjë është problemi im më i vogli le ta vlersojnë këta si të dojnë duke bashkëngjitur rekomandimeve që dhanë kolegët para prak unë desha ti shtoj disa vërejtje që kam tek ky statut dhe tek zbatimi i tij pasi ta marr formën e prerë këtu në asamble komunale, pasi që personalisht do të votoj për të shkuar në instanca tjera për të dalenë dëgjim publik etj. Drejtoresh ju së bashku si drejtori e shëndetësisë së bashku me kryetarin që na ke thënë edhe në mbledhjen e

kaluar e ke emëruar 1 ushtrues detyre të qkmf-së në Deqan, një drejtor të ri, që për mendimin tim është në kundërshtim me ligjin, pasi që në qendren kryesore të mjekësisë familjare në Deqan janë 7 specialist të mjekësisë familjare kthehemi pra aty tek neni 14 tek procedurat emërimit e drejtorit tek pika 2.1 thotë të jetë mjek specialist nga mjekësia familjare dhe ju pra keni emëruar 1 ushtrues detyre pra shkelja e 1-rë është se ai nuk është specialist i mjekësisë familjare dhe një pediater shkelja e 2-të është se ne e dimë se Qkmf-ja në Deqan ka një staf numër të punëtorëve të themi ashtu mbi 100 persona janë diku 120 afër dhe i takon zv.drejtorit dhe për momentin është zv.drejtori në qendren kryesore të mjekësisë familjare atëherë kur është zv.drejtori çfarë ka me lyp aty ushtrues detyre, pasi që nëse ishte kanë në gjendje që drejtori më parë ka patur 1 fatkeqësi dhe ka liru pozitën po i drejtorit që ka qenë më parë e ka liru pozitën në mënyr natyrale ka dal në pension dhe keni pasur kohë sipas një akti nënligjor 2 muaj që drejtori parapraktë del në pension për ti hapur procedurat e konkursit edhe për të aplikuar ata mjekë të cilët i plotsojnë kriteret pra që kanë përparsi ata që janë mjekë të mjekësisë familjare e ju qfar keni bërë keni shkuar i keni anashkualuar 7 mjekë të mjekësisë familjare dhe keni shkuar tek i 8-ti i cili është pediater me profesion pra këtu janë dy shkelje drejtoresh tek tema jam kryesus

Hajdar Sutaj

Jeni jashta teme , jo jo per statut folni tek te ndryshmet

Vatan Istrefaj

për mendim timin i keni bërë 2 shkelje ligjore, pra ku të merr emrimin e plotë ky status një është që nuk keni hapur konkurs që 9 muaj që është dashur që të hapet 2 muaj përpara se drejtori të dal në pension shkelja e dytë është që keni bërë një ushtrues detyre të një digasteri të pediatri po ashtu njëjt keni vepru edhe në vitin 2020 ku e keni emëruar drejtorin paraprakt me një vendim arsyeshmërie që ka qenë me performanc të mirë

Hajdar Sutaj

Vatan është obligim i imi me kërkuar nga anëtarët me fol për temën ju keni te drejt me ata që po e folni me diskutu tek të ndryshmet

Vatan Istrefaj

mundem edhe tek të ndryshmet që lidhet me temën saktësisht ka mundësi mos me më ndërpre a jeni duke dashur me mshef diqka më të madhe

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë dikush tjetër po more tamon puna për qata është tek të ndryshmet me i diskutu te gjitha në rregull qashtu qysh te votojm qashtu mu bë kush ishte për fjalë, kryetari i komunës Bashkim Ramosaj e ka kërkuar fjalën.

Bashkim Ramosaj

Nuk e di ndoshta është dashur me u jep sygjerimet edhe vrejttet edhe me u kalu sepse duhet me u merr shumë seriozisht me të unë nuk besoj që kemi nevojë me ndryshu shumë këtë status ose me plotsu për shkak se është uniforme kanë të gjitha qendrat kryesore të mjekësisë familjare në Republikën e Kosovës, po rikthehem pak mbasë për shkak se ka njerëz në këtë sallë ku kemi qenë pjes e komisionit për hartimin e statutit të qendrës kryesore të mjekësisë familjare e cila ka rrjedh edhe nga ligji i shëndetësis mirpo që ka rrjedh edhe nga udhëzimi administrativ mbi kriteret e themelimit të qendrave kryesore të mjekësisë familjare, për ne si organizimi tillë është është i ri së paku ka qenë i ri në atë kohë për shkak se ne nuk ishim mësuar me shku në qendër kryesore të mjekësisë familjare mos në pas derisa profesionet e mjekëve cilët tradicionalisht Deqanit është mësuar me ta dhe mjekësia familjare nuk është që u japë përparësi këtyre i konsideron mjekësin sekondare ose në qendrat rajonale që janë spitalore dhe nuk i kemi këto shërbime si qytetet e vogla se si komuna që vlerësohen në bazë të kriterëve mbi themelimin e këtyre qendrave edhe në atë kohë ka qenë norm e diskutushme a duhet me qen vetëm specialisht i mjekësisë familjare apo duhet qen mjekë a mjafton me qen mjekë dhe me marrë () të isha pyetur unë ose me u pytë une, unë ju kisha japë mundësin gjithësecilit që ka diplom shkollorë një që është i aftë një që është menagjer sepse nuk është e thënë me qen vetëm në atë profesion e me menagju situatën me sektorin tënd ka dikush që është i lindur për menagjer ka një diplom universitare dhe pse me ja mohu drejtën e ti që me menagju me këtë por janë thjesht aspekte ligjore dhe po ashtu procedura udhëzimet mbi kriteret e themelimit ajo që e kemi bërë kohën e fundit me emërimin e doktorit Hasan Gjykokaj një doktor i ndershëm i këtij shteti njeri tepër i zoti i këti shteti jemi me fat që e kemi

një mjekë të tillë e kemi bërë në dakordim të plotë me krejt pretendent të cilët kanë pas pretendime për me marrë menaxhimin ose me pasë postin e drejtorit të qendrës kryesore të mjekësis familjare për shkak se kanë munguar dhe mungon 1 pjesë e dokumenteve që janë bazik në këtë sektor edhe është një dakordim i plotë e hapi i parë është me hy në fuqi ky statut gjatë 6 mujorshittë parë ne kemi me u marrë me komplet infrastrukturën ligjore normative të qendrës kryesore të mjekësis familjare kur perfundon e gjitha kjo ne kemi me pasë një konkurs sipas nenit 14 ku emërohet drejtori nuk do të thotë se emërimi i drejtorit është akti i nënshkrimit mirpo që duhet me ju nënshtruar një procedure për përzgjedhjen duhet me kuptu kështu si term pajtoj që () ose hyrja isht dasht me qenë e bazuar edhe në ligjë edhe në udhëzimet administrative me normat që janë më të larta me riarki dhe po ashtu edhe emërtimi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare, sepse është 1 vendim i kësaj asambleje që është emërtuar me emrin Adem () besoj që kemi me realizu kësioj dhe kështu kemi realizuar nuk ka ndonjë tendencë, nuk ka ndonjë qëllim tjetër përtej përkushtimit që kjo qendër kryesore e mjekësis familjare me pasë tretmanin dhe po ashtu mi pasë shërbimet në nivel në raport me qytetarët faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kryetar kështu nëse keni mundësi po ju lutem meqenëse me rregullore thuhet 1 herë me marrë fjalën për 1 pikë të rendit të ditës, e përqëndrohuni me i than të gjitha po japë fjalën por përqëndrohuni me i thanë qato që i keni pastaj nëse ju përmendet emri sigurisht e shfrytëzoni të drejtën e replikës, Hyrije po e kaloj fjalën te ju fillimisht edhe munda sht thuni ato që keni për ti diskutuar qofse mundeni me i përmbledh.

Hyri Dobrunaj

Shumë shkurt kryesues fjalën e kryetarit e dëgjova me vëmendje ndonjëher po duket sikur po tentojm me u marrë me emra të përvetqëm është shumë e vërtet se as një moment, unë besoj, unë jam e sigurt për vete, mirëpo edhe kolegët e mi asnjëri nuk e ka ndërmend me u marrë me emrin e doktor Hasanit pediatër, shumë i mir i komunës së Deqanit e nuk është i vetmi, komuna e Deqanit të gjithë mjekët që i ka aty në shërbim i ka të mrekullushum dhe jemi shumë krenar me ta, me secilin veq e veq mirpo ne po merremi tash me statutin pikërisht edhe me procedurat nëqoftëse një nen i ati statuti e ndalon me u zgjedhë në atë mënyr ato kriteret që i kërkon atëher na duhet me diskutu këtë temë por jo me emra të përvetqëm asnjëher me u merr edhe unë po ju sugjeroj meqenëse komuna është themelus ekuptoj që i ka dërguar ministria aktet po a mundemi me bo ni shkres me ndryshu atë nen që na mos me qenë gjithmon në kundërshtim me rregulloret edhe me dokumentet që i nxjerrim vetë si kuvend komunal kjo është qëllimi nuk është qëllimi që me thanë që një doktor është me i mir se tjetri ose një më i keq se tjetri faleminderit

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Hyrije kryetari i komunës e ka fjalën.

Bashkim Ramosaj

Edhe unë nuk e thashë me ndonjë tendencë për me mbrojt ndokënd ose me lartësu ndokënd tjetër kisha pas dëshir me u kuptu drejt sepse ka qenë bashk me mu në komisionin kur e kemi hartuar statutin e fundita është kështu, po dhe ne kemi pasë një dilemë, dilema ka qenë a me tejkalu kriteret për themelimin nenin që bëhej fjalë, në bazë të udhëzimeve mbi kriteret e ligjit mbi organizimin e shëndetësisë në republikën e Kosovës. Në atë kohë ka qenë një tronditje e madhe për të gjithë ne që kemi qenë në komision për shkak sepse ne na kanë dalë kardiologët në pension dhe nuk kam drejt me i zëvendësu ne na kan dalë komplet raporti i gjenezologjis nga funksioni e nuk kemi drejt me i zëvendësu edhe janë profesionet e ndryshme mjekësore që kanë shërby në qendrën spitalore osenë qendrën kryesore të mjekësis familjare në Deqan mirpo që tash nuk e kanë atë mundësi dhe nuk e kanë atë të drejt për shkak se ligji e përkufizon më ndryshe dhe ne e kemi bërë një lëshim në atë kohë kur e kemi arsyetuar para ministrisë së shëndetësis që ka qenë subjekti i thirrur nga ministria e administrimit të pushtetit lokal që me arsytu a me marrë legalizimin këtë dokument a mos me marrë e ne e kemi bërë një arsyetim për shkak se jemi në këtë far trendi dhe ata na kan mirkuptuar dhe kanë thënë po keni të drejt po e lejojmë, tash ka ardhur një shkresë tjetër është një udhëzim është një rekomandim nga ministria e shëndetësis që me qenë statuti unifrom për krejt qendrat kryesore të mjekësis familjare në republikën e Kosovës unë uroj që me u tejkalu ky statut me ofrimin e shërbimeve për shkak se kemi, shpesh e kemi diskutu e ju kujtohet fort mirë ata që janë marrur nga afër me këtë a kanë të drejt me dhënë infuzion në qendren kryesore të mjekësis familjare a skan të drejt a kanë të drejtë me i kry disa shërbime që faktikisht i kryejn unë jam tepër i lumtur, jam mirënjohës për ata që i kryejn mirëpo kjo është kjo është njëfarë tendence, pak ma moderne që është njëfar standardi që kemi me ju nënshtru dikur se kemi me kuptu që është e drejtë kështu e thot ligji edhe në rregull jemi, por mos të keqkuptohemi që dikush pat me fol për emra të përvetqëm e me

ofendu ndokënd ose me mbrojt ndokënd.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë ka dikush që nuk ka diskutuar e që don me marrë fjalën atëherë a i japim mundësi këtij drafti që me përcjell për dëgjim publik edhe jepni edhe ju rekomandimet e juaja edhe gjatë dëgjimit publik po edhe në drejtorin për shëndetësi edhe pastaj i japim edhe komentet tona kur vjen në përfundim, Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatohet që në mënyrë unanime kuvendit komunal e ka miratuar draftin e QKMF-së duke i dhënë mundësi për me ju nënshtruar procedurave tjera deri të diskutimi përfundimtar dhe jemi të pika e 8 që është shqyrtimi i kërkesës së komunitetit të fshatit Pobergjë për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit për nevojat të komunitetit të fshatit Pobergjë dhe fillimisht këtë pikë e mbron kryetari i komunës, zoti Bashkim Ramosaj, ju e keni edhe materialin e keni edhe kërkesën e keni dhe specifikacionin e keni edhe dokumentin prej kadastrës që i keni për ku është hapësira nevojat që ju nevojitet atyre nëse ka dikush diçka nga ju me thënë në lidhje me këtë pikë e hapi diskutimin, nga grupi i AAK-së është lajmëruar Ariani që thotë e mbështesim si pikë dhe po e kalojmë grupi i LDK-së, edhe grupi i LDK-së e mbështet këtë pikë grupi i vetëvendosjes e përkrah Mon Selmanaj Kush është për?

Po më falë po that ju në rregull jemi po sa e qita në votim në rregull bone ja lëshoni fjalën Miftarit

Miftar Ahmetxhekaj

Ajo ka për tu ndërtuar në afërsi të një monumenti apo të shtatorja un vetëm një pyetje po bëjë konkrete, ajo shtatore a është në kuader të agjencisë memoriale të Kosovës nëse jo nuk paraqet problem e atëherë e ka mbështetjen gjithësesi

Hajdar Sutaj

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatohet se e kemi miratuar kërkesën e fshatit Poberxhë jemi të pika e 9-të është raporti i komisionit të bursave kush e merr fjalën nga komisioni, Manjolla.. Arjan Dobraj e ka fjalën.

Arjan Dobraj

Përsëritet kryesisht, rrime dhe pak faleminderit për fjalën, faktikisht na Manjollën e kemi kryesuese, por në komision se kemi problem cilido që raporton ne jemi njëjtë aty nuk është domethënë diçka ajo punë fort e di që dikush tha kemi pas me lënë për janar po është fakt që kemi pasur me lënë për janar por rezultate preliminare kanë dalë të aplikimet që kemi pas kanë qenë gjithsej 221 aplikime, bursa kanë fituar studentët që kanë qenë ekselent, kanë fituar 170 studentë kanë fituar domethënë janë përfitues të bursave. Puna e komisionit ka kalu qysh është më së miri kemi pas pak debate në fillim shkaku i rregullores për cilën temë e kemi mendu bashkë me kryesuesen Manjollën edhe kolegët nga komisioni që me e diskutu në muajt në vijim të vitit 2025, që me pas pak intervenime në të sepse kemi hasë disa keqkuptime, kështu që besoj që është ajo punë që rregullohet, unë nuk kam diçka tjetër me shtu, vetëm me falenderu kryetarin Ramosaj për mundësinë që po jep vit pas viti që me u shpërblyata që përnime e kanë vendos me qëndru këtu dhe me jep kontributin e tyre në Kosovën tonë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit po patjetër tashti në këtë rast Albësa pastaj Hyrija, Orgesi, këta i ka ndarë bursat në bazë qysh e parashihet rregullorja nëse këta si komision kanë mbërri gjatë punës me vërejtje që ka ndonjë gjë në rregullores që nuk është në rregull le ta propozojnë ndryshime rregulloren për vitet e ardhshme bëjmë plotsim ndryshime se këta kanë mundur me vërejtje më mirë gjatë punës që a është rregulloja a është si duhet a nuk është nëse keni ndonjë ndryshim ne jemi me ju ndihmu me shumë njerëzve urdhëro Albësa.

Albësa Cacaj

Pajtona plotësisht me parafolën që tha rregullorja nuk është në harmoni, as në me nën kështu që ne e kemi pas për qëllim që të jemi në kohë për të ndarë bursat e shprej shumë që të bëhet edhe ekzekutimi i mjeteve ndaj studentëve e të mos jetë si vitin e kaluar, ku komisioni ka kry punën përshembull në muajin tetor nën të, ekzekutimi i mjeteve nuk ka dalur deri në qershor kështu që besoj, si the se nuk të dëgjo po shprej shumë

që të bëhet ekzekutimi me kohë edhe falenderuese për të gjithë anëtarët që e kemi kry punën së bashku kaq faleminderit.

Hajdar Sutaj

Albesa faleminderit Hyrija pastaj, jo jo nuk e patë në lidhje me këtë çështje kryetari pat vërejtje se dikush prej anëtarëve të komisionit, ata që nuk e kanë përfituar kanë thënë ne e kemi kryer punën tonë por kryetari, e dashti të thotë që unë nuk jam fajtor kush ka përfituar kush nuk ka përfituar është qështje e juaja, Hyrije Dobrunaj e ka fjalë më fal Hyrija pastaj kur të përsëritet rendi, a tu ka përmend emri, jo jo nuk ke, Hyrija.

Hyri Dobrunaj

Më vjen shumë mirë për studentët të cilët kanë përfituar pyetja ime e 1-rë është për Arianin, pyetja ime e parë është për Arianin më intereson me dita kanë përfituar më shumë vajza apo dejm, kur po e shtroj kështu pyetjen e kam një qëllim sepse kur flasim për strategjinë kundër dhunës në familje, kur flasim për avancimi në të drejtave të grave ose për barazinë gjinore, atëher lidhemi gjithmonë këtu për mua në interes është me fitu ma shumë vajza sesa djem uroj e shpresoj që e kanë plotësuar kriteret më shumë mirëpo unë kisha dashur ndoshta edhe ndonjë kriter shtesë për vajzat edhe me u plotësu në rregullore nuk kish me qen ide e keqe edhe pse është njëfar diskriminimi por është diskriminim pozitiv dhe e kam një pyetje për kryetarin, kryetar kur mundesh me na premtu premtona për për këtë vit të jeter të gjitha të këqijat po ti falim nëse na premtun, po shiko ne opozita e mendojmë, nese na premtun që vitin e ardhshëm ke me fillu me bo një rregullore që studentët me marrë burs të përmujshme jo njëher në vit edhe Aak edhe kushdo që e bënë për studentat është e mrrekullushme për situaten ku jemi.

Hajdar Sutaj

Nvaret tash është parafushatja kemi fillu edhe paki largojm pagat tona dhe ju jepim atyre

Hyri Dobrunaj

Kryesus nuk jamaq zemer ngusht sa ju

Hajdar Sutaj

Jo e di e ke zemrën e gjërë të përgëzoj, Orgesi pastaj Moni, kryetari i komunës Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

Bashkim Ramosaj

Se jam edhe keq me kohën ndoshta mbledhja e fundite ngarkume kaq fort nuk është fort tradicionale me u mbajt kështu një diskutim përtej bursave një diskutim shtesë që e kemi bërë është duke qarkulluar tashë e një vit e që një pjesë dërmuese e studentëve kanë kërkuar që me ju hjek shpenzimet e udhëtimi nga komuna e kemi shikuar tepër seriozisht këtë pjesë, mirëpo që nuk kemi pasur atë komoditet për me ndodhë tash kohëve të fundit, që diku nga shtatori ka ardhur një kërkes e njëjtë, mirëpo që ka ardhur në mënyr pak më të organizuar kemi me vlersu me ju dhënë për qdo muaj burs përbesë nuk e kemi mundësin.

Hajdar Sutaj

Me shiku si mundësi Orges urdhëro Arian Dobraj e ka fjalën, kryetar të urojm suksese në vitin që po vjen faleminderit shumë që ishe pjesë e seances kalofshi mir e me të mira hajt se vitin e ardhshëm Arjan vazhdo.

Arjan Dobraj

Me ju përgjigj kolegës nga Ldk-ja nfakt nuk e kemi shikuar me numër mbase na paska i kur ky element, e di e kemi diskutuar me kolegët dhe me kolegen tënde nga partia Albesen një përqindje e madhe mundemi me thënë se 80 përqind janë të gjinis femërore e sa i përket mesatares besoj edhe ju e dini kuvendi, domethanë drejtimet deficitare i quajm ato që janë pak më të vështira të themi kështu kushtimisht që janë megatronika, arkitektura këto që kanë pas mesatare shumë të lehtë, por me u fitu një bursë 7.5, nuk e di, nuk besoj që ka ndonjë komunë që jep me këtë mesatare më të ulët se sa e kemi ne, por kjo është gjithmon me ju kriju mundësi të gjithëve që me mujt sadopak me i përballu shpenzimet e veta por drejtimet nuk kanë qenë edhe shumë qysh kemi pritur ne që janë duke studiuar të rinjë e këti vendi dotëthotë janë kryesisht të fokusuar në drejtime për të cilat ju mundëson me dal jasht shtetit e kjo nuk na ka ardhur mir asnjë pikë mirpo nuk kemi qfar të bëjmë por dikund 80 përqind janë femra ato që kanë aplikuar edhe që kanë përfituar.

Hajdar Sutaj

Më falni a të bëjmë edhe pak gati, Orgesi pastaj Moni fjalën po ty jam duke ta dhënë fjalën.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues realisht edhe me rregullore ceket që të 2 komisionet duhet të raportojnë para kuvendit me qenë se kam qenë pjesë e komisionit si për hartimin e rregullores si për ndarjen e bursave të vitit paraprak është shumë e rëndësishme që edhe komisioni i ankesave të vijë dhe të raportojë këtu, për shkak të ndjeshmërisë së temës besoj sidomos kur komisioni i ankesave përzgjedh x persona pastaj si përfitues të bursës mund të ju hyj në hak të tjerëve prandaj është mirë që komisioni i ankesave pas këtij komisioni të vijë dhe të raportoi pse x personi e ka merituar bursën që nuk ia ka dhënë komisioni.

Hajdar Sutaj

Kështu kuvendi është pikërisht me diskutu këtë që e tha edhe Orgesi e kisha një telefonat nga një qytetar edhe tha që kishin fituar 3 motra dhe i thash që të triat i kan plotsuar kushtet sigurisht se unë nuk e di kush janë i thash ju mundeni me ardh dhe me pas qasje në dokumenta, mundësisht kush të vjen qasjouni në dokumenta ka ndonjë shqetsim për naj kond pse ka fitu filani hapeni dosjen edhe te atij argumentojani domethan perderisa ju jeni te sakt ne ata që e keni bërë Vatoni është edhe kryetari i komisionit për ankesa, sigurisht afati i ankesave është tash i merrni dhe i shqyrtoni, Moni pastaj Vatoni, Mon Selmanaj.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues ju lutem vetëm pak nëse mund të dëgjohej kryesues të lutem mbaje qetësin pak faleminderit une një pyetje kam për Arianin që na raportoj për ndarjen e bursave për listen e ndarjes së bursave kryetarin e dëgjuam që tha mua po më vin për qdo ditë në derë studentat nuk edita kush është anëtar i komisionit për ankesa tash po e di që është Vatoni por nuk edi kush është përgjegjësi epo atëherë a është që kjo listë prej 170 kandidatëve lista përfundimtare dhe për komisionin për ankesa a ka student që janë ankuar për ndarjet e këtyre bursave.

Hajdar Sutaj

Mon unë po të përgjigjem, kur është publikuar kjo po është afati i ankesave pastaj kur i marrin këta ja u dorëzon zyra pritse dhe pastaj këta munden me ditsa ka ankesa po ja kaloj fjalën Vatoni.

Mon Selmanaj

Zotri kryesues një pyetje për ty drejtpërdrejt, pse e bëtë publike, ju e shpërndat ju partia juve komuna në rrjete sociale listën përfundimtare prej 170 po pa qenë përfundimtare

Hajdar Sutaj

Po ata janë përfitust komisioni komisioni e ka qit

Mon Selmanaj

E qka nëse të kthehet bumerang ajo me 5 a 6 studenta

Hajdar Sutaj

Ata e marrin dhe e postojm prapë Vatoni urdhëro Vatan Istrefaj e ka fjalën

Vatan Istrefaj

Kur të vijë koha fol ti, Florima bënë vetëm te përfundoj, kryesues tani po flas në cilësinë e kryesuesit të komisionit të ankesave, lista që është publikuar që po thotë Florimi nga kryetari nuk është lista preliminare pasi që ajo është publikuar me datën 26 dhjetor dhe nga ajo datë e publikimit do të jenë edhe 15 ditë kohë të gjithë ata student të cilët nuk kanë arritur të përfitojn burs të bëjnë një kërkesë një ankesë në komisionin e ankesave ku jemi të përfshirë nga asambleja komunale unë dhe Faruk Hasanramaj kjo prale të jet një shpjegim për të gjithë opinionin e gjërë dhe gjithë ata student të cilët nuk kanë arritur që të përfitojn bursën edhe kjo prale është që të ja bëjmë kryetarit një lehtësim se tha po më vin mu te zyra, nuk ka nevoj askush me shku te zyra e kryetarit le të vjen te komisioni i ankesave e bënë ankesën edhe ne nëse kemi baza ligjore ata student do të përfitojn burs por kjo nuk është lista preliminare kështu që unë si kryesues i komisionit të ankesave kam vetëm 1 shqetësim për kryetarin e komunës, pasi ai nuk qenka këtu është drejtoresha e financave herën e kaluar kanë fituar 146 studentë më duket edhe e kanë vonuar që pagesën të ja bëjë 6 a 7 muaj është kjo si lutje si këshillë, si doni merreni a ka mundësi këta studentë të cilët kanë fituar kanë përfituar kësaj radhe bursë t'ju paguhet sa më shpejt, pasi që tani janë në semestrin dimëror dhe shpenzimet veç se janë të rritura falënderim.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Florim Mataj e pastaj le të përgjigjet drejtoresha.

Florim Mataj

Pajtohem 2 që kjo është lista preliminare nuk është lista përfundimtare kështu që vetëm këtë deshta ta kemi të kuart është lista preliminare e jo përfundimtare kaq kisha.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë a patë me u përgjigj dikush diçka... drejtoreshë, drejtoreshë a dëshiron mu përgjigjë, veq a e keni lëshuar Yll mikrofonin te Dafina

Dafina Cacaj

Do të bëjmë gjithqka të mundur që ti përfundojm me kohë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë e kemi përmbyllur edhe këtë pikë të rendit të ditës, a ka dikush tjetër tek të ndryshmet i nderum a ke diçka Po. Florim Mataj e ka kërkuar fjalën.

Florim Mataj

Përshendetje kryesus në komision politik e financa nuk na ka ardhur një kërkesë e tillë po kish me qen mirë që sindikata le të kordinohet me drejtoreshen e financave në mundemi me marr një vendim sot nëse nuk egzekutohet brenda këti viti aj vendim nuk ka, nuk është i plotfuqishëm më kështu që është mirë që të koordinohen këta të dy që mos të na qesin në pozita të palakmueshme as ne ose le ta shtyjn për janar kështu që kisha kërkuar nga kryetari i sindikatës zotri Zeqa me drejtoreshen e financave Dafina Cacaj ta marrin një vendim që të mos na qesin në pozitë të keqe as ne si asambleist.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë po Vatan urdhëro se me të vërtet kjo ish dashur me kalu në KpF ashtu e thot rregullorja/

Vatan Istrefaj

Kryesus nëse na një herë gjatë këtyre 3 viteve që ka ndodhur shpesh herë pikat e rendit të ditës që kan ardhur me vones i kena futur në fillim të seances për rend të ditës si ka hyr kjo kërkesë nga kryesuesi i sindikatës së punëtorëve këtu të administratës është hera e 2-të ose e 3-të që Zeqa vjen me kërkesa ndaj kuvendit komunal kësaj radhe ka ardh me 1 kërkesë që t'ju jepet rroga e 13-të punonjësve të administratës sepse e kam lexuar kërkesën disa herë për ta kuptuar mirë është për shkak të arsyes se ajo zyrtarët e administratës kanë rrogat më të ulëta në sektorët komunale e kan koficientin më të ulët, pra ju është dashur që të koordinohen në mes veti dhe pastaj të vini atë në kuvend komunal e ju shkon sikur 2 herë me radhë që kanë ardhur për pagesën e shujtave opozita ka votuar por pozita befasisht se ka votu, kështu që edhe kësaj radhe ndoshta është i njëjtin përceptim, unë e kisha qit në votim së pari kërkesën e tyre e kisha bërë inicusin e kërkesës me dal me mbajt një fjalën për këtë kërkesë pastaj të del ne votim faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë a keni ju diçka me shktu, as Moni, Zeq a ke diçka më thanë Zeqë Malaj e ka fjalën në foltore po ja japim të drejten kryetarit të sindikatës për kërkesën që e ka bërë.

Zeqë Malaj

Përshendetje për të gjithë kryesues i kuvendit komunal, zoti Sutaj asambleist drejtor të drejtorive është e vërtet që ne realisht nuk kemi kordinu me drejtorinë e financave herav të tjera pa dyshim që jemi kordinuar por kësaj radhe nuk kemi kordinuar e kemi bërë një kërkesë duke u bazuar në komunat tjera të Republikës së Kosovës siq është komuna e prishtinës ku nga viti 2022-2023 dhe 2024 e përfiton pagën e 13-të dotëthot shërbysit civil e marrin pagën e 13-të me një vendim të asambles komunale në Prishtinë duke u bazu ka dhe disa komuna të tjera që për momentin nuk më kujtohen qe e kan votu domethanë kërkesën e sindikatës për pagat e 13-të e dini edhe ju vetë e ceki edhe asambleisti nga radhët e Ldk-së që këtu në komunë kemi rrogë 320 euro, kemi rrogë 340 ndoshta kemi dhe rrogë nën 300 euro.

Kështu që inflacioni rritja çmimeve e shumë gjëra tjera do më thonë e vështirësojn jetën qytetarëve e në veçanti punëtorëve të komunës për këtë arsye ne si sindikat kemi bërë kërkesë që mundësisht ta votoni këtë

kërkesë ose nëse jeni dakord edhe ju edhe ne jemi dakord që mos me u bë shkelje ligjore, me u kordinu me drejtoreshin e financav mund edhe në muajin janar me sjell kërkesen njëjt por me një kordinim sepse a po bëjmë shkelje ligjore apo jo kështu që qysh të doni vendosni, nuk është kërkesë e jona për mu shty, kërkesë ishte e asamblistëve që me u kordinu me shty këtë kërkesë por kisha kërku që nëse vjen në muajin janar ose edhe sot nëse vendosni kjo kërkesë e sindikatës me u votu për shkak se ne e dimë më mirë unë jam kryetar i sindikatës e din edhe drejtoresha e financav qfar ka me bërë edhe kjo për shkak se koficientet, kjo nuk mundet me i rrit koficientet as komuna nuk mundet me i rrit koficientet ashtu siq janë gjetur koficientet kan vazhduar jan pagat shumë të vogla tash me i krahasu me asambleista, ju keni 600 euro pagë 1 herë në muaj vini po themë 600 euro aty afër dikund 1 herë në muaj nëse, jo jo ne jemi për me përkrah jemi për me përkrah tash qysh të vendosni edhe ju dhe ju nëse e shini të arsyshmes i asambleist me u shty për muajin janar na pajtohem.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kryetari i sindikatës, fjalën e ka drejtoresha për buxhet dhe financa Dafina Cacaj.

Dafina Cacaj

Përshëndetje për të gjithë faleminderit kryesus për fjalën po e filloj, së pari kërkesa nuk po bazohet në asnjë ligj edhe përderisa nuk e përcakton as ligji për paga as ligji për vetqeverisje lokale pagën e 13-të unë jam shumë e sigurt që nuk na takon edhe Prishtina që e murrum shembull e kan votuar por e kan marrë ne form shujte forma e shujtes atë nuk ja u ka përcaktuar ministria fondi ku i marr mjetet edhe komuna e Prishtinës e ka suficit 30 milionë euro na nuk kemi suficit kemi pasur probleme me pagat prej gushtit edhe me datën 27.11 qeveria ka marrë vendim të komunës deçanin ndër komunat tjera me subvencione 500.000 euro në paga për shkak të muajit dhjetor ka qenë. ka qenë.. kemi mundur me mbet pa paga nëse nuk na kish ndihmuar qeveria edhe në momentin që nuk kemi tepriçë, atëherë nuk kemi mundësi na me pagu pagën e 13-të, edhe pse nuk e parasheh asnjë ligj mirëpo sikur ti kishim mjetet nuk është naj problem unë po them që me shty këtë pikë me diskutu me gjet 1 formë tjetër nuk jo. për të mos ju ndihmuar ose për mos me jau kompenzu ma shumë se sa që e kanë pagën bazë, mirëpo me gjet ni formë duhur qysh mundemi ne me ja gjetë zgjidhjen sfidues, juve mjetit në pozitë të keqe me votu tani mos me gjetë zbatim. Ky vendim po me gjet 1 formë që na mundën me. me u dakordu qysh me gjet formen e duhur për me bo pagesen faleminderit.

Hajdar Sutaj

Drejtoresh faleminderit është Moni për fjalë pastaj Vatani pastaj Miftari pastaj Ariani nuk folë ti a atëher ti je para Monit, letë fol Moni pastaj ti

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues më së pari po i drejtohem parashtresit të kërkesës i cili na e ka sjell këtë kërkesë pa disa të dhëna detale për numrin e puntorëve shumë totale sepse kjo kërkesë do të ketë implikime buxhetore dhe unë pyetjet po i parashtroj edhe drejtoreshës e cila për bazën ligjore veq e ceku unë e parapregadita një pyetje a ka baz ligjore kjo kërkesë dhe cili do të jetë implikimi buxhetor nëse miratohet kjo kërkesë dhe zotri Zeq Malaj pse nuk është bërë kjo kërkesë muajin e kalum muajin nëntor mbledhjen e parafundit, e cila nëse do të ishte miratuar kjo kërkesë, do të ishte bërë egzekutimi i mjeteve tash bash si e keni parapar ju rrogen e 13-të nëse e shtyj me për seanca të tjera, atëherë çfarë do të ketë kuptim rroga 13-të nëse ju e dini se në janar buxheti nuk e di a u dërzohet komunave në janar mundet me ardh shkurti edhe e ka kuptim rroga e 13-të të paguhet në shkurt ose në mars përshembull nëse kuvendi e miraton dhe për këto kisha pas dëshir drejtoreshë nëse nuk priton edhe një herë sa është obligimet buxhetore, nëse miratohet në kuvend kjo kërkesë e sindikatës.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Mon, Orgesi, Vatani e kanë fjalën edhe kush donë urdhëro Orges.

Orges Tafilaj

Faleminderit Kryesus personalisht duke qenë ideologjikisht i majtë e përkrah fuqishëm kërkesën e Zeqës dhe të njëjtën kohë kërkoi që kurdo që të votohet mos të tërhiqet si rastin paraprak kur u anulua vendimi i kalum po të jetë në përkrahjen e të drejtave të punëtorëve faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, po drejtoreshë

Dafina Cacaj

Zotri Mon është afër 70.000 po e llogariti nga 500 euro për secilin puntor se nuk po e di se sa i bie ose se sa e kanë pagën se nuk e kanë të njëjt edhe po veç ata që kanë akt emërime thojke aty edhe Orges sikur unë ta kisha bo këtë kërkesën ti mi kishtecitu nja 3 a 4 ligje të cilat ma ndalojn unë e kuptoj se duhet me votu nëse është në kundërshtim me mua po unë po kam qejf që nëse do vendime ...bukur do vendime i kemi marrë e nuk kanë gjetur zbatim për edhe deri sa të sqaroj në mënyrën e drejtë mem për krahu.

Hajdar Sutaj

Orges po ke të drejtë mundësisht Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

A me fol unë a po fol ti Mon, shkurt drejtoreshë personalisht nuk kam kundër asgjë kundër teje, por në aspektin e përkrahjes punëtore pa marrë parasysh ku gjindem unë jam konsistent qëndrimet e mija faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Hyri Dobrunaj.

Hyri Dobrunaj

Duke ju ndëgjuar tha ju po i merrni 600 e 700 për besë pasna harruar që bëhen 2 vjet që i marrim 600 gati po edhe ne 198 i kemi marrë dhe nuk jemi ankuar me të vërtetë është për keqardhje që punëtorët e administratës i kan pagan shumë të vogla në këtë inflacion të madhë që e kemi dhe është edhe diqka tjetër Dafina unë nuk kom thon pse kom dashtë ose kom pas dëshirës që keni marrë në punë vite s'kemi mujt i paguaj pagat skeni më pas para për paga po e shihni që keni ardh në fund të skeni pas as për paga kjo do të dëlë e vërtetë. E kam 1 propozim meqenëse këtu ne në komunë dyqysh na mundemi qka dojm me bo nga njëher supermena jema bon te gjith puntort e administrates me jau bo 65 vjet me i qu te Albini jau jep nga 100 aj edhe e perfundojm si problem per ketë vit pastaj në vitin tjetër e shohim qka bojm.

Hajdar Sutaj

Arian ti si duket dëshiron me i vu kapak kësaj pune

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesus po përbes jemi lodh sot gjumi është duke na marrur kapak, jo unë veç deshta se kur dola me fol me raportu për komision e bursave, harrova sekoni temë që u lidh pak me arsimin se drejtori i arsimit e ka ditëlindjen zotri Besnik Hulaj edhe deshta me ja uru besoj edhe në emer të kolegëve të tjerë nga partit tjera kam të drejtë të dëshiroj shëndet suksese edhe shumë vite të tjera urime.

Hajdar Sutaj

Vatan Istrefaj e ka fjalën.

Vatan Istrefaj

Nuk të lam me përfundu kryesusi pasi që është seanca e fundit për këtë vit veç edhe 1 vërejtje kam edhe po e përfundojm me këto edhe i tregova kryetarit komunës është seanca e 5-të që nuk rrin te pika e të ndryshmeve na u kan mbledh pyetjet edhe si e përfundojm seancën ka qytetar qe me thirr edhe me thotë a e bërë pyetje time kështu që tash.. nuk mundem me shku në zyre se kam këtu pallafaqime këtu në seanc në asamble kështu që shpresojmë se viti e ardhshëm të ja nisim mbar e mir edhe kryetari të vi më shpesh në seanca e ka obligative

Hajdar Sutaj

Si e lamë punën e kërkesës.. si e lamë punën e kërkesës së sinidikatës

Vatan Istrefaj

Nëse ka bazë ligjore ne e votojm

Hajdar Sutaj

Po tash qfar kemi me bërë po urdhëro Florim.

Florim Mataj

Kryesus unë e propozova, n'fillim në janar na edhe nëse nuk e votojm sod këta naser nuk ka pare naser mbyllet thesari, jam duke folur mfal se thash thesari por viti dashta me than naser mbyllet vlefshmëria e këtij vendimi na qare nuk kemi pa marr vendimin për vitin tjetër jam duke folur për vendimin.

Hajdar Sutaj

Hyri Dobrunaj e ka edhe njëherë fjalën.

Hyri Dobrunaj

E tash pse ma dhe fjalën vetëm me thënë këtë qe po don edhe ti më duket, në fillim të kësaj seance kemi folur dhe kemi vendosur këtë me futë në pikëtë rendit të ditës momentin kur e fut si pik të rendit të ditës të gjithë votuat me dëshirë kërkush nuk shtini mos me votu tash duhet me diskutu duhet me qit në votim e qesim në votim kalon ose nuk kalon jo te të ndryshmiet si pik e rendit të ditës e kemi zavendsuar me materialin për komunitete.

Hajdar Sutaj

Unë e qes në votim kush është për?

Faleminderit për me da rrogën e 13-të falemnderit

A ka kundër?

A ka abstenim?

Kuvendi i komunës mënyrë unanime ka marrë vendim me qit rrogën 13-të.

Me kaq e përmbylli këtë takim shihemi në seancën tjetër

